

AKSIONI PËR Evropë

NË KUADËR TË PROJEKTIT:

- mbi **2500** qytetarë kanë marrë pjesë në 25 debate publike dhe sesione informative në 14 qytete në mbarë vendin. Përveç Shkupit, në projekt janë përfshirë edhe *Manastiri, Velesi, Gjevgjelia, Dibra, Dellçeva, Kërçova, Negotina, Prilepi, Resnja, Struga, Strumica dhe Shtipi*;
- mbi **2000** nxënës të shkollave të mesme prej **30** qyteteve kanë marrë pjesë në **56** trajnime njëditore për Bashkimin Evropian, Instrumentin për ndihmë para-anëtarësimin dhe për Programet e Bashkësisë;
- si partnerë lokalë kanë marrë pjesë: *Fondacioni për zhvillimin e bashkësisë lokale Shtip; Fondacioni për zhvillim lokal dhe demokraci "Fokus" – Veles; Qendra për përkrahjen e zhvillimit – Prilep; Qendra për zhvillimin e bashkësisë – Kërçovë; Qendra për zhvillim të qëndrueshëm "Porta" – Strumicë; Qendra për përkrahjen e bashkësisë – Resnjë; Qendra për zhvillimin e qëndrueshëm të bashkësisë – Dibër; Qendra për zhvillim rajonal "Antigona" – Negotinë; Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm – Kratovë; Akua – Strugë; Qendra rajonale për zhvillim rajonal – Gjevgjeli dhe Qendrën rinore kulturore nga Manastiri*;
- pjesëmarrës kanë qenë *Misioni i Bashkimit Evropian, si dhe ambasadat e Republikës së Çekisë, Bullgarisë, Gjermanisë, Greqisë, Spanjës, Francës, Hungarisë, Holandës, Austrisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, Sllovenisë dhe Sllovakisë*. Të gjitha misionet janë përfaqësuar në nivel të ambasadorit, zëvendës-ambasadorit ose ushtruesve të detyrës;
- kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave eksperte (think-tank) nga disa shtete-anëtare, mes të cilave edhe *Instituti për politikë evropiane - Europeum, Instituti për politikë evropiane nga Berlioni, Instituti irlandez për çështje ndërkombëtare dhe evropiane, Qendra greke për studime evropiane dhe zhvillim, Instituti mbretëror Elkano nga Madridi, Instituti për ekonomi botërorë pranë Akademisë hungareze të shkencave, T.M.C. Aser Instituti nga Haga, Instituti evropian në Logj, Instituti portugez për marrëdhënie ndërkombëtare, Instituti evropian rumun, Qendra për marrëdhënie ndërkombëtare nga Lubjana, si dhe Shoqata për politikë të jashtme nga Sllovakia*.
- janë përgatitur dhe publikuar **8** botime me përmbajtje relevante për aderimin e Maqedonisë në BE (në maqedonisht dhe shqip) me tirazh prej **4200** ekzemplarëve.



Aksioni për Evropë

Aksioni për Evropë

Boton:

Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Milçin, Drejtor ekzekutiv

Redaktorë:

Fani Karanfilova Panovska, Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni
Andreja Stojkovski, Qendra maqedonase për arsim evropian

Fotografitë:

Vanço Xhambaski, Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni

Përkthimi dhe lektura:

Abakus

Formësimi grafik:

Brigada dizajn

Shtyp:

Propost

Tirazhi:

300 ekzemplarë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

341.171.071.51(4-672EY)(049.2)

341.171.071.51(4-672EY:49.7) (049.2)

AKSIONI për Evropë, / [redaktorë Fani Karanfilova - Panovska,
Andreja Stojkovski], - Shkup ; Fondacioni instituti shogëria e hapur -
Maqedoni, 2010. - 116 стр. : илустр. ; 20 см

Превод на делото: Акција за Европа, - фусноти кон текстот

ISBN 978-608-218-065-6

а) Европска унија -Проширување -Дебата б) Македонија -
Зачленување - Европска унија - Дебати
COBISS.MK-ID 82457866

PËRMBAJTJA

- 5 PARATHËNIE
- 7 d-r Ketrin Botger,
Filloni prej pikës ku dëshironi të jeni në ardhmëri
- 11 Simone Filipini
Është absolutisht e pamundur të mbijetohet jashtë strukturave të Bashkimit Evropian në rrethanat e sotme
- 15 Angel Angelov
Bashkimi Evropian është projekti më bashkëkohor dhe ne jemi modernizuar për qasje në anëtarësim
- 19 Sonja Rodriguez
Maqedonia i takon Bashkimit Evropian
- 21 Vacllav Mleziva
Bashkimi i Evropës do të jetë i paplotë pa integrimin e tërësishtëm të Ballkanit perëndimor
- 23 Marija Angeles Garsija de Lara
Anëtarësimi i shteteve të Bashkimit Evropian mbetet prioritet i BE-së
- 25 Vladimir Milçin
Trokas në dyert e Bashkimit Evropian për t'ia mundësuar vetes dhe të mive jetën më dinjitoze
- 29 Stivens Blokman
Parimi i pare i zgjerimit: I rreptë, por i drejtë
- 33 Ervan Fuere
Reformat për në BE kanë rëndësi qenësore për vendin dhe prosperitetin e qytetarëve
- 37 Julija Serafimesku
Për shkak të themelësisë së reformave - jemi rilindur si shtet
- 41 Vladimir Bartoviç
Anëtarësimi në BE duhet të jetë prioriteti numër një
- 45 Adrijan Stefan Konstantinesku
Për të hyrë në Bashkimin Evropian duhet të shfrytëzoni tre partneritete - vendase, rajonale dhe ndërkombëtare

- 49 Robert Kirnag
Dialogu me shoqërinë civile është partneriteti strategjik i brendshëm
- 53 Lidija Dimova
Liberalizimi i vizave duhet të komunikohet në mënyrë adekuate me qytetarët
- 57 Suzana Lisinova
Forumi i hapur për diskutim është shumë më i rëndësishëm për procesin sesa qeveria
- 61 Ulriche Marija Knoc
Ne kemi nevojë për qytetarë dhe media kritike, kemi nevojë për shoqëri qytetare që është e interesuar dhe angazhuar
- 65 Ferenc Kekeshi
Definimi i interesit tuaj qenësor do tu sjellë tek partnerët tuaj strategjikë
- 67 Kristina Vida
Kapaciteti dhe vazhdimësia e shoqërisë qytetare ka rëndësi qenësore për rezultatin e negociatave
- 73 Bojko Buçar
Negociatat me BE-në kanë të bëjnë me legjislacionin e saj, por edhe me përpjekjen dhe politikën
- 79 Natasha Jovanova
Sa më shumë që presim, aq më tepër punë do të kemi
- 83 Aleksandra Papadopulu
Jam këtu për ta ndihmuar përfundimin e miqësive mes shteteve dhe popujve tonë
- 85 Krazimer Sobotka
Pjesa më e madhe e frikës për Bashkimin Evropian nuk është asgjë më shumë se paragjykime
- 89 Nikos Frangakis
Partia e mençur politike e lë anash fjalimin e mbingarkuar politik, për të mirën e shtetit
- 93 Endru O'Rurk
Preku Përmes ndarjes së sovranitetit deri në një nivel të caktuar, ne e kemi fituar sovranitetin e vërtetë
- 97 Dariush Karol Bahura
BE nuk sjell asnjë vendim për ju pa ju
- 101 Luis de Almeida Sampajo
Jemi pajtuar me fqinjët tonë, pa e humbur identitetin
- 105 Andreja Stojkovski
Republikës së Maqedonisë i nevojiten politikanë të guximshëm dhe përgjegjës
- 107 Hulo Krespo MscLennan
Nëse Maqedonia është problemi - Evropa është zgjidhja
- 111 Allan Brajan Bergant
Tani duhet të mendohet për ardhmërinë

PARATHËNIE

*Qendra maqedonase për arsim evropian
Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni*

“Aksioni për Evropë”

Ky publikim është fryt i ciklit të fundit të debateve publike, të organizuar me titullin “MK@EU” në kuadër të projektit “Aksioni për Evropë” në realizim të Qendrës maqedonase për arsim evropian, së bashku me Fondacionin Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni, Forumin rinor arsimor, Qendrën rinore kulturore nga Manastiri dhe qendrat për përkrahjen e organizatave joqeveritare nga disa qytete.

Koncepti i projektit ka filluar me përgjigjen e pyetjes *Ku dëshirojmë të jemi në ardhmëri?* dhe përgjigjen e kemi gjetur në përkrahjen e jashtëzakonshme, pothuajse 100% për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Arsyet për përkrahjen e këtillë janë më se të qarta. Arsyeja e parë është që *sot është e pamundur të mbijetohet jashtë strukturave të Bashkimit Evropian*. E dyta është që *Bashkimi Evropian është projekti më bashkëkohor dhe ne modernizohemi për të aderuar në anëtarësim*. Arsyeja e tretë lidhet me faktin që Maqedonia është pjesë gjeografike e Evropës dhe *i takon Bashkimit Evropian*. Arsyeja e katërt dhe e fundit është që *bashkimi i Evropës do të jetë i paplotë pa integrimin e plotë të Ballkanit perëndimor*. Arsyeja e fundit, është në fakt porosia themelore të cilën ne si qytetarë mund t’ia dërgojmë Evropës: *anëtarësimi i shteteve të Ballkanit perëndimor duhet të mbetet prioritet për BE-në*.

Duke dashur t’i përgjigjemi qëllimit dhe ta afrojmë Bashkimin Evropian ndaj qytetarëve, kemi vendosur ta bëjmë këtë përmes shpjegimit të politikës së zgjerimit të BE-së dhe procesit të anëtarësimit, si dhe përmes prezantimit të përvojave të shteteve-anëtare. Së këndejmi, *parimi i parë i zgjerimit është i rreptë, por i drejtë*. Baza për parimin e këtillë është që politika e përbashkët është politike e qasjes strategjike ndaj çështjeve, por bazohet në kritere reale dhe objektive, ku shtetet e procesit duhet të aderojnë ndaj procesit të reformave mbarëpërfshirëse. Madje edhe pa perspektivën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, *reformat kanë rëndësi qenësore për zhvillimin e vendit dhe prosperitetin e qytetarëve, ku për shkak të themelësisë së tyre, si edhe në shumë raste tjera deri tani, Republika e Maqedonisë do të rilind si shtet*.

Duke e marrë parasysh madhësinë e procesit, kohëzgjatjen dhe rëndësinë e reformave për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, *anëtarësimi në BE duhet të jetë prioriteti numër një dhe për lehtësimin e procesit duhet të shfrytëzohet tre lloje të partneritetit: vendas, rajonal dhe ndërkombëtar*.

Dialogu me shoqërinë civile është partneritet strategjik i brendshëm, kurse ekzistimi i një forumi të hapur për diskutim është shumë më i rëndësishëm për procesin, sesa për Qeverinë. Për këtë arsye, për arritjen e partneritetit të parë (vendas), Republika e Maqedonisë *ka nevojë për qytetarë dhe media që janë kritike dhe shoqëri qytetare që është e interesuar dhe angazhuar*. Duke i përcaktuar interesat e saj vitalë, Republika e

Maqedonisë do t'i identifikojë edhe partnerët strategjikë, me çka do të arrihen ose krijohen partneritetet rajonale dhe ndërkombëtare.

Për reformat dhe suksesin e zbatimit të tyre, rëndësi kanë edhe kapacitetet dhe vazhdueshmëria e administratës publike, për shkak se negociatat me BE lidhen me legjislativën e saj, por edhe me të hollat dhe politikën.

“Aksioni për Evropë” nuk do të ishte as afër asaj që është, pa pjesëmarrjen e partnerëve tonë, ambasadorëve të shteteve-anëtare në Republikën e Maqedonisë, të cilët kanë folur mbi përforcimin e miqësisë mes vendeve dhe shteteve tona, si dhe ekspertët nga organizatat e ndryshme evropiane think-tank, të cilët është dashur t'i bartin përvojat e tyre të anëtarësimit, politikës së zgjerimit, etj. Këta duhet t'u përgjigjen pyetjeve më esenciale. Vërtetë, ekzistojnë shumë lajthitje për Bashkimin Evropian dhe shumë frikë nuk janë asgjë më tepër se paragjykime. Do të na shpjegojnë si një parti e mençur politike e lë anash retorikën e tepër politike, për të mirën e vendit të vet. Do të na ndihmojnë të kuptojmë se përmes ndarjes së sovranitetit, deri në një masë, fitohet sovraniteti i vërtetë. Gjegjesisht, në BE asgjë nuk vendoset për ne pa ne. Do të na shpjegojnë si janë pajtuar fqinjët e tyre pa e humbur identitetin e vet. Shkurt, do të na ndihmojmë të kuptojmë se nëse Maqedonia është problemi, atëherë Evropa është zgjidhja.

Tani duhet të mendohet për ardhmërinë!

*Qendra maqedonase për arsim evropian
Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur - Maqedoni*

“Filloni prej pikës ku dëshironi të jeni në ardhmëri”

INSTITUTI PËR
POLITIKË EVROPIANE

D-r Ketrin Betger,
Hulumtues



Do të kisha dashur të flas pak për përvojën tonë, nga aspekti i politikës gjenerale të zgjerimit. Mbi të gjitha, kur e shikoni Bashkimin Evropian, mendoj se është e rëndësishme që çdoherë ta keni parasysh pozitën në të cilën gjendeni momentalisht. Unë vij nga shteti-themelues i BE-së, që është edhe shteti më i madh anëtar dhe ka pozitë qendrore në Evropë. Për këtë arsye, ajo ka pozitë tjetër, krahasuar me pozitën e ardhshme të Maqedonisë. Njëra prej ngjashmërive që i kemi është që kemi shumë fqinjë dhe marrëdhëniet tona nuk kanë qenë shumë të mira me fqinjët, por kjo ka ndryshuar me kalimin e kohës, falë BE-së. Këtu kemi edhe disa shembuj: i ashtuquajtur i zgjerim i harruar i viteve 1990, zgjerimi drejt lindjes dhe Ballkanit perëndimor, si dhe çështja e bashkëpunimit tejkufitar mes pakicave gjermane, daneze ose polake.

Së pari, i a.q. zgjerim i harruar i vitit 1990, gjegjësisht bashkimi i serishëm i Gjermanisë, që kishte pak domethënie për BE-në, por ishte kyç për Gjermaninë. Kjo është bërë në një mënyrë, që është relativisht e pazakontë, për shkak se Gjermania lindore u anëtarësua në BE, pasi që u bë pjesë e Gjermanisë perëndimore. Qëndrimet e shteteve-anëtare të BE-së nuk kanë qenë çdoherë aq pozitive - ka ekzistuar frika që Gjermania do të bëhet shteti më i madh dhe me gjasë, shtet-anëtar dominant. Në fund, bashkimi i serishëm u aprovua nga ish-aleatët e Luftës së dytë botërore

dhe Gjermania lindore u integrua në Bashkësinë Evropiane pa proces formal të anëtarësimit. Ka ekzistuar shpresa që standardi i jetës së Gjermanisë lindore do ta arrijë shpejtë nivelin e Gjermanisë perëndimore, por kjo është treguar si e gabueshme. Një pasojë tjetër e "zgjerimit të harruar" ka qenë ndryshimi i kufijve të vendit, që në fund e ka hapur rrugën për valën tjetër të zgjerimit - zgjerimit lindor.

Anëtarësimi i fqinjëve tonë (Polonisë, Republikës Çeke dhe Sllovakisë) ka qenë shumë i rëndësishëm për Qeverinë gjermane dhe ka pasur rol të posaçëm në zemrat e gjermanëve. Kjo na dha mundësi për bashkëpunim të ngushtë me fqinjët tonë, në mënyrë që t'i tejkalojmë ngadalë armiqësitë e vjetra nga e kaluara. Për shkak të rëndësisë së anëtarësimit të shteteve të cekura për Gjermaninë, mediat informonin për këtë proces në mënyrë të detajuar dhe gjermanët e rinj kishin mundësi të shohin sa i gjatë dhe vështirë është ky proces. Më kujtohet një diplomat polak, i cili kishte përgjigje të njëjtë çdoherë kur e pyesnin kur do të anëtarësohen në BE - për dy vite, ka qenë përgjigjja e tij. Pas dy vitesh i është parashtruar pyetja e njëjtë dhe ai sërish është përgjigjur "për dy vite". Në fund, diplomati e ka riformuluar pyetjen "Kur do të kalojnë këto dy vite?" dhe në fund, anëtarësimi ka ndodhur. Polonia u anëtarësua në BE përmes një procesi të vështirë, i cili zgjati gjatë. Nuk duhet harruar që zgjer-



imi është proces në dy drejtime. Detyrat e shtëpisë nuk duhet të realizohen vetëm nga shtetet që e synojnë anëtarësimin, si që dëshirojmë të theksojmë ne, por edhe BE duhet ta kryejë detyrën e saj të shtëpisë. Detyra e jonë aktuale është përmbyllja e procesit të ratifikimit të Traktatit të Lisbonës, ku kanë mbetur edhe tre shtete-anëtare që duhet ta ratifikojnë këtë dokument. Nëse arrihet kjo, BE do ta plotësojë kriterin e saj për proceset e ardhshme të anëtarësimit. Nëse duhet ta vlerësojmë qëndrimin e opinionit publik në Gjermani për çështjen e zgjerimit, duhet të themi se nuk ka qëndrim entuziast. Në disa raste janë shfaqur edhe qëndrime negative, si dhe frika për tregun tonë të punës. Ka ekzistuar përshtypja që shumë njerëz mund të vijnë të punojnë, me çka do të preket tregu i punës. Përndryshe, njerëzit që kanë ardhur të punojnë në Britani, për shembull, e kanë avancuar gjendjen ekonomike të vendit-nikoqir, si dhe vendit të tyre, duke e pasuruar shumëllojshmërinë. Sot, pesë vite pas zgjerimit, përvoja tregon që njerëzit janë adaptuar shpejtë ndaj zhvillimeve të këtilla.

Dëshiroj të përqendrohem edhe në qëndrimin e Gjermanisë mbi zgjerimin në Ballkanin perëndimor. Është e rëndësishme të kuptohet fakti që ekzistojnë shumë probleme për të cilat diskutoni tani dhe që lidhen me anëtarësimin dhe funksionimin në vendin tuaj. Në fillim, kjo ka qenë e rëndësishme edhe për ne. Gjermania nuk ka qenë çdoherë anëtare e Evropës së qetë dhe të bashkuar. Nga aspekti historik, kur i shohim marrëdhëniet mes Gjermanisë dhe Francës, këto dy vende ishin armike deri në fund të Luftës së dytë botërore. Shekuj me radhë kemi luftuar dhe kemi jetuar me paragjykime. Sot, të rinjtë që e kanë kryer shkollimin e mesëm as nuk kujtohen në armiqësitë që kanë ekzistuar mes dy popujve. Në ditën e sotme, kur kufijtë janë të hapur, ka shumë më tepër këmbime - të rinjtë i mësojnë gjuhët e të tjerëve dhe e pranojnë më tepër njëri-tjetrin. Kuptohet, ne edhe më tej grindemi kur luajmë futboll, por nuk grindemi kur udhëheqim politikë normale. Besoj që kjo është e arritur e rëndësishme.



Zgjerimi në Ballkanin perëndimor do të jetë shumë më i gjatë, krahasuar me zgjerimin në lindje për shkak të disa arsyeve. Me përvojën që e kemi nga zgjerimi në lindje, kemi mësuar që disa procese kanë qenë më pak të qëndrueshme dhe vendimet për disa reforma janë miratuar vetëm në Parlament dhe nuk janë zbatuar. Në fund, procesi reformues nuk e përfshin opinionin publik dhe shoqërinë qytetare në masë të mjaftueshme dhe kjo shkakton perceptcion të gabueshëm për reformat dhe aderimin në BE. Sipërfaqësia e reformave shkakton brenja tek politikanët gjermanë.

Poenta tjetër, që gjithashtu është e rëndësishme është aspekti i bashkëpunimit tejkuftar. Për dallim nga zgjerimi në lindje, BE konsideron që për zgjerimin në Ballkanin perëndimor, është shumë e rëndësishme të përmirësohen marrëdhëniet mes shteteve të caktuara. Bashkëpunimi rajonal nuk është i lehtë. Por, nëse e shihni zhvillimin e bashkëpunimit mes Gjermanisë, Republikës Çeke dhe Polonisë, do të shihni që në fillim ka qenë mjaft i vështirë. Pothuajse nuk kishte përkthyes

për përkthim në takime dhe parashtrohen pyetja, si të bisedojmë kur nuk e kuptojmë gjuhën e tjetrit? Pa dallim nga kjo, mungesa e njohjes së gjuhës ka qenë problemi më i vogël. Ka pasur shumë probleme historike, për shkak se gjatë Luftës së dytë botërore, Gjermanët e kanë okupuar Poloninë dhe pas luftës, Polonia ka përzënë shumë Gjermanë. Aksionet e këtilla kanë shkaktuar shumë armiqësi mes vendeve. Pas rënies së Perdes së hekurit, populli polak ka qenë tejet i frikësuar. Me hapjen e kufijve dhe mundësinë që njerëzit të udhëtojnë lirë, polakët frikoheshin që gjermanët do t'i kërkojnë pronat e tyre. Nevojitej kohë dhe përpjekje të kuptohet se dikush dëshiron vetëm ta shohë shtëpinë e lindjes dhe vendin e fëmijërisë - kjo nuk do të thotë patjetër që dikush dëshiron të zhvendoset ose që do ta kthen pronën e dikurshme. Ekziston edhe perceptcionin që Gjermanët janë çdoherë të përpiktë dhe në kohë. Këto paragjykime shpesh herë shkaktojnë probleme në komunikimin tonë me Poloninë. Në kontaktin tonë të parë me pushtetin lokal polak, të gjithë frikoheshin

të marrin vendime për çështje të rëndësishme. Kur gjermanët propozonin ndonjë mënyrë të diskutimit dhe vendim-marrjes, polakët thonin që Gjermanët e diktojnë punën. Kur gjermanët tërhiqeshin, polakët atëherë thonin që duhet edhe gjermanët të marrin pjesë në vendim-marrje. Historia patjetër duhet të merret parasysh, ajo ekziston çdoherë dhe e formë-

son mënyrën në të cilën mendojmë. Kur përpiqeni të komunikoni me dikë tjetër, kjo asnjëherë nuk do të jetë e përkryer ose e lehtë, për shkak se çdoherë ekziston një histori. Më e rëndësishme është që duhet të vendosni se çka dëshironi të bëni dhe ku dëshironi të jeni në ardhmëri. Kjo është pikë-nisja e juaj!



“Është absolutisht e pamundur të mbijetohet jashtë strukturave të Bashkimit Evropian në rrethanat e sotme”

**AMBASADA E MBRETËRISË
SË HOLANDËS**

**Sh. S. Znj. Simon Filipini,
Ambasadore**



Nuk është në rregull të flitet për maqedonasit dhe evropianët si ne dhe ju ose të flitet për Evropën, thuajse Maqedonia nuk është pjesë e saj. Ju jetoni në një vend të mrekullueshëm, jeni pjesë shumë e rëndësishme e këtij rajoni dhe pjesë përbërëse e Evropës. Ju jeni pjesë e jona dhe partner i natyrshëm - kështu e shoh unë Maqedoninë. Ju jeni partnerë tonë, tani dhe në ardhmëri. Me kalimin e viteve, do të bëhemi partnerë edhe më të afërt, me avancimin tuaj drejt anëtarësimit në BE.

Filmat e shkurtër që u shfaqën janë shumë informativ. Disa prej filmave të fundit ishin vërtetë zbavitëse, ndoshta pak jokorrektë në kuptimin politik. Shfaqja e Bullgarisë dhe Italisë si vende pak kaotike, të cilat nuk i aplikojnë të gjitha rregullat është jokorrekte në kuptimin politik, por kjo flet për shumëllojshmërinë në Evropë, që është pjesë esenciale e asaj që jemi ne. Të gjithë rreshtohemi ashtu si duhet. Nuk i bëjmë të gjitha gjërat ashtu si duhet. Rregullat, dispozitat dhe ligjet ekzistojnë për tu respektuar, por ne të gjithë jemi njerëz. Të gjithë holandezëve ju pëlqen që ju në Maqedoni nuk ndaleni në rend njëri pas tjetrit. Secili e porosit kafën dhe i kërkon kafetë e ndryshme të cilat i keni, ndonëse të gjitha janë të njëjta - makiato e madhe, makiato e vogël, kafe maqedonase, kafe dibrane, etj. Kjo është e bukur dhe evropiane.

Shumëllojshmëria e juaj nuk është diçka negative. Ju duhet ta kultivoni këtë shumëllojshmëri, që të

bëhet adut i juaj. Këtë nuk e kuptoni sa duhet - fakti që në këtë shtet keni shumë popuj që çdoherë kanë qenë këto dhe çdoherë do të jenë (maqedonasit, shqiptarët, vllahët, serbët, boshnjakët) dhe të huajt si unë, vetëm e pasuron cilësinë e asaj që ju jeni. Në vend që t'i kërkonti gjërat që ju ndajnë, me energjinë e njëjtë duhet t'i kërkonti gjërat që ju bashkojnë. Ju jeni shumë më të ngjashëm nga ajo që mendoni.

Historia është çështje e vështirë, kryesisht për shkak se ekzistojnë pikëvështrime të ndryshme. Pas Luftës së dytë botërore, ne në Holandë e kemi konsideruar veten si herojë, në atë kohë kemi luftuar kundër popujve tjerë në Holandë. Larg, në Azi, kemi pasur koloni dhe kemi menduar se popujt atje nuk janë të gatshëm për pavarësi. Kështu, kemi luftuar kundër vullnetit të tyre për pavarësi. Në fund, ata e fituan pavarësinë. Si mund të ndalni një popull të bëhet i pavarur, nëse populli e do pavarësinë? Si që e keni dashur ju pavarësinë dhe e keni fituar atë para 18 viteve. Ne kemi luftuar kundër kësaj. Atëbotë, holandezët nuk ishin njerëz shumë të mirë që luftonin kundër indoneziasve. Kemi bërë gjëra të tmerrshme dhe na janë dashur 50 vite që ta pranojmë këtë publikisht. Na është dashur të pajtohemi me të kaluarën tonë. Kjo është ajo që njerëzit këtu, në këtë pjesë të Evropës duhet ta bëjnë - të pajtohen me të kaluarën e tyre. Për këtë, nevojitet kohë dhe energji. Pajtimi i këtitillë shkakton dhembje, por kjo duhet kaluar dhe ju duhet patjetër të pajtoheni



mes vete. Kjo është rruga e vetme drejt Bashkimit Evropian.

Të gjithë njerëzit në Bashkimin Evropian, rreth 500 milionë banorë të BE-së dhe ata që dëshirojnë të bëhen qytetarë të BE-së duhet të gjejnë ardhmëri të përbashkët. Është e vërtetë që ne dallojmë, por jemi të ngjashëm në shumë aspekte - të gjithë jemi njerëz. Nëse kemi dëshirë ta shohim në sy njëri tjetrin, të jemi të sigurtë me njëri tjetrin, ta ruajmë integritetin personal, t'i respektojmë dallimet që i kemi mes vete në mendimet, kulturën, besimin fetar, gjuhën ose ndonjë çështje tjetër që është e rëndësishme për këtë vend - besoj së bashku mund ta arrijmë këtë. Nëse fillojmë me theksimin e çështjeve që na ndajnë, do të humbim të gjithë. Luftërat e viteve '90 në Ballkan kanë shkakuar vetëm humbës. Nëse ia zgjasim dorën njëri tjetrit, mund t'ia ndryshojmë kahjen procesit.

Evropa është një projekt shumë i komplikuar me shumë politika të përbashkëta -27 shtete-anëtare, Kroacia troket në derë, Maqedonia gjithashtu dhe të njëjtën e bën edhe Turqia, një vend tejet i madh. Këtu e kemi edhe Islandën, Shqipërinë dhe shumë shtete tjera që dëshirojnë të anëtarësohen. Ndonjëherë, ne e nënvlerësojmë kompleksitetin e këtij procesi. Kjo vlen madje edhe për ne, shtetasit e BE-së. Të gjitha gjërat organi-

zohen diku në Bruksel, në sallat e takimeve ku politikanët merren vesh dhe dakordohen për marrëveshje që kuptohen vështirë. Çka rezulton nga kjo? Ajo që duhet ta kuptojmë është që Evropa është një makineri e madhe për ta arrit kompromisin. Të shkohet tutje me 27 shtete-anëtare aktuale dhe me interesat e tyre nacionalë, si dhe me interesat e perceptuar nacionalë është vërtetë e vështirë.

Evropa është shumë e gjallë këtu në Maqedoni, shumë më e gjallë krahasuar me Holandën, në kuptimin më pozitiv. Holanda e kupton Evropën si të gatshme. Si që e dini, shteti i jonë ishte një prej shteteve-themeluese. Evropën e marrim si të gatshme dhe e kritikojmë tërë ditën. Themi, Evropa e ka bërë këtë ose atë, por asnjëherë nuk kuptojmë se në fund Evropa është projekt i qytetarëve. Të gjithë duhet të jemi pozitivë për këtë projekt të madh. Nëse politikanët në Holandë e shohin vëmendjen e madhe që i kushtohet projektit evropian këtu, në Maqedoni, do të jenë xhelozë. Çdo ditë flitet për këtë në lajme, por qytetarët edhe më tej vështirë mund ta kuptojnë këtë projekt, i cili megjithatë është shumë i prekshëm. Flitet për Bashkimin Evropian, për të gjitha hapat e procesit të anëtarësimit, të cilat do t'i sjellin Maqedonisë përfitime të jashtëzakonshme. Bashkimi Evropian është interes esencial nacional për

shtetin tuaj, si edhe për ne - holandezët. Ne jemi vend i vogël dhe është absolutisht e pamundur të mbijetoni në botën e sotme si vend i ndarë, jashtë strukturave të Bashkimit Evropian, të cilat ju mbrojnë dhe ju ndihmojnë në planin ekonomik dhe politik.

Si që e dini, të drejtat e konsumatorëve kanë rëndësi të jashtëzakonshme. Konsumatorët kanë fituar ndikim të madh, për shkak të Bashkimit Evropian. Çdo ditë ushqehemi me ushqim të sigurt. Kemi sistem të shkëlqyeshëm të sigurimit të udhëtarëve. E kam parë vetë si holandezët presin rend në kufirin mes Belgjikës, Holandës dhe Gjermanisë. E tmerrshme! Nuk mund të kalohej! Kufijtë janë të hapur tani, të gjithë mund të udhëtojnë lirë nga njëri vend në tjetrin dhe të njihen mes vete. Njerëzit afrohen, kontaktojnë, zhvillojnë lidhje ekonomike, tregojnë dhe investojnë. Institucionet punojnë së bashku, përfshirë edhe ato kulturore dhe të ekspertëve. Të gjitha llojet e institucioneve bashkohen, këmbëjnë mendime, dituri, ekspertizë dhe përvojë. Kjo i sjell përfitime të gjithëve, ne mësojmë nga njëri-tjetri. Evropa nuk është rrugë njëkahëshe. Ne be-

gato kemi mes vete. Ky është rast i vetëm, në histori nuk ka ndodhur diçka kaq e rëndësishme si projekti evropian.

Holanda çdoherë e ka mbështetur Maqedoninë, ndoshta për shkak se ndihemi të afërt dhe ju jeni vend i vogël, në detin e shteteve të mëdha në BE. Edhe ne është dashur të luftojmë për të qenë të suksesshëm, por ne jemi vend i suksesshëm dhe e dimë interesin tonë strategjik, dhe e kuptojmë interesin tuaj. Maqedonisë i japim mbështetje politike, bashkëpunim zhvillimor dhe përkrahje kulturore. Që në kohën kur mbretëresha e jonë ishte princeshë, ajo e ka shprehur përkrahjen politike pas tërmetit katastrofal të vitit 1963. Kjo përkrahje është çështje e vijueshmërisë për Holandën. Ne do të vazhdojmë me përkrahje edhe gjatë anëtarësimit tuaj. Ekziston vetëm një gjë e vogël - Maqedonia duhet ta kryejë detyrën e shtëpisë. Kjo është esenca e anëtarësimit. Bashkimi Evropian është një lloj klubi dhe për të qenë anëtar i klubit, duhet t'i respektosh rregullat e tij. Nuk ka asgjë të padrejtë këtu, meqë të gjithë veprojmë kështu. Kjo është pjesë



e procesit të BE-së dhe do të vazhdohet edhe më tej në mënyrën e njëjtë, çdoherë duke u shfaqur fusha të reja.

Tani i afroheni fazës së negociatave për anëtarësim. Edhe pse mendoj që fjala negociata është pak e çuditshme në këtë kuptim, për shkak se më tepër flitet për një dialog të vazhdueshëm mes një vendi dhe Komisionit Evropian dhe vendeve-anëtare për avancimin tuaj në afrimin drejt rregullave dhe rregullativave që duhet t'i zbatoni. Kjo bëhet me qëllim që të jenë konkurrentë në Bashkimin Evropian. Nuk ekziston asnjë shembull i shtetit që nuk ka pasur sukses dhe besoj që edhe ju mund ta bëni po të njëjtën. Kuptohet, në rrugë ka pengesa dhe pikërisht tani ekziston një pengesë, e cila duhet zgjidhur. Keni parasysh që nuk guxonit të anoni

jashtë rrugës. Duhet ta vijoni rrugën dhe të përgatiteni për korsin më të shpejtë drejt anëtarësimit në BE.

Është vërtetë e rëndësishme që vendi të punojë me zell për anëtarësimin në BE dhe kështu t'i qetësojë qytetarët e saj, t'i edukojë për të drejtat që i kanë dhe ta përkrahin procesin. Bashkimi Evropian ofron më tepër përfitime për të gjithë. Këtë e dimë të gjithë dhe e kemi parë tashmë. Të gjitha vendet-anëtare dëshirojnë tu përkrahin në këtë proces, madje edhe SHBA e kanë përkrahur procesin tuaj për anëtarësim në BE, për shkak se e kemi parë të gjithë se është e rëndësishme që Evropa të bashkohet dhe të punojmë së bashku. Le të nisemi në këtë rrugë, në rrugën drejt Bashkimit Evropian, duke i kërkuar gjërat e ngjashme dhe jo ato që na ndajnë.



“Bashkimi Evropian është projekti më bashkëkohor dhe ne jemi modernizuar për qasje në anëtarësim”

AMBASADA E
REPUBLIKËS SË
BULLGARISË

Angel Angelov,
Ushtrues i detyrës së
Ambasadorit



STë gjithë e pranojnë që Bashkimi Evropian është projekti më modern, që do të thotë edhe më i komplikuar, për shkak se BE e realizon funksionin e sinkronizuesit të interesave të 27 shteteve. Do të thotë, Bashkimi Evropian funksionon sipas dy sistemeve - Komisionit Evropian, që është burokracia e Bashkimit Evropian dhe shtetet-anëtare. Kur e përmendim Brukselin, kjo do të thotë se nga njëra anë qëndron burokracia, kurse nga ana tjetër shtetet-anëtare. Në Bashkimin Evropian ka shumë institucione në nivele të ndryshme, kështu që ekziston nevoja e përkthimit të mekanizmave të komplikuar, me qëllim që të kuptohen nga qytetari i thjeshtë. Së pari, ne teori është shfaqur një nocion i ri, që quhet forca e butë (soft power) dhe kjo lidhet plotësisht me Bashkimin evropian - BE është forcë e butë. Nëse në historinë e njerëzimit deri tani, zgjidhjet e problemeve janë kërkuar me forcë dhe aleancat janë bazuar në anën ushtarake-politike, që nga Leka i madh e deri te NATO-ja, Bashkimi Evropian është aleancë e bazuar në vlera dhe interesa pragmatike. Si duket nga jashtë kjo forcë e butë? Nga njëra anë thuhet që Bashkimi Evropian është forcë, por jo në tërësi, për shkak se shumë vështirë merr vendime në politikën e jashtme. Nga ana tjetër, kjo është qendra më e fuqishme tërheqëse, një lloj i magnetit që i tërheq vendet që gjenden jashtë klubit. Të gjitha këto shtete dëshirojnë të bashkohen me BE-në. Së këndejmi, nuk është Bashkimi Evropian duke kërkuar

ta afrojë Bullgarinë dhe Maqedoninë ndaj vetes, por këto dy shtete dëshirojnë t'i bashkëngjiten BE-së. Kjo është shumë e rëndësishme dhe duhet të dihet. Bashkimi Evropian është projekti më bashkëkohor dhe ne modernizohemi për tu bërë anëtarë të BE-së. Ky modernizim i përfshin të gjitha fushat e jetës së vendit, duke filluar nga bujqësia deri te kultura, prej arsimit deri te gjyqësori, prej luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar deri te modeli i ri i politikës sociale.

Një prej nocioneve themelore të Bashkimit Evropian, që aplikohet në të gjitha politikatat e saj është parimi i subsidiaritetit. Kjo është doktrina themelore politike, sipas të cilit zgjidhjet duhet të miratohen në nivel më të decentralizuar, sa më afër qytetarëve. Pushteti qendror ushtron vetëm mbikëqyrje dhe ndërhyrë vetëm në rastet kur zgjidhjet nuk zbatohen në mënyrë efikase. Kjo do të thotë që Bashkimi Evropian funksionon prej poshtë lartë, jo në drejtim të kundërt. Nivelet më të ulëta miratojnë vendime dhe nëse ato nuk janë në pajtim me ligjin, ndërhyrë pushteti qendror. Kjo është pak e vështirë të kuptohet nga shoqëritë tona, të cilat në shekullin XX kanë kaluar në faza të ndryshme të totalitarizmit, autokracisë dhe të ngjashme. Shprehitë shoqërore dhe sjellja shoqërore ka ndryshuar. Ne besojmë që atje lartë ka ndonjë udhëheqës, ndonjë forcë ose vëllai i madh i cili kujdeset për ne, që na lejon diçka dhe na ndalon diçka tjetër. Projekti evropian është pikërisht e kundërta - ti kujdesesh për

vete. Kjo është filozofia për shembull e mbarë procesit të decentralizimit në komunat në Maqedoni. Komunat vetë duhet ta ndërmarrin përgjegjësinë për sukseset e të hollave, me të cilat disponojnë në interes të qytetarëve. Kjo është vetëm një shembull. Kuptohet, këtu mund të dalin probleme, për shkak se disa komuna janë më të pasura dhe të tjerat janë më të varfra. Por, këtu menjëherë mund të përfshihet parimi tjetër themelor i Bashkimit Evropian - solidariteti. Në BE ekziston ndihma e ndërsjellë, më të fuqishmit i ndihmojnë më të dobëtëve, por edhe çdokujt që i nevojitet ndihmë. Kështu i ndihmon edhe pushteti qendror ndonjë komune të varfër. Kuptohet, kur gjithçka shkon në rregull, nuk ka nevojë për ndërhyrje nga Qeveria.

Në fakt, nëse subsidiariteti është vertikal, atëherë solidariteti është horizontal. Bashkimi Evropian funksionon si sistem i marrëdhënieve vertikale dhe horizontale. Pse? Për shkak se sipas Strategjisë së Lisbonës, qëllimi i BE-së është shndërrimi i Evropës në ekonomi më dinamike dhe më konkurrense në mbarë botën. Si do të arrihet kjo? Strategjia e Lisbonës ka tre shtylla. Ekonomia e bazuar në dituri - ekonomia që funksionon falë kuadrit të trajnuar dhe teknologjive më të reja dhe më bashkëkohore. Politika e re sociale - kujdesi për njeriun, zhvillimin e tij profesional dhe papunësinë. Sa i përket shtyllës së tretë, kjo është ekologjia, gjegjësisht kujdesi për mjedisin jetësor, për botën e gjallë rreth nesh, për shkak se teknologjia nuk guxon ta shkatërrojë natyrën.

Do të ndalemi këtu te elementi themelor, arsimi. Qeveria e juaj ka një program të quajtur "Dituria është fuqi". Si kornizë dhe politikë, kjo jo vetëm që është e vërtetë, por është e vërtetë universale në të gjitha vendet. Pa kuadro të mjaftueshme nuk mund të ekzistojë kapaciteti i mirë administrativ, gjegjësisht nuk do të ketë njerëz që dinë si të aplikojnë dhe t'i shfrytëzojnë mjetet e fondeve. Për ndërtimin e kuadrove, ata duhet të jenë vazhdimisht në

administratë. Për mësim, ju nevojitet më tepër kohë dhe përvojë praktike. Në realitet, kur ka zgjedhje dhe ndërrohet Qeveria, kuadrot e krijuara lëshohen nga puna. Do të shpjegoj një ndodhi në këtë kuptim, që në fakt është ngjarje e vërtetë. Pas zgjedhjeve, një kryetar komune i lëshon nga puna të gjithë nëpunësit e administratës komunale dhe Ambasadori Fuere e pyet pse ka vepruar kështu, meqë njerëzit kanë qenë të trajnuar. Përgjigjja e tij ka qenë: "Të gjithë vepronjë kështu". Është e thjeshtë - puna nuk kryhet në këtë mënyrë. Kjo është arsyeja se pse diskutohet për Ligjin për nëpunës shtetërorë. Nevojitet administratë e pavarur, e trajnuar mirë për shfrytëzimin e mjeteve dhe që nuk ndryshohet me ndërrimin e Qeverisë.

Do të ndalem pak edhe te arsimi. Dëshiroj ta cek përvojën tonë me arsimin e disperzuar, me hapjen e fakulteteve në qytetet e ndryshme. Kjo është bërë në Bullgari në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar dhe rezultati nuk ka qenë i mirë, kryesisht për shkak se diplomat e studentëve nuk kishin asfare besueshmërie. Ata kishin problem me akreditimin, legalizimin, etj. Bullgaria, gjithashtu kishte probleme (ndonëse jo shumë të mëdha) me kapacitetin administrativ për shfrytëzimin e fondeve dhe realisht na janë nevojitur dy vite pas anëtarësimit të adaptohemi ndaj kërkesave të BE-së. Të hollat e fondeve janë më të rëndësishme, për shkak se në këtë mënyrë modernizohen të gjitha elementet e sistemit shoqëror-ekonomik të shtetit. Për ta ditur mënyrën e arritjes tek të hollat evropiane, duhet të dish si hartohet projekti, si aplikohet, si lexohet përkthimi në gjuhën gjegjëse. Do të thotë, marrja e të hollave kërkon mësim dhe mbindërtim të vazhdueshëm.

Në vitin 1997 është promovuar IPA si instrument i ndihmës para-anëtarësimit. Sipas raportit të fundit, ku jepet pasqyra e Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim, në periudhën 2008-2010, Maqedonisë i jepen



244 milionë denarë ose rreth 16 milionë euro për 2 vite në kornizat e IPA. Këtu hyn edhe Programi për bashkëpunim tejkuftar, me buxhet prej rreth 7.800.000 euro nga Fondi evropian për zhvillim rajonal, buxheti i Bullgarisë dhe i Maqedonisë. Programi përfshin 23 komuna nga qarku i Bllagoevgradit dhe Qystendilit dhe 29 rajone kufitare nga Maqedonia, përfshirë edhe Kratovën. Rezultatet kërkojnë në të tre elementet, përfshirë edhe zhvillimin ekonomik dhe afrimin social. Do të thotë, në qendër vendoset zhvillimi i biznesit dhe politika sociale, si dhe zgjidhja e problemit të papunëve, që duhet të trajnohen për vende të reja pune. Elementi i dytë është përmirësimi i cilësisë së jetës, duke e theksuar mbrojtjen dhe menaxhimin me burimet natyrore dhe kulturore, me të cilat rajoni i juaj është shumë i begatshëm. Këtu është edhe ndihma teknike për përgatitjen e projekteve dhe ajo që është shumë

e rëndësishme - mënyra e mësimit për aplikimin për të hollat. Komunat, sektori joqeveritar, strukturat rajonale të administratës qendrore dhe administratat e parqeve nacionale të rajonit janë vetëm disa që mund të aplikojnë për këto mjete. Nuk mund të aplikojnë kompanitë dhe partitë politike dhe kjo është mirë, për shkak se në të kundërtën do të zgjerohej korrupsioni. Interes të madh tregojnë edhe BNJVL-ja, e cila në planin e saj strategjik për 2006-2011 ka paraparë trajnim për komunat përmes fondeve evropiane, me qëllim të informimit më të mirë. Nëse duhet t'i japim një prezantim të hollave që vijnë nga IPA, atëherë shfrytëzimi i të hollave nga IPA për Republikën e Maqedonisë është një pjesëmarrje virtuale e Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Thënë ndryshe, IPA është një simulim, por me të holla reale dhe për këtë arsye ju duhet të përpiqeni t'i fitoni ato.



“Maqedonia i takon Bashkimit Evropian”

INSTITUTI PORTUGEZ
PËR MARRËDHËNIE
NDËRKOMBËTARE

Sonja Rodriguez,
Hulumtuese



Përvojat individuale nga procesi i afrimit deri në anëtarësimin fuqiptotë në BE janë pjesë e veçorive që e begatojnë shumëllojshmërinë evropiane.

Kur flitet për hapat portugeze drejt Bashkimit Evropian, duhet ta shohim historinë e shekullit të kaluar. Mes vitit 1933 dhe 1974, Portugalia ka jetuar e izoluar nga politikat bashkëkohore evropiane, nën diktaturën e të djathtës, që përfundoi më 25 prill 1974 me revolucionin ushtarak të të majtës, pa gjakderdhje. Portugalia e ka filluar procesin e anëtarësimit në 1977 dhe është anëtarësuar në Bashkimin evropian ekonomik në vitin 1986, së bashku me Spanjën. Që nga fillimi i këtij procesi, kemi arritur përfitime të mëdha ekonomike dhe kemi formuar forume politike për diskutimin e çështjeve nacionale dhe ndërkombëtare.

Madje edhe në shikim të parë mund të shihni se kjo është e rëndësishme edhe për Ballkanin perëndimor. Ekziston shumëllojshmëri e bashkësive etnike, religjio-neve dhe kulturave që e ndërtojnë historinë e për-bashkët. Duke e marrë parasysh shembullin e Iberisë dhe duke e shikuar historinë dhe shekujt e kaluar së bashku me fqinjët tuaj, duhet ta pranoni shumëllojsh-mërinë që ju lidh.

Në rastin e Maqedonisë, si që mund të shohim në rezultatin e Samitit të NATO-së të vitit 2008 në Bukuresht, çështja e emrit ka rëndësi vendimtare. Ekziston nevojë urgjente për pajtim dhe takime të rregullta mes Shkupit dhe Athinës. Do të jetë e dobishme nëse Bashkimi Evropian ushtron pak presion tek të dy palët për nxitjen e kreativitetit të tyre për të ardhur tek zgjidhja.





Kur flitet për integrimin evropian të Ballkanit perëndimor, qëndrimi im personal është që shtetet që janë krijuar nga prishja e Jugosllavisë janë të "lumtura" në kuptim të anëtarësimit evropian, për shkak se ato i takojnë Evropës dhe të gjitha kanë rëndësi qenësore për paqen, stabilitetin dhe trashëgiminë kulturore të Evropës. Është mirë të dyshoni në projektet evropiane dhe të parashtroni pyetje për aspektet

e ndryshme të procesit tuaj të afrimit. Vetëm kështu mund ta arrini dialogun politik, mediat e lira dhe lirinë e të shprehurit, që janë vlera themelore dhe primare të krijimit të ardhmërisë së përbashkët të Evropës. Kjo është një pjesë e detyrës së rëndë dhe të madhe, që duhet ta kryejnë të gjithë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

“Bashkimi i Evropës do të jetë i paplotë pa integrimin e tërësishëm të Ballkanit perëndimor”

AMBASADA E
REPUBLIKËS SË ÇEKISË

Vaclav Mleziva,
Zëvendës i Shefit të Misionit



Në hyrje, do të përqendrohem shkurt në kryesinë çeke me Bashkimin Evropian dhe aktivitetet tona në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Shkurt do të përqendrohem edhe në marrëdhëniet tona dypalëshe dhe thellimin e tyre të mëtejshëm. Motoja simbolike e kryesisë çeke me Bashkimin Evropian ka qenë "Evropa pa pengesa" gjegjësisht Evropa pa pengesa të brendshme kulturore dhe ekonomike për qytetarët, sipërmarrësit dhe subjektet ekonomike. Temat kyçe të kryesisë çeke kanë qenë ekonomia, energjetika dhe Bashkimi evropian në botë. Nëse e marrim parasysh kompleksitetin e gjendjes së lidhur me fillimin e kryesisë çeke me BE, mund të konstatojmë që programi i kryesisë tonë u plotësua.

Një prej rezultateve konkrete ishte përshpejtimi i procesit të liberalizimit të vizave, proces ku Republika e Çekisë ka qenë një prej nismëtarëve. Jemi të bindur që liberalizimi i vizave është pjesë përbërëse e procesit të integritimit të Maqedonisë dhe vendeve tjera të rajonit në BE. Sa i përket liberalizimit të vizave, e vlerësojmë si mjaft pozitiv faktin që Maqedonia është udhëheqëse e rajonit në plotësimin e kushteve të liberalizimit të vizave. Në shtetin tuaj të bukur janë mbajtur disa ngjarje kulturore dhe ekonomike gjatë kryesisë çeke. Si shembull, do ta cek konferencën e ministrave në Mavrovë, që u

mbajt prej 27 deri më 29 maj për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në Odën ekonomike të Maqedonisë u mbajt biznes-forum me 43 përfaqësues të kompanive çeke dhe maqedonase, në kuadër të ditëve çeke në Maqedoni dhe kjo u bashkua me prezantimin kulturor të Republikës së Çekisë në Shkup. Gjatë periudhës së kryesisë çeke u mbajtën edhe disa koncerte, ekspozita dhe sfilata të krijimtarisë çeko-finlandeze. Të gjitha ngjarjet e organizuara kishin për qëllim ta afrojnë Republikën e Çekisë më afër opinionit publik në Maqedoni dhe t'i thellojnë kontaktet tona në të gjitha nivelet.

Më lejoni tani të përqendrohem në marrëdhëniet dypalëshe çeke-maqedonase. Çekia dhe Maqedonia kanë marrëdhënie tradicionale të shkëlqyeshme dypalëshe, të pangarkuara me çështje të hapura. Megjithatë, niveli i lartë i marrëdhënieve politike që dëshmohet me vizitat e shpeshta të delegacioneve qeveritare nuk korrespondon me nivelin e bashkëpunimit ekonomik. Është pikërisht ekonomia dhe zhvillimi i bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik që ka potencial më të madh për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve çeko-maqedonase. Do të kisha dashur të them se duhet të mësojmë pak nga kompanitë dhe sipërmarrësit slovenë për ushtrimin e biznesit të mirë. Sipas pozitës së saj gjeo-politike, Maqedonia gjendet në udhëkryqin e korridoreve 8

dhe 10 dhe me marrëveshjet e lidhura bilaterale për tregti të lirë me vendet fqinje të Ballkanit perëndimor është treg me perspektivë për kompanitë dhe investuesit çekë. Interesi i ndërsjellë në rritje e sipër dëshmohej edhe me rritjen dinamike të vëllimit të këmbimit tregtar gjatë 3 viteve të fundit. Në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ekonomike rol të madh kanë edhe investimet çeke dhe pjesëmarrja e kompanive çeke në fushën e energjetikës, infrastrukturës rrugore dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor. Në këto fusha Republika e Çekisë ka shumë për të ofruar dhe kompanitë çeke kanë referenca të mira edhe për shkak të realizimit të projekteve qeveritare, përmes ndihmës qeveritare çeke në Republikën e Maqedonisë.

Në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe krijimin e kontakteve, ndihmë të madhe mund të japin ambasadat dhe institucionet dhe agjencitë tjera shtetërore, por rol vendimtar kanë subjektet ekonomike - sipërmarrësit çekë dhe maqedonas. Një prej aktiviteteve të kësaj fushe ishte takimi joformal i kompanive çeke dhe maqedonase më 12 tetor në Shkup, në organizim të odave ekonomike.

Dëshiroj të theksoj që Republika e Çekisë gjatë periudhës së kryesimit me Bashkimin Evropian i ka përkrahur dhe vazhdon t'i përkrahë përpjekjet për integrimin e Maqedonisë, anëtarësimin e saj në BE dhe NATO. Ballkani perëndimor dhe integrimi i tij në strukturat euro-atlantike është një prej prioriteteve të kryesisë çeke dhe kjo ka vazhdimësi edhe në kryesinë suedeze. Tendenca e Maqedonisë drejt strukturave euro-atlantike do të mbetet edhe më tej prioritet i politikës së jashtme të Republikës së

Çekisë dhe kjo ka mbështetje të fuqishme, pa dallim nga spektri politik në Republikën e Çekisë.

Përkrahja jonë aktive është shprehur edhe me vizitën zyrtare të Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Çekisë, njëherazi edhe Kryetar i Këshillit Evropian, z. Mirek Topolanek, në mars, si dhe vizita e Kryetarit të Senatit të Parlamentit të Republikës së Çekisë, z. Premisel Sobotka, në maj. Kontaktet mes parlamenteve të dy vendeve janë shumë të shpeshta. Për shembull, Ministria e punëve të jashtme e Republikës së Çekisë, e ka ndihmuar projektin me titull "Përkrahje e avancimit të Maqedonisë në procesin evropian për integrimin". Hapi i ardhshëm duhet të jetë themelimi i institutit parlamentar në Maqedoni. Vizita e fundit e Zëvendës-Kryetarit të Qeverisë dhe Ministër i punëve të jashtme, z. Jan Kobut në Shkup e konfirmon vazhdimësinë e kryesisë çeke dhe interesin tonë për zhvillimet rajonale. Përveç kësaj, Republika e Çekisë është e gatshme të ndihmojë në procesin e afrimit të Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian dhe t'i ndajë përvojat çeke nga procesi i anëtarësimin. Në fund, dëshiroj të theksoj që bashkimi dhe stabilizimi i kontinentit evropian do të mbetet i papërfunduar pa integrimin gradual të Ballkanit perëndimor në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye, ne besojmë që në kuadër të marrëdhënieve të jashtme të Komisionit Evropian, ky proces duhet të vazhdojë edhe më tej pa dallim nga krizat e ndryshme dhe kështu të përforcohet perspektiva evropiane për shtetet e rajonit. Në këtë drejtim, presim që raporti do të jetë pozitiv dhe dëshiroj tu bind të gjithëve që sipas mendimit tonë, Maqedonia është në rrugë të mirë.

“Anëtarësimi i shteteve të Ballkani perëndimor mbetet prioritet i BE-së”

AMBASADA E
MBRETËRISË SË SPANJËS

Maria Anheles
Garsija de Lara,
Zëvendës-Ambasadore



Kjo do të jetë hera e katërt për Spanjën të kryesojë me Bashkimin Evropian prej anëtarësimit të vendit në vitin 1986. Sipas Traktatit të Lisbonës, kjo do të jetë hera e parë për Spanjën, por edhe për BE-në që kryesia punon si ekip i tre shteteve në periudhë prej 18 muajve. Treshja e ardhshme e Kryesisë, gjegjësisht tre kryesitë e njëpasnjëshme përbëhen nga Spanja, Belgjika dhe Hungaria.

Duke filluar nga kryesia spanjolle në janar 2010, deri në fund të kryesisë hungareze në qershor 2011, tre vendet do të punojnë së bashku për 18 muaj për definimin e prioriteteve dhe hartimin e agjendës së kryesisë. Konsideroj që për një shtet-kandidat si Maqedonia, është e rëndësishme të dihen këto skema të rëndësishme për punën e BE-së. Maqedonia gjithashtu

duhet të jetë e vetëdijshme për raportet e brendshme në BE, meqë ato ndikojnë shumë në afrimin tuaj.

Tejkalimi i krizës aktuale ekonomike është prioriteti i parë në agjendën e kryesisë spanjolle, belge dhe hungareze. Kjo e nënkupton implementimin e Strategjinë e Lisbonës, së bashku me dy sfida speciale:

- 1) krijimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik,
- 2) rritja e punësimeve përmes investimeve, hulumtimit dhe teknologjive të reja.

Çështja e dytë në listën e prioriteteve lidhet me luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes planit të ri aksionar për energjetikë në Evropë për periudhën 2010-2012. Baza e planit aksionar do të përcaktohet në kornizat e Samitit për ndryshime klimatike në Kopenhagë, që do të mbahet në dhjetor të këtij viti.





Prioriteti i tretë është përforcimi në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, që njihet si Programi i Stokholmit, që duhet ta zëvendësojë Programin aktual të Hagës të nëntorit 2009. Kjo nismë ka për qëllim ta dakordojë legjislativën dhe realizimin e legjislativës për zonën Shengen. Do të përforcohen edhe politikat e përbashkëta evropiane për azil dhe migracion.

Në aspekt të politikës së jashtme, treshja do të përkushtojë vëmendje të posaçme në përforcimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me vendet mesdhetare. Tre kryesitë në të njëjtën kohë do të punojnë në favor të zhvillimit të mëtejshëm të Mesdheut. Kup-

tohet, tre kryesitë do të fokusohen në zgjerimin dhe anëtarësimin e shteteve të Ballkanit perëndimor në BE.

Spanja, Belgjika dhe Hungaria do të punojnë së bashku për promovimin e BE-së si lojtar global. Për këtë arsye, gjatë tre kryesive të ardhshme parashihet edhe organizimi i disa samiteve: Samiti special BE-SHBA, Samiti BE-Amerika Latine dhe samite tjera me partnerë bilateralë.

Në fund, treshja do t'i koordinojë përpjekjet e veta për realizimin e Traktatit të Lisbonës, për të cilin shprejtojmë se do të miratohet deri në fund të vitit 2009.

“Trokas në dyert e Ballkani perëndimor për t'ia mundësuar vetes dhe të mive jetën më dinjitoze”

FONDACIONI INSTITUTI
SHOQËRIA E HAPUR
MAQEDONI

Vladimir Milçin,
Drejtor ekzekutiv



DKam menduar gjatë si tu drejtohem dhe në fund kam vendosur për "Të dashur bashkudhëtarë". Jo në kuptimin e "mundimit" serb, gjegjësisht "përpëlitjes" maqedonase, mos në aspekt të rrugës dhe udhëtimit. Pa dallim nga dëshira jonë, të gjithë jemi në trenin e njëjtë. Të gjithë që jemi këtu. Ne, qytetarët e Maqedonisë jemi në trenin për të cilin besojmë dhe shpresojmë se udhëton drejt Evropës. Zoti Fuere është këtu që, me ose pa dëshirë, të na ndihmojë dhe ndonjëherë ta shtyjë trenin drejt Evropës. Edhe mysafiri i jonë nga Irlanda është këtu, për të na ndihmuar ta shtyjë trenin. Unë jam mjaft i moshuar dhe më kujtohet që më herët kishte një tren, të quajtur "Ballkan Express". Ky ishte një tren pa shumë reputacion. Më vonë, kishte një tren tjetër, më të mirë, më të pastër dhe më të rregulluar, të quajtur "Orient Express", por ai nuk arrinte në Shkup - ndahej afër Nishit dhe një pjesë shkonte drejt Stambollit, kurse pjesa tjetër drejt Athinës. Tani ne ëndërojmë për një tren të tretë, të quajtur "Evropa Express" por që nuk duhet të jetë i njëjtë me "Ballkan Express" që ndalej në çdo shtyllë të tretë. Në fund, të gjithë ne dëshirojmë të mos jemi udhëtarë treni. Gjendja më tragjike gjatë udhëtimit me tren në Jugosllavinë e atëherëshme ishte kur zgjoheni dhe konstatooni se treni në fakt qëndron në vend, në ndonjë hekurudhë të dorës së dytë.

Pastaj mendoheni se çka ndodh. A ka treni lokomotivë? Kështu edhe ne, në Fondacionin Instituti Shoqëria e hapur Maqedoni pyetnim veten para një viti, nëse treni i jonë ishte i ndalur diku në hekurudhën e dymbëdhjetë, diku në stacionin e vjetër hekurudhor në Shkup ose a ka lokomotivë? A lëvizë hiq treni i jonë ose ne besojmë verbërisht në retorikën, në fjalët që ne dëshirojmë të shkojmë ne Evropë, dëshirojmë të gjithë. Por, duket që pak njerëz kanë punuar për këtë, kurse lokomotiva ishte e bashkëngjitur në fund të trenit dhe shkonte në drejtim të kundërt. Ne në Fondacion nuk kemi pasur lokomotivë, por kemi menduar që së bashku me ata që vërtetë dëshirojnë të shkojnë në Evropë, mund të përpiqemi ta shtyjë lokomotivën dhe ta sjellim trenin në vendin e quajtur udhëkryq-drejtimi. Ngadalë, udhëkryq pas udhëkryqi, prej hekurudhës së dymbëdhjetë do të arrijmë në të parën. Mendoj se tani ka më së shumti gjasa që treni të niset nga hekurudha e parë. Ndoshta për shkak se duket që për dallim nga viti i kaluar dhe kjo pranverë, edhe përgjegjësit për lokomotivën kanë vendosur ta bashkëngjisin lokomotivën e trenit dhe të tërheqin. Pak me presion nga brenda, pak nga jashtë, pak për shkak të mungesës të të hollave, për shkak të krizës ekonomike - do ta arrijmë suksesin. Tani, mund të arrihet sukses përmes rekomandimit për negociata. Kjo është shumë e rëndësishme për



ne, qytetarët, meqë besojmë se pas fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian, presioni mbi politikanët tonë do të rritet edhe më shumë dhe do të jetë më vështirë t'i tejkalojnë autorizimet e tyre dhe të mos i përmbushin premtimet e dhëna. Në këtë rast, Bashkimi Evropian është aleati i jonë, i qytetarëve. Nuk e di se cili politikan mendon se BE është ose nuk është aleati i jonë dhe në fund të fundit, kjo nuk më intereson. E di që kemi nevojë për Bashkimin Evropian. Dhe kur themi "Aksioni për Evropë" ne mendojmë në "Aksionin për Maqedoni". Ne kemi nevojë për Evropën, që të mos na bezdisin në sportele, të mos na kërkojnë librezat partiake kur kërkojmë punë, të mos japin dorëheqje përgjegjës as në gjendjet më katastrofale, etj. Vendi ku do të jetojmë dhe të drejtat tona do të varen a jemi me një ose dy këmbët në Evropë. Kjo shprehet edhe përmes shenjës tonë për aksionin e cekur - mk@eu (Maqedonia në Bashkimin Evropian, e përkthyer). Ky është qëllimi i jonë. Kemi menduar që jemi të obliguar të përpiqemi

ta shtyjmë trenin nga hekurudha paralele në hekurudhën e parë. Të kujtohem, mbi 90% e qytetarëve dëshirojnë të jenë qytetarë evropianë, gjegjësisht ta shohin Maqedoninë në Bashkimin Evropian. Çdonjëri e jep maksimumin dhe mendoj nëse çdonjëri bën atë që mundet, ne do të sillemi në mënyrë evropiane. Kjo është fjalia ime e parafundit, kurse e fundit është: Është evropiane të parashtrojmë pyetje, por nuk është evropiane të fshehim se diçka nuk dimë, të turpërohemi nga parashtrimi publik i pyetjeve dhe shprehjes publike të mendimit tonë.

Së pari, mendoj që është skandalozë që Republika e Maqedonisë nuk ka Ligj për anti-diskriminim. Pas përpjekjeve shumëvjeçare të sektorit qytetar është përmbledhur një draft, që është vlerësuar si katastrofal. Kjo është edhe një dëshmi plus për tezën time - na nevojiten aleatë nga jashtë, nëse dëshirojmë ta detyrojmë pushtetin tonë të bëjë diçka, që nuk është nën standardet e Bashkimit Evropian. Për ta arritur këtë, na nevojitet më shumë solidaritet qytetar. Unë

pajtohem me ju, e kuptoj qartë situatën, por ende pyetem pse jeni lënë të vetëm. Pse vetëm viktimat, jo të gjitha viktimat, por vetëm ata që janë viktimat të diskriminimit politik, meqë diskriminimi politik është kur dikush lëshohet nga puna për shkak të përkatësisë së ndonjë partie ose simpatisë për të, pse kjo nuk shkakton simpati të mjaftueshme tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë? Pse tani nuk gjenden 70% të anëtarësisë së Sindikatës së arsimit, që do t'i thonë zotëri Dojçin Cvetanovskit që nuk i mbron anëtarët e tij dhe për këtë shkak nuk do ta paguajnë anëtarësimin, si përqindje nga rroga e tyre. Kjo është mënyra e reagimit në botën që gjendet para nesh, kur flitet për të drejtat dhe liritë qytetare.

Sa i përket shoqërisë qytetare - porosia është: mos pritni, por kërkoni dhe merreni vetë! Nëse nuk ua japin atë që e kërkoni, filloni me mbikëqyrje! Unë pajtohem që Qeveria deri tani e ka injoruar sektorin qytetar në mënyrë retorike, por edhe tjera, përveç disa përjashtimeve të vogla (organizatat joqeveritare qeveritare, të cilat shfaqen për një natë ose zhduken për një natë). Mbikëqyrni se cilat organizata joqeveritare, të cilat kinse merren me të rinjtë, kanë marrë të holla nga programi "Të rinjtë në aksion". Kontrolloni

cilat janë këto organizata, a ka konflikt të interesave. Kjo është mënyra e veprimit të sektorit joqeveritar. Mos prisni tu thërrasin në Shkup të dilni në fotografi me Ministrin, për shkak se mund të ndodhë që fotografia të shërbejë vetëm për skenografi, rol ky që nuk është dinjitoz për sektorin qytetar.

Po të isha demagog, po të isha politikan në fushatë, do t'ia thuaja Branko Beninovit - po, kërkoi barazi, insisto për barazi! Me siguri, ai do të votonte për mua. Por, kjo do të ishte një rrenë, meqë teza është e vendosur mbrapshtë. Ne dëshirojmë të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian, dëshirojmë të jemi anëtarë të barabartë të klubit. Vetëm atëherë do të jemi të barabartë. Askush nuk ka kërkuar prej nesh të konkurrojmë për anëtarësim në BE, ne kemi vendosur meqë kemi parë që nuk mund të mbesim të izoluar. Anëtarësia në klub, si që është Bashkimi Evropian me rregulla dhe ekskluzivitet, nuk është gjëja më e mirë në univers, por për gjërat që nuk janë të mira në BE do të bisedojmë pas anëtarësimit. Atëherë, do ta kemi më lehtë të jemi euroskeptik. Tani trokas në derën e Bashkimit Evropian, për t'ia mundur vetes dhe të mive të jetojmë jetë më dinjitoze.





“Parimi i parë i zgjerimit: I rreptë, por i drejtë”

T.M.C. ASER
INSTITUTI

D-r Stivens Blokman,
Hulumtues



Organizuesit e ngjarjes së sotme tregojnë frymë të madhe evropiane, duke e lutur një belg të flasë për qasjen holandeze për zgjerimin e BE-së. Mbi të gjitha, ne jemi të bashkuar në shumëllojshmëri. Qasja holandeze ndaj zgjerimit të BE-së është shumë e ngjashme me qasjen gjenerale të 26 shteteve-anëtare ndaj kësaj politike. Por, për shkak të veçorive specifike - si shtet-anëtar i vogël shumë-kulturor, neto-kontribuues në buxhetin e BE-së, me qëndrim parimor për respektimin e rregullave dhe konsultimeve mbarëpërfshirëse për krijimin e politikave, qasja e Hollandës ka treguar nuanca të njohura në aspekt të zgjerimit të BE-së, krahasuar me qëndrimet e shteteve tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

Holanda është shtet anëtar i vogël deri në madhësi mesatare, që ka interesa të qarta ekonomike, politike dhe të sigurisë për bashkëpunim me shtetet tjera të Evropës. Kombinimi i përpjekjeve të shteteve-anëtare që kanë mentalitet të njëjtë, e bën Holandën më të fuqishme në aspekt të sfidave politike, ekonomike dhe financiare në botën e sotme të globalizuar. Madje edhe para formimit të Bashkësive evropiane në vitet 1950, së bashku me pesë shtete tjera nga Evropa perëndimore, Holanda ka bashkëpunuar me fqinjët e saj Belgjikën dhe Luksemburgun në fushën politike, kulturore dhe ekonomike, përmes Beneluxit. Holanda ka qenë shtet-themelues i NATO-së me

qëllim të garantimit të interesave të sigurisë dhe për arsytet e njëjta e ka mbështetur fuqishëm zgjerimin gjeografik të Bashkimit Evropian. Në bashkëpunim me vendet tjera, ajo është përpjekur t'i arrijë qëllimet e saja në bashkëpunimin tregtar, politik dhe kulturor me qëllim që të bëhet vend më i fuqishëm, më prosperues dhe më stabil në arenën ndërkombëtare, e cila është ndryshuar vazhdimisht dhe në këtë mënyra ia ka dalë t'i orientojë përfitimet për të gjithë qytetarët. Në vitet e nëntëdhjeta, sukseset e shtetit në të gjitha frontet janë lavdëruar edhe nga Kryetari i Shteteve të Bashkuara, Klinton si "çudi holandeze" që duhet të përcillet nga të tjerët.

Në momentin historik të bashkimit të Evropës perëndimore dhe lindore, Holanda e ka luajtur rolin e saj në promovimin e reintegrimit të Evropës, ndonëse nën kushte të caktuara për mos t'i humbur përfitimet e arritura gjatë 40 viteve paraprake të procesit evropian të integritimit. Shtetet që kanë dashur të anëtarësohen në Bashkimin Evropian në fillimin e viteve të nëntëdhjeta, nuk kanë pasur përvojë ose përvoja e tyre me demokracinë ka qenë e vogël. Shtetet kanë qenë më pak prosperuese dhe jostabile në kuptimin ekonomik. Për këto vende, BE i ka përgatitur kushtet e reja të anëtarësimit, të njohura si "Kritere të Kopenhagës" dhe ky moment i zhvillimit është nxitur nga Holanda, që ka qenë vëzhgues

i rreptë i këtyre kërkesave. Haga është mbështetëse e idesë që anëtarësimi në klub kërkon t'i respektoni rregullat e lojës. Pakoja e rregullave përbëhet nga katër kriteret e Kopenhagës, plus kërkesat specifike që mund të lidhen me të kaluarën e dhunshme dhe sfidat specifike të shteteve të Ballkanit perëndimor, si dhe kriteret e caktuar në kuadër të procesit të para-anëtarësimi. Nën moton "Të rreptë, por të drejtë" Holanda e ka përcjellë nga afër aplikimin e kushteve të cekura gjatë mbikëqyrjes së proceseve reformuese në administratë, ekonomi dhe rregullimin juridik të shteteve-anëtare dhe kandidatëve potencialë. Cilësia e reformave konsiderohet si më e rëndësishme nga plotësimi i afateve finale.

Në vitin 1997, Holanda e ka propozuar idenë e krijimit të grupit udhëheqës së gjashtë shteteve-kandidatë, me të cilat do të hapen negociatat e anëtarësimi, duke i prolonguar gjasat e këtiilla për grupin tjetër prej gjashtë shteteve më pak të zhvilluara. Në fund, kjo qasje rezultoi me anëtarësimin e 10 shteteve në vitin 2004, kurse Bullgaria dhe Ru-

mania u bashkëngjitën në vitin 2007 për shkak të problemeve marramendëse me korrupsionin, reformat gjyqësore dhe stabilitetin ekonomik. Por, në Hagë edhe më tej mbizotëron ndjenja që dy vendet që ngecnin u anëtarësuan në BE shumë herët, për shkak se nuk i plotësuan të gjitha kushtet.

Zgjerimi i madh i BE-së ishte shok për shtetet "e vjetra" anëtare. Disa prej 12 shteteve të reja treguan që më ngadalë e mësojnë mënyrën "evropiane" për arritjen e kompromiseve. Nga ana tjetër, holandezët duhet të mësohen që anëtarësimi i aq shumë shteteve të reja e ka vështirësuar edhe më tej shtytjen e agjendës për "thellimin" e Bashkimit Evropian. Kur në vitin 2005 iu dha mundësia holandezëve për deklaram përmes referendumit për ardhmërinë e Evropës (gjegjësisht të a.q. "Kushtetutë evropiane") shumica e bindshme prej 62% votoi kundër këtij dokumenti. Arsyet për votimin e këtiillë negativ janë shpjeguar me distancën që ekziston mes votuesve holandezë dhe makinerisë së Brukselit për miratimin e vendimeve, rolin e Holandës në Projektin evropian







për integrim, si dhe për ardhmërinë e procesit, veçanërisht për zgjerimin që duket i pandërprerë - konkretisht me Turqinë.

Kombinimi i "frikës nga zgjerimi" dhe "melankolisë së zgjerimit" dhe veçanërisht efekti i tyre në tregun vendas të punës, si që është i a.q. "sindrom i instaluesve polak" i kanë nxitur udhëheqësit politik të vendit drejt qëndrimeve më konservative dhe më të rrepta në aplikimin e kushteve për anëtarësim në BE për shtetet (potenciale) candidate. Me siguri që kjo vlen për shtetet e Ballkanit, veçanërisht vendet e përfshira në luftërat e gjysmës së parë të viteve '90, ku Holanda ka luajtur rol të konsiderueshëm (si pjesë e përpjekjes më të gjerë ndërkombëtare paqeruajtëse) dhe ka paguar çmim të madh moral, konkretisht për humbjen e të a.q. "zonë të sigurisë" në Srebrenicë nga armata e serbëve të Bosnjës. Mossuksesi për mbrojtjen e mijëra meshkujve dhe djemve myslimanë nga vdekja e sigurt ka rezultuar me dorëheqje të Qeverisë holandeze dhe "rishqyrtimit të ndërgjegjes" në mbarë kombin. Trauma e Srebrenicës dhe fakti që Gjyqi ndërkombëtar penal për ish-Jugosllavinë gjendet në Hagë janë dy arsytet më

të fuqishme që Holanda të jetë më e ashpër në aplikimin e kushteve "Kopenhaga plus" për bashkëpunim të plotë dhe të padyshimtë me Gjyqin ndërkombëtar penal. Me muaj të tërë Holanda e ka mbrojtur pozitën e izoluar në Këshillin e Bashkimit Evropian, duke e mbështetur qëndrimin e vendit që Serbia duhet të dëshmojë bashkëpunim të plotë me Gjyqin ndërkombëtar penal para se të vazhdojë tutje në procesin e para-anëtarësitimit.

Prapëseprapë, duhet theksuar që Holanda ka hequr dorë nga pozitat e saj të fuqishme për t'i dalë në ndihmë forcës shtytëse reformuese në Serbi, nën udhëheqjen e Kryetarit Boris Tadiq dhe ta lehtësojë goditjen ndaj Beogradit në aspekt të humbjes së Kosovës, që është pranuar nga Holanda si shtet i pavarur dhe sovran. Njëherazi, mbikëqyrja e rreptë e kushteve të (para)anëtarësitimit rrjedh paralelisht me dorën e shtruar për të gjitha shtetet e prekura. Përmes sigurimit të ndihmës financiare dhe teknike për mbështetjen e proceseve reformuese, që nevojiten për anëtarësim në BE, Holanda tregon që nuk i mban peng shtetet-kandidate me pozitën e saj të ashpër për zgjerimin e BE-së. Politika e saj është vërtetë "E rreptë, por e drejtë".

“Reformat për në BE kanë rëndësi qenësore për vendin dhe prosperitetin e qytetarëve”

MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

Sh.T. Z. Ervan Fuere,
Ambasador, Shef i Misionit



Si që është dëshmuar në shumë vende të Bashkimit Evropian, përfshirë edhe shtetin tim, vetëm përfshirja e njerëzve dhe qytetarëve që nga faza më e hershme në procesin e anëtarësimit mund të garantojë pranim më të mirë publik të rezultateve të negociatave, si dhe pranim më të madh për të arriturat në procesin e integritimit evropian, në afat të gjatë. Ndonjëherë, në shtetet-ona anëtare njerëzit pyeten për vlerat e integritimit në BE. Nëse kthehemi në të kaluarën dhe e shohim rrugën e kaluar, do ta përkujtojmë rëndësinë qenësore të procesit integrativ evropian për kontinentin tonë, në tejkalimin e konflikteve të të kaluarës dhe garantimin e paqes dhe stabilitetit afatgjatë të qytetarëve të kontinentit evropian. Këtë javë fillojmë me shënimin e 20 vjetorit të ngjarjeve që e rrëzuan njërën prej barrierave të fundit në Evropë - Murin e Berlinit. Para 20 viteve u rrëzua ky mur - e rrëzuan qytetarët.

Bashkimi Evropian ka pasur mundësi t'i absorbojë ngjarjet e njëpasnjëshme dhe kështu ta përforcojë procesin e integritimit, përmes përfshirjes së më shumë shteteve në BE, duke arritur në familje 27-anëtarësh sot. Shtetet tjera janë duke pritur për të hyrë në Bashkimin Evropian, përfshirë edhe shtetin tuaj, i cili është shtet-kandidat që nga dhjetori 2005. Çdoherë është e rëndësishme ta kujtojmë të kaluarën, me qëllim të theksimit të rëndësisë esenciale të procesit evropian

të integritimit - për stabilitetin tonë të ardhshëm, veçanërisht në rajonin e Ballkanit, që ishte i kapluar nga shumë konflikte dhe vështirësi në të kaluarën e afërt.

Aspirata për përfshirje në Bashkimin Evropian është qëllimi I VETËM që me siguri i bashkon njerëzit e të gjitha bashkësive fetare të këtij vendi. Kujtohe mi që shteti i juaj ka qenë i pari që e nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim, që u krijuar nga Bashkimi Evropian për t'i ndihmuar shteteve të Ballkanit në përgatitjen e tyre për procesin e aderimit. Kjo ndodhi pikërisht në vitin 2001, vit i vështirë ky për vendin, për shkak të konfliktit që shkaktoi shumë viktima dhe e theksoi rëndësinë qenësore të tejkalimit të tensioneve etnike. Bashkimi Evropian ka luajtur rol të rëndësishëm, duke i ndihmuar udhëheqësve të vendit në tejkalimin e konfliktit, përmes nënshkrimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit, më 13 gusht 2001. Më tej, në këtë vit u nënshkrua edhe Marrëveshja për stabilizim dhe asociim, që është hapi i parë drejt Bashkimit Evropian. Në mars 2004, pas disa vitesh, udhëheqësit e vendit udhëtuan në Dublin për ta parashtruar aplikacionin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Për fat të keq, kjo ngjarje u shënuar me një tragjedi - vdekja e Kryetarit Trajkovski. Megjithatë, si simbol i frymës së madhe të popullit të këtij vendi, pas një muaji, udhëheqësit e njëjtë u kthyen në Dublin për ta parashtruar aplikacionin edhe formalisht tek Kryeministri

irlandez, meqë Irlanda ishte Kryesuese e radhës e Bashkimit Evropian.

Në vijim, në dhjetor 2005, Bashkimi Evropian vendosi t'ia jep vendit statusin e kandidatit, që është mirënjohje për përpjekjet e jashtëzakonshme nga udhëheqësit e vendit për tejkalimin e ndarjeve nga e kaluara. Kjo i ka nxitur udhëheqësit dhe të gjitha partitë politike të punojnë së bashku, në frymën e konsensusit për realizimin e reformave, që do t'i ndihmojnë vendit në arritjen e standardeve juridike, pavarësisht së gjyqësorit dhe luftimit të korrupsionit, me qëllim të përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Zgjedhjet e korrikut 2006 e sollën ndryshimin e pushtetit, që nga ana tjetër solli vështirësi të mëdha për dialogun politik. Janë nevojitur përpjekje të mëdha nga unë dhe kolegu im amerikan për t'ia theksuar udhëheqësve të vendit rëndësinë qenësore të mbajtjes së dialogut të vazhdueshëm mes të gjitha partive, si mënyra e vetme për zgjidhjen e problemeve dhe promovimin e konsensusit.

Në fillim të vitit 2009 kishim një përparim të mirë me shumë reforma, që e inkurajoi Komisionarin Rehn ta vizitojë vendin dhe t'i nënvizojë disa prej reformave kryesore, të cilat do t'i ndihmojnë shtetit të kalojë në fazën tjetër të procesit të anëtarësimit: përcaktimit të datës për fillimin e negociatave. Këto janë të a.q. reperë (kritere) - tetë reforma me prioritet që janë zemra e mbarë procesit reformues. Duhet të theksoj që qëllimi i Komisarit ka qenë ta ndihmojë Qeverinë të fokusohet në detyrat e dhëna, si dhe ta përkujtojë Qeverinë dhe udhëheqësit politikë për përgjegjësinë e tyre si shtet-kandidat. Pranimi i statusit shtet-kandidat dhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian ofron shumë mundësi, por edhe obligime. Është e rëndësishme që udhëheqësit e vendit të kujtohen në obligimet ekzistuese, për shkak se vendi dëshiron t'i bashkëngjitet

BE-së. Megjithatë, këto reforma janë esenciale për zhvillimin e ardhshëm ekonomik dhe social të vendit, si dhe për prosperitetin e qytetarëve, madje edhe pa ekzistimin e Bashkimit Evropian. Këto janë faktet që ne vazhdimisht i theksojmë.

Në Mars 2008, pas miratimit të Partneritetit për aderim, ku përcaktohen prioritetet kyçe afatshkurte dhe afatmesme, Komisari erdhi për t'i prezantuar këto kritere. Ne ishim vërtetë optimistë që gjërat do të lëvizin para dhe që në vitin 2008 do të jemi në gjendje ta shënojmë zhvillimin historik të gjasave të vendit për anëtarësim në BE. Fatkeqësisht, zgjedhjet e vitit 2008 e shkatërruan këtë shpresë. Këto zgjedhje u shënuan nga dhuna, frikësimi, parregullsitë e shumta dhe kjo ishte një hap prapa për vendin. Tani, kjo i takon të kaluarës. Zgjedhjet e marsit të kaluar, ndonëse në asnjë rast nuk ishin të përkryera, e kthyen besimin në kapacitetin e vendit dhe vullnetin politik për organizimin e zgjedhjeve, në pajtim me standardet ndërkombëtare. Edhe këtu kishte probleme të caktuara, si që është çështja e frikësimit. Këto janë çështje që duhet të zgjidhen nga Qeveria dhe partitë politike, për të garantuar që zgjedhjet e ardhshme do të jenë plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare. Por, edhe kjo është në interes të qytetarëve - të kenë stabilitet, ta gëzojnë të drejtën e votës në atmosferë të lirë, pa frikësim dhe dhunë.

Pas kësaj kemi vërejtur përparim të jashtëzakonshëm, veçanërisht gjatë dy muajve të fundit, pas ndërrimeve të ministrave të caktuar dhe emërimit të Zëvendës-Kryeministrit të ri, që pasoi pas dorëheqjes së para-ardhësit të tij. Jemi shumë të inkurajuar nga përpjekjet e paradokohshme, meqë ato e demonstroi në përkushtimin e Qeverisë dhe të gjithë udhëheqësve për të punuar në frymën e konsensusit në miratimin e reformave. Do të theksoj disa prej tyre. Së pari, pa-



varësia e gjyqësorit. Shumica e anketave të mendimit publik tregojnë që gjyqësori është një prej institucioneve me besim më të ulët të qytetarëve. Ndërhyrja e perceptuar politike dhe vonesat e gjata të proceseve gjyqësore janë vetëm disa prej arsyeve. Çdo javë, ne marrim shumë kërkesa nga qytetarët dhe kompanitë, që besojnë se të drejtat e tyre nuk respektohen, që kanë qenë palë të aktgjykimeve që nuk zbatohen ose që kërkojnë intervenimin tonë. Kjo e pasqyron sistemin jofunksional gjyqësor, që kërkon shumë përpjekje për përforcimin e gjyqësorit në vend. Mjetet financiare të Bashkimit Evropian janë shfrytëzuar për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publike dhe këtu ka përparim relativisht të mirë. Megjithatë, ky është proces i gjatë që kërkon përpjekje të vazhdueshme nga të gjitha palët në vend.

Lufta kundër korrupsionit është një fushë tjetër e rëndësishme. Korrupsioni nuk është specifik vetëm për këtë shtet, por ajo është endemike në shumë vende të rajonit ballkanik dhe më gjerë. Kjo është dukuri që duhet shlyer një herë e përgjithmonë. Duhet të ekzistojë zero-tolerancë në luftën kundër korrupsionit. Këtu problemi ka qëndruar në mungesën e bashkëpunimit mes agjencive të ndryshme për zbatimin e ligjit. Kjo

është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme dhe besojmë që me ligjet e miratuara kohëve të fundit, do të vazhdojë puna në këtë drejtim.

Fusha e tretë, e cila mbase është më e dobëta në këtë proces, është administrata publike. Ky vend është i pllakosur nga administrata publike tejte e politizuar. Çdo herë kur ndërrohet qeveria, pa dallim nivelit nacional ose lokal, nëpunësit publikë lëshohen nga puna ose ndërrohen. Nuk ka vazhdueshmëri dhe për këtë arsye nuk ka administratë publike profesionale, që do ta lëvizë procesin reformues. Ne jemi të inkurajuar me momentet e reja zhvillimore dhe me përkushtimin e Kryeministrit për të bërë gjithçka që mundet për themelimin e administratës publike profesionale dhe të depolitizuar. Kjo është e rëndësishme për shkak se pas zgjedhjeve të fundit lokale dhe presidenciale në mars, në shumë komuna ku erdhën kryetarët e rinj të komunave lëshohej nga puna një pjesë e kuadrit, që ishte trajnuar nga ana e Bashkimit Evropian. Veprimet e këtuja do ta nxisin BE-në të heqë dorë nga trajnimet e këtyre personave, nëse në zgjedhjet vijuese ata lëshohen nga puna - komuna humb në këtë mënyrë ekspertizë, për të cilën ekziston nevojë tejte e madhe. Sot, përderisa flasim, Kuvendi duhet ta miratojë

Ligjin e ri për administratë publike. Kjo është shumë e rëndësishme dhe e demonstroi përkushtimin e Qeverisë dhe të gjitha partive politike për përparim.

Miratimi i ligjeve është i mirë dhe kjo tregon përkushtim të mirë, por nuk mjafton. Zbatimi efektiv është absolutisht i nevojshëm. Ligjvënësi duhet ta ketë parasysh faktin që legjislati i miratuar kërkon burime gjegjëse - burime njerëzore dhe financiare të administratës, që do ta garantojnë zbatimin e ligjeve. Më tej, nevojitet edhe mbikëqyrja për ta garantuar zbatimin e plotë. Në të kundërtën, dështon synimi i ligjvënësit.

Krejt kjo është shumë pozitive dhe ne shpresojmë që përpjekjet e këtyra do të vazhdojnë edhe gjatë javëve të ardhshme, me qëllim që Komisioni të ketë argumente të mjaftueshme për dhënien e rekomandimit për hapjen e negociatave për anëtarësim, në raportin e tetorit. Nëse jepet rekomandimi, ai përcjellët në Këshillin e Bashkimit Evropian për miratim, ku vendimet miratohen njëzëri, tradicionalisht si vendimet tjera që lidhen me procesin e zgjerimit. Rekomandimi do të jep një sinjal të fuqishëm ekonomik, që e përforcon orientimin evropian të vendit dhe ndihmon në përforcimin e besimit afarist në vend për në ardhmëri.

Ne do të vazhdojmë me përkrahjen e Qeverisë së Maqedonisë dhe të gjitha sektorëve të shoqërisë, përmes burimeve tona financiare me buxhet prej pothuajse gjysmë milion euro, që dedikohet për ndihmën e procesit reformues në nivel nacional dhe lokal. E theksoj nivelin lokal, për shkak se demokracia funksionon dhe është më afër qytetarëve pikërisht në nivelin lokal. Kjo është arsyeja se pse debatet publike si ky sot janë shumë të rëndësishëm - ato e rrisin vetëdijen tuaj për çështjet e diskutuara dhe për të cilat vendoset. Përforcimi i bashkëpunimit me fqinjët është pjesë e këtij bashkëpunimi. Tashmë është krijuar bashkëpunimi tejkuftar me Greqinë, Shqipërinë dhe Bullgarinë. Për shembull, projektet e përfunduara me sukses me Greqinë tregojnë që pa dallim mendimeve politike, bashkësitë fqinje mund të punojnë së bashku në frymën e miqësisë dhe besimit. Do të përfundoj me notë shpresëdhënëse, për shkak se kam parë zhvillim të jashtëzakonshëm javëve të fundit. Ardhmëria e vendit në Bashkimin Evropian është e garantuar, nëse kjo shndërrohet në proces të vazhdueshëm, posaçërisht pas Raportit të Komisionit, me çka do të ndryshohet praktika e një hapi para dhe pas një dite hap prapa.



“Për shkak të themelësisë së reformave - jemi rilindur si shtet”

INSTITUTI EVROPIAN I RUMANISË

Julija Serafimesku,
Ndihmës i Redaktorit
e Revistës rumune
për çështje evropiane



Këmbimi i përvojave të caktuara të Rumanisë mbi periudhën para dhe pas anëtarësimit mund të jetë i dobishëm për përcaktimin e opsioneve të ardhshme strategjike të Maqedonisë, kur flitet për procesin e anëtarësimit.

Përgjigjja e Rumanisë për pyetjen "Pse BE?" ishte e qartë që në fillim. Kjo lidhet fuqishëm me momentin kur filloi procesi i anëtarësimit në vitin 1989, si dhe konteksti në të cilin filloi ky proces, procesi i kthimit në Evropë. Bisedat e anëtarësimit shiheshin si ndarje nga e kaluara nga njerëzit në Rumani, ndarje nga mbeturinat e komunizmit dhe 40 vitet e pushtetit komunist. Rumania filloi t'i qasej me vrap botës perëndimore, ku institucionet i pasqyrojnë parimet demokratike, të cilat tentonim t'i respektojmë. Përveç kësaj, Rumania e kishte përvojën e kthimit në Evropën e mesme gjatë periudhës së para-anëtarësimit. Ndonëse shteti ishte këtu për një kohë të gjatë në kuptimin gjeografik, "kthimi" simbolik lidhej me perceptimin që të qenit pjesë e vendeve të Evropës së mesme është vërtetim që Rumania është në rrugën e vërtetë për në BE.

Hapi i parë në rrugën drejt BE-së ishte nënshkrimi i Marrëveshjes evropiane në vitin 1993. Bisedat e anëtarësimit filluan në vitin 2000 dhe përfshinin 31 kapituj, disa prej të cilave ishin shumë të ndjeshme. Por, ne ia dolëm t'i mbyllim ato dhe t'i përfundojmë

negociatat në vitin 2004. Dinamika e negociatave e përcaktonte suksesin e Rumanisë në transponimin dhe miratimin e legjislativës së BE-së. Megjithatë, ky proces nuk ishte aspak rrugë njëdrejtimëshe. Pas miratimit, legjislacioni duhet zbatuar dhe kishte pak garanci për këtë. Miratimi ose harmonizimi i legjislacionit nuk mjafton. Në këtë drejtim, procesi i jonë i anëtarësimit ishte maratonë e vërtetë, që tregoi se Rumania ngec pas vendeve tjera që ishin në procesin e anëtarësimit, ndonëse filluam në pikë të njëjtë dhe duhej t'i plotësojmë kriteret e njëjta. Kështu, në vitin 2004, u ballafaquam me faktin e fillimit të rrethit të fundit për arritjen e afatit të fundit në janar 2007. Disa prej sfidave kryesore ishin të lidhura me disa çështje shumë të ndjeshme, prej të cilave do të cek vetëm disa, të cilat i shkaktuan kokëdhëmbje organeve publike rumune në negociatat me Brukselin. Lëvizja e kapitalit, për shembull, ishte çështje kapitull me ndjeshmëri të veçantë, në aspekt të faktit që një dimension i kapitullit i mundësonte qytetarëve të shteteve tjera të BE-së të blejnë tokë bujqësore dhe pyje në territorin e Rumanisë, pas anëtarësimit. Kjo çështje ishte posaçërisht e ndjeshme, meqë të drejtat pronësore në Rumani ishin shfaqur para pak kohe, pas 40 viteve të pronësisë shtetërore. Ky lejim ishte sfidë e madhe dhe temë e diskutimit serioz në Bruksel. Më tej, kapitulli i politikës së konkurrencës,



ku problemi kryesor ishte legjislacioni i lidhur me ndihmën shtetërore. Shteti duhej të ushtrojë presion të fuqishëm drejt ristrukturimit të industrisë dhe privatizimit, por jo përmes rritjes së subvencioneve dhe ndihmës shtetërore. Mjedisi jetësor ishte një kapitull tjetër me vështirësi të jashtëzakonshme, për shkak të implikacioneve të negociatave në masat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, që duhet të merren në të gjithë sektorët e ekonomisë. Me qëllim të aplikimit për masat e mbrojtjes së mjedisit jetësor në Rumani, duhej të bindeshin të gjithë aktorët e përfshirë në industri dhe shoqërinë civile. Nevojiteshin ndryshime, që ishin të shtrenjta për ekonominë në Rumani. Kjo shkaktoi vështirësi për shtetin që nuk kishte aspak përvojë në mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në fund, bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme dhe politikave të ngjashme nënkuptonte garanci që Bashkimi ka fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Për ta arritur harmonizimin me parimet kryesore të politikave të cekura, Rumania duhej të

rilind si shtet, për shkak të reformave të thella në sektorin e administratës publike dhe reformave në gjyqësor.

Përveç kësaj, duhet cekur që procesi i integritimit në BE realizohej në mënyrë paralele me integrimin në NATO. Këto dy procese ishin të ndërlidhura që në fillim. Rumania u anëtarësua në Këshillin e Evropës në vitin 1993, me çka u pranua përkushtimi i Rumanisë për parimet demokratike. Pas një viti, nënshkruam marrëveshje me NATO, që ishte hapi i parë për anëtarësim. Më pas e nënshkruam Marrëveshjen evropiane me Bashkimin Evropian, që e nënkuptonte tregtinë e lirë me mallra industriale. Kjo ishte e mundur për shkak se prej fillimit të viteve '90 kishim konsensus të fuqishëm politik për rëndësinë e procesit të anëtarësimit. Të gjitha forcat politike ishin të vetëdijshme për atë që nevojitej në këtë drejtim dhe konsensusi nënkuptonte shumë kompromise politike në planin nacional. Këto momente zhvillimore ishin vërtetë të vështira, meqë Rumania përpiqej të me-



naxhojë dy procese të ndryshme në kohën e njëjtë, por që ishin të lidhur mes vete. Procesi i parë ishte tranzicioni - ne dolëm nga dyzetë e më tepër vite komunizëm dhe tani përpiqeshim ta kapim hapin. Kjo nuk ishte aspak e lehtë, posaçërisht në fushën e ekonomisë. Procesi i dytë ishte anëtarësimi në BE, që ndonjëherë impononte kërkesa të dallueshme nga kërkesat e imponuara në procesin e tranzicionit. Në çdo rast, procesi i tranzicionit dhe anëtarësimit në BE impononin demokratizimin e vendit. Një prej rreziqeve kryesore ishte tendenca e aktorëve politikë që të mos e shohin demokratizimin si qëllim për vete, por si qëllim më të vogël në kuadër të qëllimit - anëtarësimit në BE. Kjo ishte posaçërisht e rëndësishme, meqë demokracia duhet të jetë qëllim për vete për të dhënë rezultate.

Në fund, Rumania ia doli dhe u bë anëtare e Bashkimit Evropian më 1 janar 2007, me çka filloi edhe prezantimi i saj në nivelin politik në institucionet e BE-së. Shoqëria civile "reagoi" ndaj anëtarësimit

dhe për çështjet e lidhura me BE-në diskutohej çdoherë e më tepër në Rumani, posaçërisht në media. Presioni i OJQ-ve dhe organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që kërkojnë vazhdim të reformave vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe kjo ka rëndësi të madhe.

Dy vite pas anëtarësimit, mund të thuhet që zhvillimi ekonomik i Rumanisë është përfitimi kryesor nga ky proces. Megjithatë, çështja kryesore që duhet theksuar është që data e anëtarësimit nuk ka pasur rëndësi të madhe për këtë. Fakti që ne jemi anëtarësuar më 1 janar 2007 nuk e ka shkaktuar ndryshimin në ekonomi. Zhvillimi ekonomik është rezultat i të gjitha përpjekjeve të Rumanisë në periudhën para anëtarësimit, në kombinim me interesin në rritje nga investuesit e huaj dhe institucionet e huaja, që shtoheshin me rritjen e gjasave për datën e anëtarësimit për Rumaninë.

Tema kryesore në diskutimet për gjendjen ekonomike në Rumani janë fondet e BE-së. Rumania edhe



më tej ka shkallë më të ulët të absorbimit të mjeteve financiare të BE-së në mbarë Evropën. Nëse i shihni të dhënat statistikore, ato nuk duken shumë mirë. Një pjesë e problemit është që ende nuk ka ekspertizë të mjaftueshme tek aplikuesit për financim nga BE, si dhe tek autoritetet publike që përfshihen në menaxhimin e projekteve të parashtruara për vlerësim. Ekspertiza e nevojshme lidhet me mënyrën në të cilën duhet të hartohen projektet për të qenë të suksesshme. Një problem tjetër është fakti që dy vite pas anëtarësimit të Rumanisë në BE, ende ndjehet një masë e përfaqësimit joadekuat politik të Rumanisë në organet e BE-së pas vitit 2007, që nuk përket me ndryshimet e pritura në aspektin e dimensionit social. Në këtë kuptim, disa shtete-anëtare dhe më tej kanë kufizime për punësimin e rumunëve.

Përveç kësaj, konsiderohet që Rumania ka shënuar rezultate pozitive në drejtim të qeverisjes

së mirë. Por, fakti që jemi anëtarësuar në janar 2007 nuk do të thotë që puna e jonë ka përfunduar - Rumania edhe më tej është në procesin e verifikimit, me raporte gjysmë-vjetore për çështje shumë të ndjeshme. Disa prej çështjeve në fjalë janë të njëjta edhe për Maqedoninë, si që është korrupsioni. Përmes këtyre raporteve, Komisioni përpiqet t'i ndihmojë Rumanisë në ballafaqimin me këto probleme, plotësimin e kriterëve të caktuar dhe ballafaqimin me sfidën e të qenit shtet-anëtar i BE-së. Pa dallim faktit që ende luftojmë disa probleme që rrjedhin nga periudha e para-anëtarësimit, anketat publike edhe më tej tregojnë që rumunët janë pozitiv për BE-në. Në fund, është pikërisht ky qëllim që do t'i ndihmojë Rumanisë në shfrytëzimin më të mirë të mundësive të anëtarësimit, së bashku me përkushtimet e organeve publike. Këtu do ta përfundoj prezantimin tim. Ju falënderoj.

“Anëtarësimi në BE duhet të jetë prioriteti numër një”

INSTITUTI PËR POLITIKË
EVROPIANE - EVROPEUM

M-r Vladimir Bartoviç,
Hulumtues më i vjetër



Republika e Çekisë dhe Sllovenia, gjegjësisht perspektivat e tyre drejt BE-së ishin shumë të ngjashme. Tetë prej vendeve të Evropës lindore, të cilat ishin socialiste tani luftonin për anëtarësim në BE. Sllovenia dhe Republika e Çekisë ishin në dy vendet e para, kur flasim për zhvillimin ose nivelin e BPV-së. Pozitat e tyre fillestare dhe problemet ishin me esencë të njëjtë. Kur në vitin 1989 ndodhën ndryshimet në Republikën e Çekisë (Çekosllovakia e atëhershme), njerëzit mendonin se për tre ose katër dhe maksimum për pesë vite, do të jemi anëtarë të Bashkimit Evropian. Por, kjo datë vonohej vazhdimisht dhe në fund kuptuam se kjo nuk do të ndodhë në vitin 1995, as në vitin 1996, 1998 ose 2000 dhe as në 2001. Pritjet e këtilla përkraheshin edhe nga politikanët e Evropës perëndimore. Për shembull, Kryetari francez Zhak Shirak tha që Republika e Çekisë mund të hyjë në BE aty rreth vitit 1998. Kjo, së bashku me qëndrimin mbizotërues të politikanëve çekë se jemi shteti më i zhvilluar, krahasuar me të gjitha shtetet-aplikuese, tek shumë njerëz ka shkaktuar siguri se Republika e Çekisë do të ketë vërtetë negociata me BE-në për kushtet e anëtarësimit. Republika e Çekisë, së bashku me Slloveninë, ishin vendet e fundit që dorëzuan aplikacion zyrtar për anëtarësim në BE.

Pas fillimit të negociatave, negociatorët tonë u habitën kur kuptuan se nuk bisedohet shumë për kushtet

e anëtarësimit, por që kjo është më tepër gjendje "prano ose tërhiq". Bashkimi Evropian është klub me rregulla të rrepta. Legjislacioni evropian ka dhjetëra mijë faqe dhe ne nuk jemi në gjendje të imponojmë kushte. Bisedohet vetëm për periudhat kalimtare dhe përjashtimet në pak fusha. Disa politikanë çekë u habitën me gjendjen e këtillë. Kishte ide aq të çmendura, si që është anëtarësimi në Traktatin e Atlantikut verior për tregti të lirë (NAFTA) në rast se BE nuk i pranon kushtet tona. Ide të këtilla të çmendura kishte shumë. Për fat, së shpejti kuptuam se nuk ka opsion tjetër përveç BE-së. Çështja e anëtarësimit në BE u apsolvua dhe arritëm konsensus.

Periudha e negociatave për anëtarësim në BE ishte periudha më e mirë, në aspekt të reformave. Këtu mendoj kryesisht në kushtet që duhej t'i plotësonim në rrjedhën e këtij procesi, që nga viti 1990. Por, puna e vërtetë me reformat filloi me negociatat. Ishte e pabesueshme të shihet si administrata, politikanët dhe Parlamenti ishin në gjendje të miratojnë ligje për mënyrën e punës së shiritit prodhues në kompaninë e motorëve Ford. Mjaftonte të thuhej që kjo është kërkesë e BE-së dhe për ligjin pothuajse nuk kishte diskutim fare pastaj. Kuptohet, kjo praktikë bart në vete edhe efekte negative, si që janë problemet gjatë zbatimit të ligjeve të këtilla. Megjithatë, me problemin e njëjtë u ballafaquan edhe shumë vende tjera. Mirat-

uam mijëra faqe të legjislativës, pa u përgatitur për zbatimin e ligjeve.

Për fat, BE ishte aty për ta përcjellë procesin nga afër. Edhe ne ishim të opsionuar me Progres-Raportin, si edhe ju. E kemi analizuar çdo fjalë, a flitet për perspektivë afatshkurte, mesme ose afatgjatë, a mjafton ajo që e jemi bërë, a është mirë, shumë mirë ose e pranueshme. Duhet të kemi parasysh që përveç plotësimit të kriterëve teknike, ekziston edhe aspekti politik. Për anëtarësim në BE patjetër duhet të ketë vullnet politik dhe për ta arrit këtë, ju duhet të loboni tek shtetet-anëtare. Negociatat e Çekisë u përshpejtuan me ndihmën e dinamikës së grupeve dhe presionit të opinionit. Shtetet që aderojnë çdoherë kanë garuar mes vete. Gazetarët vazhdimisht e krahasonin përparimin në hapjen edhe mbylljen e kapitujve të legjislativës së BE-së. Shpesh herë mund të lexohej që

Republika e Çekisë ka mbyllur 12 kapituj, por Sllovenia ia ka dalë me 16. Ndonjëherë tjetër, Sllovakia ishte në avantazh, kështu që nevojitej punë për t'i arritur sllovakët. Kjo ka ndihmuar shumë - Kroacia ka mungesë të dinamikës së këtyre dhe me po të njëjtën do të ballafaqoheni edhe ju. Prapëseprapë, BE është ajo e cila duhet të ballafaqohet me pozitën negociuese të 27 shteteve-anëtare dhe pikërisht BE është ajo që e dikton procesin.

Më 1 maj 2004, më në fund u kthyem "mbrapa në Evropë" pa dallim faktit që përfitimi më i dukshëm erdhi më vonë, kur në vitin 2008 hymë në zonën Schengen. Që nga ky vit, të gjithë çekët ishin të lirë të udhëtojnë dhe t'i kalojnë kufijtë vetëm me letërnjoftim.

Procesi i anëtarësimit i ka edhe anë negative, si që janë kuptimet e gabueshme të opinionit për kushtet e anëtarësimit në BE. Për shembull, ka ekzistuar një



mit që pas anëtarësimit në BE, do të detyrohemi të heqim dorë nga salsiçet dhe nga rumi jonë special. Qeveria është dashur t'i përmirësojë këto keqkuptime vazhdimisht dhe ka organizuar fushata me të cilat qytetarëve i është shpjeguar BE dhe anëtarësimi.

Njëra prej çështjeve më të ndjeshme gjatë negociatave kanë qenë periudhat kalimtare të lëvizjes së lirë të punëtorëve prej Evropës qendrore dhe lindore në shtetet "e vjetra" anëtare të BE-së. Në negociatat tona, jemi munduar të shpjegojmë që dallojmë nga Polonia dhe vendet tjera baltike, si dhe që ne më tepër atraktojmë punëtorë të huaj (ukrainas dhe moldavë), ngjashëm si edhe Sllovenia. Kjo është treguar si e vërtetë pas anëtarësimit, kur shumë çekë u larguan nga vendi i tyre për të kërkuar punë në ndonjë shtet-anëtar më të vjetër të BE-së. Prapëseprapë, përgjigjja që e pranuar ishte se nuk jemi mjaft të zhvilluar për BE-në dhe pothuajse të gjitha shtetet-anëtare të BE-së (me përjashtim të Britanisë së madhe, Irlandës dhe Suedisë) i kanë mbajtur periudhat kalimtare për të

paktën një vit, kurse Austria dhe Gjermania e mbajtën ndalesën e qasjes së punëtorëve çek në tregjet e tyre të punës. Mbase kjo është arsyeja për të cilën shumë çek ndiheshin si anëtarë të rendit të dytë të Bashkimit Evropian.

Përderisa të gjitha shtetet e reja anëtare luftonin për mënjanimin e kufizimeve të qasjes në tregun e punës, para fillimit të krizës ekonomike, politikanët në Poloni dhe Letoni përnjëherë kuptuan se largimi i njerëzve të shkolluar është problem serioz për ekonominë e tyre, me çka shtetet e tyre mbeten pothuajse pa forcë të kualifikuar pune. Për këtë arsye, në një tryezë të rrumbullakët në Forumin ekonomik të Evropës qendrore, të mbajtur në Krinicë të Polonisë, u fokusuan në temën: Si të ndalet migracioni i vendeve të punës?! Këtu edhe u konfirmua argumenti i Republikës së Çekisë që ne dallojmë prej të tjerëve dhe kjo çështje shkoi në histori.

Anëtarësimi në BE i solli Republikës së Çekisë zhvillim ekonomik. Eksporti në vitin 2004 u rrit për rreth





20%. BPV shënoi rritje dhe çdo vit pas anëtarësimit në BE kemi rritje të BPV-së për 4-5%. Investimet e huaja direkte u rritën dukshëm dhe shkalla e papunësisë u zvogëlua, duke u rritur standardi i jetës. Ndonëse gjendja ekonomike ndryshoi pak me krizën aktuale, veprimet e koordinuara të BE-së kundër krizës i ndihmuan njerëzve të ndihen më të sigurt. Sipas Eurobarometrit, çekët janë mes popujve më optimistë kur flitet për anëtarësim në BE, për shkak se kjo ishte e dobishme për Çekinë.

Europeizimi i shoqërisë çeke ishte përfitimi i cili u bë i dukshëm më vonë. Qytetarët i përshtaten BE-së. Tani kur mund të udhëtojnë lirisht dhe të punojnë më tepër ose më pak, ata janë anëtarë të "klubit" dhe kualifikohen për të gjitha fondet e BE-së, duke qenë më të përgatitur edhe për fondet tjera. Sipas hulumtimeve të fundit të mendimit publik, mbi 70% e çekëve dëshirojnë ta pranojnë Kroacinë dhe shtetet tjera. Nga ana tjetër, procesi i europeizimit ndihet më pak tek elita politike çeke. Qëndrimet e skenës politike ndaj BE-së janë mjaft të polarizuara dhe ato kanë filluar të ndryshohen me kryesimin çek të BE-së. Kryesimi i Çekisë e

ka ndryshuar madje edhe perceptcionin tek politikanët - ata janë më të vetëdijshëm tani për obligimet nga anëtarësimi në BE. Tani shihet që Bashkimi Evropian nuk shihet si çështje e politikës së jashtme, por e asaj të brendshme. Diskutimet për Traktatin e Lisbonës janë dëshmia më e mirë për këtë ndryshim të perceptcionit dhe këto janë prioritetet kryesore në diskutimet e brendshme politike. Republika e Çekisë me siguri do të jetë shteti i fundit që do ta ratifikojë Traktatin e Lisbonës, por me kalimin e kohës do të rritet edhe presioni mbi politikanët dhe Traktati do të miratohet.

Të përfundoj - rruga e Republikës së Çekisë drejt BE-së ka qenë mjaft e rrafshët. Ka zgatur më tepër se që kemi pritur, por nuk ka pasur pengesa të mëdha. Shtetet tjera, si që është Sllovakia, mund të jenë shembull më i mirë për Maqedoninë. Gjëja më e rëndësishme është që anëtarësimi në BE të jetë prioriteti më i lartë, prioriteti numër një! Nëse e bëni këtë, procesi i reformave do të rrjedhë pa pengesa dhe anëtarësimi do të vjen më shpejtë. Kjo do të thotë që do ta kapni trenin e shpejtë për në BE dhe unë i uroj Maqedonisë ta arrijë këtë!

“Për të hyrë në Bashkimin Evropian duhet të shfrytëzoni tre partneritete - vendase, rajonale dhe ndërkombëtare”

AMBASADA E
RUMANISË

Sh. T. D-r Adrijan Stefan
Konstantinesku,
Ambasador



Dëshiroj ta prezantoj pasqyrën e përfundimeve të mia lidhur me përvojën tonë për partneritet strategjik. Mendoj që partneritetet strategjike janë shumë të rëndësishme për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Do të filloj me theksimin e faktit që aderimi në BE është treguar si çdoherë e më i komplikuar dhe koklavitur. Lodhja nga zgjerimi është një zhargon që sot duket shumë i vërtetë. Për të pasur sukses, të gjitha palët duhet të jenë të mençura, të kenë perspektivë të artë për ardhmërinë, të jenë këmbëngulës në ballafaqimin me vështirësitë dhe të jenë fleksibilë në ballafaqimin me sfida, për shkak se ekziston gatishmëri reale për arritjen e kompromiseve pozitive.

Përvoja e Rumanisë e thekson faktin që në zgjidhjen e çështjes së aderimit në BE, partneritetet strategjike duhet të trajtohen si përpjekje të trefishta: partneritetet vendase ose të brendshme, partneritetet rajonale dhe në fund - partneritetet multi-rajonale ose ndërkombëtare. Rëndësinë e tre kategorive të cekura të partneriteteve strategjike do ta theksoj me disa fjalë.

Së pari, partneriteti në vend është më i rëndësishëm dhe dominant. Duhet ta marrim parasysh faktin që aderimi në BE është qëllimi KRYESOR nacional dhe jo NJË prej qëllimeve. E theksoj që është KRYESOR. Për ta bashkuar kombin rreth këtij qël-

limi nacional, nevojitet që: a) të gjithë udhëheqësit politikë t'i lënë anash dallimet ideologjike dhe/ose të alter-egos dhe të flasin me një zë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme; b) mbarë shoqëria civile duhet të jetë e informuar dhe të veprojë në drejtim të njëjtë. Kjo ka qenë përvoja e Rumanisë. Për shembull, të gjitha forcat tona politike janë mbledhur në fillimin e viteve '90 dhe janë përfshirë në të a.q. Strategji Snagov (kompleks turistik afër Bukureshtit). Pa dallim orientimit ideologjik dhe politik të forcave politike, të gjitha janë mbledhur në Snagov për ta shqyrtuar mundësinë e bashkëngjijtes në strukturat euro-atlantike dhe për hartimin e strategjisë gjithëpërfshirëse me qëllim të respektimit të rregullave, parimeve dhe disiplinës së institucioneve gjegjëse. 'Strategjia Snagov' është përshëndetur nga të gjitha partitë politike dhe shoqëria civile - ajo ka ndihmuar në krijimin e zërit të unifikuar për marrëdhëniet relevante për institucionet Euro-Atlantike. Përfitimet e këtij procesi janë: konsolidimi i demokracisë, meqë dialogu ndihmon në arritjen e demokracisë më të mirë; përshpejtimi i reformave ekonomike, meqë strategjia ka ndihmuar në bashkimin e të gjitha forcave produktive dhe akademike për planifikimin dhe realizimin e politikave reformuese; atmosfera më e mirë sociale, për shkak se në kuptimin social ka ekzistuar marrëveshje sociale për arritjen e qël-

limeve për bashkëngjitjen ndaj institucioneve euro-atlantike, si dhe ndjenja e rritur për perspektivë më të mirë dhe mirëqenie më të madhe. Kjo është një prej përfitimeve më të rëndësishme për mbarë shoqërinë, për shkak se në të kundërtën qytetarët nuk janë të bindur për tu përpjekur dhe kryer punë të vështirë të ballafaqimit me sfidat - ky proces është i mbushur me sfida, për të cilat të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm.

Partneritetet rajonale nuk janë më të rëndësishmet, por pa këto partneritete është e paimagjinueshme të ketë avancim të shpejtë të ndonjë shteti dhe për këtë ekzistojnë disa arsye. Bashkimi në ekip me kandidatë tjerë të rajonit i rrit dhe përforcon gjasat për sukses. Duke folur për përvojën tonë, dëshiroj të theksoj se bashkimi në ekip me Bullgari-në ishte shumë i dobishëm, pa dallim strukturave të ndryshme ekonomike dhe orientimeve të dallueshme politike. Pse të mos e shfrytëzoni këtë përvojë dhe të bashkoheni në ekip me ndonjë shtet tjetër, që troket në derën e institucioneve euro-atlantike. Nuk do të cek emra të shteteve, meqë i dini shtetet dhe nivelet që i kanë plotësuar për anëtarësim në institucionet relevante. Në çdo rast, do të theksoj që politikat e shëndosha në një shoqëri multi-etnike janë edhe një kusht ose instrument që e ndihmon rolin rajonal të kombit në sigurimin e paqes dhe stabilitetit. Kjo është shumë e rëndësishme për rolin kontinental të BE-së dhe është shembull i përvojës tonë. Edhe ne kemi pasur probleme të kësaj natyre që kanë kërkuar zgjidhje, ndonëse jo aq të ndjeshme si ato të Maqedonisë.

Të fundit sipas radhitjes, por jo edhe rëndësisë, janë politikat e mira fqinjësore. Ato janë me rëndësi të posaçme dhe të OBLIGUESHME në procesin e

aderimit. Këto janë shembujt e Rumanisë: Ne jemi bashkuar në ekip me Bullgari-në; politika rumune mbi pakicat dhe marrëdhëniet tona të mira ose shumë të mira me fqinjët - besoj që e vërejtët dallimin, të mira OSE shumë të mira. Përfitimet janë të qarta: bashkimi në ekip me Bullgari-në e ka nënkuptuar fuqinë në negociata. Politikat e shëndosha shumë-etnike kanë rezultuar me paqe globale etnike. Ka ekzistuar edhe dukshmëri më e mirë e rolit të Rumanisë si sigurues i paqes dhe roje e kufijve lindorë të BE-së. Kjo është shumë e rëndësishme, për shkak se përveç Finlandës, Rumania e ka kufirin më të gjatë të jashtëm të Bashkimit Evropian. Roli i jonë është të jemi roje kufitare. E di që kjo mund të duket e çuditshme, por në kuptimin e drejtë të fjalës, kjo ka kuptim pozitiv.

Kur flasim për partneritetin pozitiv, që është i rëndësishëm por jo edhe vendimtar, do të theksoj që duhet ta demonstroi rëndësinë e pranimit të një shteti-anëtar në strukturat euro-atlantike (mendoj kryesisht në Bashkimin Evropian) dhe shteti të ketë aktivitet inteligjent në çështjet ndërkombëtare ose globale, në pajtim me politikat dhe aktivitetet e BE-së në fushat relevante. Me fjalë tjera, të mos keni pikëvështrime ose qëndrime të ndryshme, të cilat mund ta zvogëlojnë ose t'i kundërshtojnë veprimeve të BE-së në forumet gjegjëse.

Gjëja e dytë e rëndësishme është i a.q. sponsorim nga një ose më tepër anëtare më të vjetra dhe më të fuqishme të BE-së. Shembujt nga përvoja jonë janë këto: sa i përket aktivizimit në çështjet ndërkombëtare dhe globale, që në fazën e shtetit-kandidat ne jemi bashkuar ose i kemi mbështetur nismat e BE-së në forumet ndërkombëtare. Për shembull, në Kombet e Bashkuara, Organizatën tregtare botërore, Fondin monetar ndërkombëtar, Bankën botërore, etj.

Me fjalë tjera, ne jemi dakorduar me BE për politikë, pikëvështrimet dhe qëndrimet e përbashkëta në këto forume para anëtarësimit, me çka e kemi shprehur të a.q. patriotizëm rajonal, në një mënyrë të shprehjes. Ky kombinim është i çuditshëm, por tregon që çdo shtet-kandidat duhet të dëshmojë se i takon klubit para se të bëhet anëtar "fuqplotë". Shembull tjetër joformal është sponsorimi francez i Rumanisë dhe sponsorimi gjerman i Bullgarisë. Këto dy shtete të vjetra dhe të fuqishme i kanë ndihmuar Rumanisë dhe Bullgarisë në avancimin drejt anëtarësimit në BE. Partneritetet ndërkombëtare mund të kontribuojnë në përkrahjen më të madhe dhe pozitive dhe profilin e përmirësuar të shtetit në BE. Në procesin e dakordimit të legjislativës, mund të ekzistojë edhe ndihmë instrumentale dhe teknike, financiare dhe politike.

Të përfundojmë. Cilat janë pasojat ose përfitimet nga partneritetet e këtilla trefishta? Do t'i cekim në radhitje kronologjike, sa i përket Rumanisë. Së pari, plotësimi i kriterëve të Kopenhagës ose kriterëve politike për kualifikim për anëtarësim në BE. Së dyti,

futja e ekonomisë funksionale të tregut, që është një kusht tjetër i rëndësishëm dhe pa të cilin nuk mund të shpresoni për anëtarësim në Bashkimin Evropian, për shkak se kjo e dëmton ekonominë. Së treti dhe e fundit, fillimi i negociatave për aderim në bazë të plotësisht të kushteve të cekura politike dhe ekonomike. Do të përfundoj këtu me shpresë që raporti vijues do ta nënvizojë gatishmërinë e dy palëve të prekura për fillimin e negociatave, gjegjësisht BE-së dhe Maqedonisë. Kjo është shumë e rëndësishme - pas përfundimit të negociatave, duhet të garantohet vullneti politik për finalizimin e tyre. Pa përfundim të negociatave dhe pa vullnet politik të shteteve-anëtare për ratifikimin e rezultateve të negociatave, të gjitha përpjekjet janë të kota.

Në fund, dëshiroj edhe një herë t'i bind të gjithë që Rumania është e gatshme dhe ka vullnet për mbështetjen e Maqedonisë në përpjekjet e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe NATO. Në këtë mënyrë dhe me qëndrimin e shprehur, dëshiroj ta konfirmoj miqësinë dhe përkrahjen tonë.





“Dialogu me shoqërinë civile është partneriteti strategjik i brendshëm”

AMBASADA E
REPUBLIKËS
SË SLLOVAKISË

Sh. T. D-r Robert Kirnag,
Zavendësi i punëve ambasador



Kur flasim për partneritetet strategjike, dëshiroj të përqendrohem në tre lloje të partneriteteve të mundshme - partneritetet e formuara para anëtarësimit në BE, por ekzistojnë edhe partneritete që krijohen ekskluzivisht në hapjen e negociatave për anëtarësim dhe negociatat si të tilla nuk janë qëllim shumë ambicioz. Përkundrazi, ju duhet të koncentrohemi në mënyrën e funksionimit dhe komunikimit si shtet-anëtar, për shkak se koha do të kalojë dhe do të bëheni anëtare e Bashkimit Evropian pa e vërejtur atë. Një prej partneriteteve strategjike që e kemi pasur parasysh në Sllovaki mund të jetë më afër realizimit të këtij qëllimi.

Në fillim, më lejoni tu tregoj se cilat lloje të partneritetit i kemi pasur në Sllovaki para anëtarësimit në BE. Në plan të parë, ka ekzistuar partneritet mes ministrive në Qeveri. Në fillim, të gjitha ministrinë kanë menduar se BE është pjesë e politikës së jashtme, kështu që Ministria e punëve të jashtme duhet të jetë përgjegjëse. Ministria e ka krijuar strukturën për komunikim dhe më pas e ka shumëzuar atë në të gjitha ministrinë gjegjëse. Pas kësaj kemi mbajtur diskutim ose komunikim mes ministrive gjegjëse, kabinetit dhe zyrës së Qeverisë, me qëllim të koordinimit të pjesëmarrjes në procesin e vendim-marrjes, ku Ministria e punëve të jashtme ka qenë sërish e ngarkuar me prezantimin e qëndrimeve të miratuara.

Në plan të dytë, ka ekzistuar partneriteti në kuadër të administratës. Ky partneritet është mes më të rëndësishmeve, njëherazi edhe kriteri i vështirë për Maqedoninë, e cila duhet ta reformojë administratën e saj publike. Leksioni

që e kemi mësuar thotë se gjatë reformës së administratës, bëheni këtë në drejtim të përgatitjes sa më të mirë për funksionimin si shtet-anëtar i BE-së. Nëse tani nuk e reformoni administratën tuaj publike dhe krijoni struktura dhe procedura gjegjëse, kjo vështirë mund të bëhet në ardhmëri dhe pa përgatitje gjegjëse, administrata mund të shndërrohet në pengesë. Kjo është përvoja e jonë dhe ne jemi këtu për t'i këmbyer sukseset dhe leksionet tona, të cilat mund të jenë më frymëzuese, për shkak se do tu tregojnë si t'i evitoni gabimet që i kemi paguar shtrenjtë. Komunikimi mes ministrive, Qeverisë dhe misionit tonë në Bruksel dhe funksionimi adekuat i administratës janë treguar shumë të rëndësishme. Në Misionin në Bruksel, sot kemi vetëm 91 sllovakë. Të gjitha ministrinë përfaqësohen në Mision dhe 20% e të gjithë diplomatëve sllovakë gjenden në Bruksel. Është e rëndësishme që të gjithë këta të koordinohen mirë.

Niveli i tretë përbëhet nga të gjitha partneritetet tjera të brendshme, si që janë partneritetet me partnerët socialë, shoqatat afariste, etj. Këto partneritete nevojiten për në ardhmëri, për shkak se nuk do të mund t'i kuantifikoni pasojat e vendimeve të caktuara, si për shembull vendimin për lëshimin e CO2. Qeveria ndoshta nuk do të dijë se çka do të thotë ky vendim për industrinë automobilistike, por disa biznese do të kenë mundësi për kuantifikim të saktë të pasojave - ata e dinë sa do të kushtojë kjo dhe a do të jenë në gjendje t'i përshtaten vendimit. Miratimi i legjisllacionit është i lehtë, vetëm e ngrisni dorën dhe direktiva miratohet. Por, bizneset do të kenë pasoja nga kjo, do të duhet të lëshojnë njerëz nga puna nëse gjërat nuk ecin si duhet. Për këtë arsye, punëdhënësit, sindikatat dhe dialogu social kanë rëndësi esenciale. Kriza



ekonomike na ka treguar që është e rëndësishme të kemi komunikim dhe kuptim të mirë, ndonëse ekzistojnë fusha në të cilat nuk dakordohemi. Ne e kemi kaluar mbarë procesin: i kemi shkatërruar sindikatat dhe na është dashur ta ndërtojmë sërish dialogun social. Për ta zgjeruar partneritetin e brendshëm dhe që të arrij në momentin e partneritetit strategjik me Maqedoninë, do të them që gjatë vizitës së fundit të Ministrit të Maqedonisë për punë në konferencën e përmbylljes së një projekti shumë të suksesshëm dypalësh (tuining) për shqyrtimin e legjislacionit nacional për marrëdhëniet e punës, dy ministrat u dakorduan të hyjnë në një fushë shumë të ndjeshme - përkrahjen e zhvillimit të dialogut social në Maqedoni. Nuk është e lehtë për sindikatat ose Qeverinë që t'i qasen të gjithëve. Megjithatë, është e rëndësishme që në këtë kohë të krizës të ketë paqe sociale në këto periudha të krizës. Me fjalë të thjeshta, kjo do të thotë se sindikatat nuk i bëjnë presion bizneseve për rritjen e rrogave mbi nivelin e rritjes së prodhueshmërisë, si që ndodh në Sllovakia.

Ekzistojnë edhe shumë partneritete tjera të rëndësishme, që krijohen brenda shtetit. Partneritete strategjike janë lidhur edhe me universitetet, qendrat hulumtuese, OJQ-të, etj. Ky partneritet strategjik është dialog me shoqërinë civile dhe kjo ka rëndësi të posaçme, për shkak se ky partneritet është në interes të të gjitha palëve të interesuara dhe për këtë arsye Qeveria ka interes ta mirëmbajë atë.

Sllovakia është e gatshme t'i përkrahë aktivitetet si që është krijimi i forumit për dialog me shoqërinë civile, në mënyrë të ngjashme me forumin tonë. Kjo është platformë e strukturuar, jo institucion por platformë mbarëpërfshirëse për debat mbi Bashkimin Evropian. Ne i kemi filluar këto aktivitete para fillimit me Konventën evropiane. Konventa nacionale sllovaqe për çështjet e lidhura me BE-në nuk është

ndërprerë me draftin e parë të Kushtetutës. Përkundrazi, ne e kemi përkrahur këtë proces, të cilin e kemi realizuar me sukses në Bosnjë dhe Hercegovinë. I njëjti është filluar nga një organizatë joqeveritare në Serbi. Një vit pas përkrahjes së siguruar përmes zyrës tonë për zhvillim, gjegjësisht Fondit sllovak për ndihmë, Komisioni e ka ndërmarrë procesin dhe tani e përkrahë këtë projekt. Të gjithë aktorët që i ceka janë pjesë e projektit.

Në planin e jashtëm - kur jeni në proces të anëtarësimit, duhet të krijoni partneritete strategjike me shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian. Çdoherë duhet të gjeni miq tek shtetet-anëtare që do të jenë të gatshëm të luftojnë për interesat tuaj. Si vend i vogël, ju mund të jeni të suksesshëm vetëm nëse jeni mjaft partnerë, për ta krijuar të a.q. koalicion për ndryshim. Do të duhet t'i bashkëngjiteni një ose dy "shteteve të mëdha" për shkak se pa ato, nuk do të jetë e lehtë të realizohet ky koalicion. Kjo nuk do të thotë që nuk mund të loboni për anëtarësimin tuaj. Përkundrazi, duhet ta kryeni detyrën tuaj të shtëpisë, ta projektoni imazhin e nxënësit të mirë dhe t'i lejoni partnerëve ta kryejnë punën e tyre dhe ta lehtësojnë promovimin e interesave tuaj dhe hapjen e procesit tuaj për anëtarësim.

Kam pas kënaqësi të dëgjoj që organizuesit e "Aksionit për Evropë" do të organizojnë konferencë me pjesëmarrësit spanjollë të martën e ardhshme. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të punoni me shtetet që do ta kenë Kryesinë e radhës të Bashkimit Evropian. Spanja nuk ka interes të posaçëm për shtetet e Ballkanit perëndimor. E njëjta vlen edhe për Belgjikën dhe Hungarinë (partnerët e treshes kryesuese). Por, ju keni nevojë për partneritetin e tyre, për shkak se ata e caktojnë agjendën e ardhshme të BE-së. Këtë proces patjetër duhet ta mbajmë në jetë, madje edhe me shtetet që ndoshta

50 години ЕУ во светот

Пронајдете се дел од проектот: АКЦИЈА ЗА ЕВРОПА



nuk janë këtu. Jam i vetëdijshëm që nuk kam korrektësi politike kur e them këtë, por e di që kam të drejtë.

Tani do të ndalem tek lloji i dytë i partneriteteve - mes Sllovakisë dhe Maqedonisë. Në rrafshin politik, ne e përkrahim procesin e anëtarësimit në shumë mënyra. Sllovakia ka qenë pjesë e grupit që kanë ushtruar presion në kuadër të Bashkimit Evropian, të a.q. Grupit të Talinit, që ka luftuar për hapjen e kufijve dhe ne e kemi të njohur këtë ndjenjë. Ne nuk kemi mund të udhëtojmë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në nëntorin e vitit të kaluar, madje edhe kjo nuk u dha e gatshme. Tani duhet të komunikojmë me qytetarët tonë që të mos qëndrojnë tepër gjatë, të mos e keqpërdorin mundësinë. Nëse ndodh keqpërdorimi, nëse njerëzit nuk i respektojnë rregullat, udhëtimi pa viza mund të ndërpritet një ditë dhe kjo do të paguhet prej shumicës së njerëzve. Së këndejmi, liberalizimi i vizave është shumë i rëndësishëm dhe ne presim shumë këmbime mes Sllovakisë dhe Maqedonisë. Në fund, presim zhvillim të bizneseve dhe për këtë arsye e kemi ftuar Kryeministrin tuaj për vizitë në Sllovaki. Ai duhet të sjellë një delegacion të madh, tashmë kanë aplikuar 22 kompani për pjesëmarrje në forumin e biznesit dhe ky është delegacioni i parë i këtij lloji që e viziton Sllovakinë 10 viteve të fundit.

Partneritetet tjera janë partneritetet për shfrytëzimin e fondeve evropiane, të a.q. projekte dypalëshe ose tuining. Më lartë e ceka projektin Shqyrtimi i legjislacionit nacional për marrëdhëniet e punës. Dialogu social mund të jetë projekti i ardhshëm dhe ne tashmë kemi diskutuar me kolegët tonë nga Holanda, pse të mos kemi një projekt trepalësh mes një shteti-anëtar, një shteti anëtar të ri dhe një shteti-kandidat. Një temë tjetër mund të jetë decentralizimi, për shembull. Kur ju tregoj njerëzve që komunat tona marrin 70% të TVSH-së, ata befasohen. Por, ato mjete nuk fitohen pa mund - komunat duhet të ushtrojnë disa injerencia. Përveç kësaj, një fushë tjetër konkrete që mund të jetë e rëndësishme për Maqedoninë është realizimi i Direktivës së Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të punësuarve nga josalvenca e punëdhënësve. Nëse ndonjë kompani bankroton, si që ka ndodhur me kompanitë tuaja pas privatizimit, njerëzit

duhet të mbrohen që të mos mbesin në rrugë pa asnjë mbrojtje. Kjo çështje është shumë e rëndësishme.

Në fund, ekziston edhe ndihma zyrtare për zhvillim. Sllovakia është aktive në këtë fushë, në Ohër e kemi projektin "Relma" me të cilin përkrahen tregjet lokale dhe rajonale të punës - afaristët, Komuna e Ohrit, nëpunësit e Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Ministrisë së ekonomisë, të cilëve ju është prezantuar përvoja sllovaqe. Delegacioni sllovak i biznesmenëve të vegjël të vetë-punësuar e kanë vizituar rajonin e Ohrit dhe vizita e tyre ka qenë shumë e kënaqshme. Ata e kanë pëlqyer verën e Maqedonisë dhe mbi të gjitha, janë njohur me partnerët dhe kanë krijuar partneritete strategjike dhe kjo duhet mbindërtuar. Fillojmë edhe një projekt që duhet të sigurojë mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në kuadër të projektit, do të hapen katër qendra në Maqedoni, të cilat do t'i përkrahin njerëzit që dëshirojnë të fillojnë ndonjë biznes. Ata kanë ide të mira, por nuk kanë të holla. Vijnë në qendër, e regjistrojnë kompaninë dhe marrin ndihmë për hartimin e planit afarist, zbulojnë ku mund të fitojnë të holla dhe marrin informata për fondet evropiane, huat komerciale nga bankat, borxhet e sponsoruara nga Qeveria dhe të tjerat. Njëra qendër do të jetë në Negotinë, meqë gjatë takimit tim të parë në Negotinë, si pjesë e projektit "Aksioni për Evropë" e vizitova Kryetarin e komunës dhe jemi miqësuar dhe kemi mbetur miq të mirë. Qendra e dytë do të hapet në Manastir, e treta në Shkup dhe e fundit në Ohër, për shkak të bashkëpunimit të mirë me Komunën e Ohrit. Ekzistojnë edhe aktivitete tjera që realizohen në kuadër të punëve zyrtare evropiane. Shpresoj që vitin e ardhshëm, në shkurt, do të fillojë edhe programi për minigrante, të cilat janë në vlerë deri në 5.000 euro dhe që janë treguar shumë të rëndësishme për bashkësitë e vogla, me qëllim të fillimit të projekteve të vogla. Kuptohet, do të ketë prioritete që ne i konsiderojmë si të rëndësishme dhe do të konsultohemi me ju para përcaktimit të listës finale.

Si që mund të shihni, kam identifikuar shumë fusha ku mund të ndërtohen partneritetet strategjike. Të gjitha këto fusha janë të rëndësishme, pa dallim a janë të brendshme ose të jashtme. Jemi këtu për tu ndihmuar në fushat që mendoni se janë të dobishme për ju.

“Liberalizimi i vizave duhet të komunikohet në mënyrë adekuate me qytetarët”

QENDRA MAQEDONASE
PËR ARSIM EVROPIAN

Lidija Dimova,
Drejtoreshë ekzekutive



Liberalizimi i vizave është mbase një prej temave më aktuale në Republikën e Maqedonisë. Qytetarët shpresojnë që së shpejti do të mund të udhëtojnë në shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe vendet tjera të sistemit Shengen. Për momentin, Republika e Maqedonisë përparon mirë në plotësimin e kushteve për marrjen e të drejtës për të qenë në të a.q. Shengen listë të bardhë. Mediat informojnë vazhdimisht për liberalizimin e vizave, për procedurat që duhet plotësuar, por është e qartë që mungon fushata e mirëfilltë e Qeverisë, me të cilën do të njihen qytetarët me përfitimet, por edhe obligimet e udhëtimit pa viza.

Për ta kuptuar më mirë liberalizimin e vizave, ndoshta duhet të kthehemi në qershorin e vitit 2003, kur në Samitin e Selanikut u miratua e a.q. Agjenda e Selanikut nga kryesia e atëhershme greke e BE-së. Kjo kryesi kishte rëndësi të veçantë, jo vetëm për Republikën e Maqedonisë, por edhe për mbarë Ballkanin perëndimor, meqë BE për herë të parë shpalli që ardhmëria e shteteve të rajonit është në BE dhe që Procesi i stabilizimit dhe asociimit do të jetë korniza (ose strategjia) me të cilën do të zgjerohet BE në këto vende.

Nga përvoja maqedonase e dimë që strategjia pa instrument implementimi është vetëm shkronjë letre, që më së shpeshti përfundon në ndonjë sirtar.

Agjenda e Selanikut ka qenë diçka më tepër, meqë ka paraparë disa nisma dhe mundësi të reja financiare. Përveç hapjes të të a.q. Programe të bashkësive, TAEX instrumentit dhe programeve-tuining për shtetet e Ballkanit perëndimor, Agjenda e Selanikut e ka paraparë edhe zgjerimin e CEFTA-së, zbatimin e Kartës evropiane për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe liberalizimin e famshëm të vizave.

Në fazën e parë, liberalizimi i vizave ka paraparë lehtësim të vizave, përmes lehtësimit të procedurës për marrjen e vizës për udhëtim në Shengen-zonën. Faza e dytë e parasheh plotësimin e disa kritereve të përcaktuara nga Komisioni Evropian në dokumentin e quajtur Udhërrëfytesë për liberalizimin e vizave.

Ky dokument i ka përcaktuar detyrat që duhet plotësuar nga Republika e Maqedonisë, për marrjen e regjimit për udhëtim pa viza. Detyrat e caktuara grupohen në disa fusha dhe pas konstatimit nga Komisioni Evropian që kriteret janë plotësuar, ajo do të rekomandojë udhëtim pa viza. Vendimi final do të miratohet nga Këshilli për drejtësi dhe punë të brendshme të BE-së, me 2/3 e votave.

Komisioni Evropian ka përgjegjësi të jashtëzakonshme këtu. Hapja e kufijve për udhëtim të lirë e nënkupton edhe hapjen e kufijve për lëvizje më të lirë të kimit dhe kontrabandës, kështu që BE duhet t'i bindë shtetet-anëtares që me plotësimin e kritereve,



BE nuk duhet të frikohet për rreziqet ndaj sigurisë së saj. Cilat janë këto rreziqe, nga të cilat frikohet Bashkimi Evropian? Së pari, frika nga zhvendosja masive e qytetarëve të Ballkanit perëndimor në BE, pa dallim arsyeve - për punësim ose kërkim të azilit politik. Gjithashtu, BE duhet të dijë patjetër që i ka të gjitha informatat e nevojshme për shtetasit që udhëtojnë në Ballkanin perëndimor dhe që do të kthehen qytetarët që kryejnë vepra kundër ligjit, në shtetin e tyre ose në shtetin prej ku kanë ardhur, nëse nuk i kanë dokumentet e nevojshme.

Nëse e shqyrtojmë Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave të Komisionit Evropian, do të shohim që këto janë kërkesat që i imponohen shteteve të Ballkanit perëndimor - kërkohet që shtetet të kenë të a.q. menaxhim të integruar kufitar, t'i kenë nënshkruar marrëveshjet për riatdhesim, të kenë pasaporta biometrike, të kenë qendër për viza dhe t'i garantojnë

të drejtat themelore të çdo qytetari. Tani, të shohim çka nënkuptojnë këto kërkesa në esencë.

Çka janë pasaportat biometrike dhe pse nevojiten ato? Pasaportat biometrike kanë çip të integruar me të gjitha informatat e rëndësishme për personin që udhëton. Të dhënat mbahen në data-bazë të posaçme, të lidhur me Sistemin informativ Shengen të BE-së. Kjo do të thotë që në momentin kur e kalon kufirin, bartësi i pasaportës biometrike ia jap vullnetarisht informatat personale organeve të shtetit ku udhëton. Nëse shteti është pjesë e Sistemit informativ Shengen - këto informata i kanë edhe të gjitha shtetet tjera të sistemit.

Menaxhimi i integruar i kufijve është një sistem tjetër, me të cilin përcillen personat që hyjnë/dalin nga territori i shteteve tjera dhe lidhet me lëvizjen e lirë të kamionëve të ngarkuara me mallra. Kur një kamion hyn në territorin e Maqedonisë, për shembull me



sheqer, regjistrohet koha e hyrjes-daljes nga Maqedonia. Nëse ngarkesa dedikohet për ndonjë shtet tjetër, në dalje të Maqedonisë do të dihet saktë ku dhe sa gjatë është ndalur kamioni dhe nëse është ndalur më shumë nga koha e parashikuar (për ta shkarkuar mallin-kontrabandë), autoritetet kufitare do të dinë që kamioni është i dyshimtë dhe ai mund të kontrollohet. Kështu, lehtësohet puna e organeve kufitare dhe lehtësohet ballafaqimi me kontrabandën.

Për menaxhimin e integruar kufitar është e rëndësishme që të ketë investime të mëdha në pajisjen e pikë-kalimeve kufitare. Duke qenë e vetëdijshme për këtë, Komisioni Evropian ka siguruar mjete të mjaftueshme, fillimisht përmes programit CARDS dhe pastaj përmes IPA për rrumbullakosjen e menaxhimit të integruar kufitar. Nëse e shohim ndihmën e BE-së për Maqedoninë, do të shohim që për këtë qëllim janë siguruar miliona euro nga CARDS 2003, 2004,

2005, 2006 dhe IPA 2007, 2008, madje edhe nga programet rajonale. Së këndejmi, është e gabueshme të thuhet që liberalizimi i vizave është siguruar nga ndonjë qeveri, meqë në pjesën e menaxhimit të integruar kufitar punohet që nga viti 2002.

Respektimi i të drejtave themelore qytetare është kushti tjetër që duhet plotësuar nga shtetet. Komisioni Evropian nuk e bën këtë për t'ia vështirësuar jetën e organeve në rajon, por udhëhiqet nga fakti që e drejta e dokumentacionit (mes tjerash, pasaportës) është e drejtë themelore e njeriut. Për këtë, nuk befason fakti që prej shteteve të Ballkanit perëndimor kërkohet t'i mundësojnë të gjithë qytetarëve të kenë qasje në dokumente dhe t' miratojnë Ligjin për anti-diskriminim. Në Maqedoni, për shembull, ka shumë qytetarë të bashkësisë rome që aspak nuk janë evidentuar në sistemin e regjistrimit, të mos flasim për pasaporta. Ligji për anti-diskriminim kërkohet për

të mos ardhur kërkesat masive për azil politik në shtetet-anëtare të BE-së, për shkak se Ligji dëshmon që qytetarët gëzojnë të drejta të njëjta politike, si edhe të gjithë qytetarët tjerë. Republika e Maqedonisë ende nuk e ka miratuar këtë ligj, për shkak të ndjeshmërisë së çështjes së orientimit seksual, por pasojat nga kjo mund të jenë më dramatike, nëse shkaktohet kërkesa masive e azilit nga shtetasit e Maqedonisë pas liberalizimit të vizave.

Nënshkrimi i marrëveshjeve për riatdhesim rrjedh si obligim nga Marrëveshja për stabilizim-asociim dhe me këto marrëveshje, BE mbrohet nga personat që hyjnë në territorin e saj pa dokumente dhe kërkojnë azil politik. Është e njohur që shumë njerëz hyjnë në BE pa dokumente (ose me dokumente, por i humbin qëllimisht pas hyrjes në BE) dhe kërkojnë pa bazë azil politik. Nëse personat e këtillë janë pa dokumente, BE i kthen në shtetin prej ku kanë ardhur, sipas marrëveshjeve të nënshkuara për riatdhesim. Shteti ku ata kthehen i vendos në të a.q. qendër për viza dhe prej atij momenti, këta persona nuk janë problem i BE-së, por i shtetit prej ku kanë ardhur. Ndoshta duhet të ceket edhe ekzistimi i një instituti tjetër evropian, që njihet më pak - Evrodag, që është institucioni evropian që i administron shenjat e gishtërinjve të azil-

kërkuesve. Ky institut është themeluar për parandalimin e mundësisë që azil-kërkuesit të udhëtojnë dhe të kërkojnë azil nga njëri shtet i Shengenit në shtet tjetër. Praktikisht, kjo do të thotë që kur kërkojnë një herë azil, shenjat e gishtërinjve të tyre dhe të dhënat do t'i jepen të gjitha shteteve-anëtare të Shengenit.

Kjo tregon që liberalizimi i vizave është politikë e menduar mirë nga BE, për shkak se rreziku për BE-në është pothuajse zero. Rreziku është shumë më i madh për shtetet e Ballkanit perëndimor, kështu që liberalizimi i vizave duhet të komunikohet në mënyrë gjegjëse me qytetarët, që edhe ata t'i kuptojnë përfitimet, por edhe rreziqet. Nuk ka asnjë dyshim që Qeveria do të gjejë mënyrë për promovimin e udhëtimit pa viza dhe do të ishte e pahijshme që të mos e shfrytëzojë rastin dhe të tregojë, për të satën herë, që ajo punon 24/7 dhe që "realizon". Por, liberalizimi i vizave e nënkupton edhe edukimin e opinionit për të drejtat dhe obligimet e saj. Në të kundërtën, ekziston rreziku për reputacionin e Maqedonisë.

Mbetet të shpresojmë që Republika e Maqedonisë do ta fitojë liberalizimin e vizave dhe që qytetarët do të jenë më të vetëdijshëm se Qeveria, që të mos e lëshojnë vendin masovikisht.

“Forumi i hapur për diskutim është shumë më i rëndësishëm për procesin sesa qeveria”

ASOCIACIONI I
SLLOVAKISË PËR
POLITIKË TË JASHTME

M-r Zuzana Lisinova,
Bashkëpunëtoreshë për
hulumtim dhe koordinatore
e projekteve



Dëshiroj ta ndaj me ju përvojën sllovae nga një partneritet tjetër, që ka qenë shumë i rëndësishëm për procesin e anëtarësimit tonë, si që është i rëndësishëm tani, për në BE. Me qëllim të përgatitjes, krye-negociatori i jonë dhe komisionari i parë, Z. Jan Figel inicioi platformë institucionale, nën udhëheqjen e Ministrisë për punë të Jashtme, me qëllim të diskutimit dhe koordinimit të përpjekjeve për anëtarësim në BE. Disa ekspertë dhe shumë pjesëmarrës janë ulur së bashku për t'i këmbyer mendimet për procesin e anëtarësimit. Me kalimin e kohës, përfunduar që debati duhet të strukturohet, të përfshijë sektorë të ndryshëm dhe ta përgatisim diskutimin, si dhe të caktojmë disa rregulla. Në fund, kemi përfunduar me projektin e plotë, të njohur si Konventa nacionale për Bashkimin Evropian. Projekti e ka përfshirë edhe angazhimin e shoqërisë civile në përpjekjet e Sllovakisë për lehtësimin e procesit të anëtarësimit, si dhe përgatitjen e Sllovakisë për anëtarësimin e ardhshëm.

Debati për procesin e integritimit evropian mund të shihet si proces politik dhe diplomatik, por vetëm nëse e vështroni nga aspektet burokratike. Për ta evituar këtë gjendje, është shumë e rëndësishme të mblidhni sa më tepër njerëz dhe të diskutoni për sa më shumë çështje. Për këtë arsye, vendosëm që projekti të ketë tre shtylla kryesore. Së pari, duhej

të vijnë përfaqësuesit qeveritarë, meqë ata janë përgjegjës dhe i kanë informatat më të reja dhe më profesionale. Së dyti, përfaqësuesit e parlamentit - pa dallim a janë nga pozita ose opozita, ata kanë përgjegjësi si të zgjedhur nga trupi votues dhe i miratojnë aktet e nevojshme ligjore. Shtylla më e madhe është sektori joqeveritar. Kemi besuar që në proces patjetër duhet të dëgjohet zëri i komunave dhe qyteteve të vogla. Ka qenë e nevojshme të përfaqësohen të gjitha organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, pa dallim a sigurojnë shërbime sociale, kujdes për të vegjlit ose merren me çështjet e politikës së jashtme, si që është rasti me asociacionin tonë. Ne, qytetarët jemi shumë të rëndësishëm, jemi pjesa më e madhe e shoqërisë dhe kemi të drejtë t'i zgjidhim këto çështje për shkak se anëtarësimi në BE krijon kushte për jetën tonë të përditshme. Tashmë edhe për ju, me avancimin në integrim, edhe ju do të duhet të përshtatni me gjërat e ndryshme.

Këto tre shtylla u prezantuan nga personalitete të rëndësishme, si Zëvendës-Kryeministri, Ministri për punë të jashtme ose Kryesuesi i Komitetit parlamentar për integrim evropian, me qëllim që të bëhen më të pranishme. Ka qenë shumë e rëndësishme dhe e dobishme që të përfshihen ekspertë, si që janë akademikët, profesorët dhe ekonomistët,

përfaqësuesit e sindikatave, sipërmarrësit e vegjël, nëpunësit e ministrive të ndryshme, etj. Të gjithë këta u shoqëruan në grupe të vogla pune prej 5-30 anëtarësh, varësisht nga tema e diskutuar në mbledhje. Në fund formuam 11 grupe të ndryshme pune që i trajtonin dhe debatonin rreth çështjeve shumë konkrete të politikës ekonomike, si që është anëtarësimi në euro-zonën. Sllovakia sivjet u bë anëtare e euro-zonës, por debatet dhe përgatitjet u përfunduan gjatë viteve të kaluara. Në kuadër të këtij projekti diskutohej edhe për shkencën, kulturën dhe arsimin, meqë kemi besuar se duhet të gjejmë tema të rëndësishme për qytetarët dhe mënyrën në të cilën e shohin Evropën. Çështjet për bujqësinë, mjedisin jetësor dhe politikën jetësore kanë qenë pjesë e rëndësishme e diskutimit, si dhe diskutimet si t'i shpenzojmë të hollat nga Bashkimi Evropian dhe shtetet tjera anëtare ose si t'i zhvillojmë rajonet dhe politikat tona me këto mjete. Në kuadër të politikës rajonale dhe veçanërisht lidhur me fondet e BE-së, e kemi pasur shembullin më të mirë për ta treguar rëndësinë e diskutimeve të këtilla, meqë njerëzit e grupeve të ndryshme takoheshin, diskutonin me orë dhe hartonin rekomandime për qeverinë. Qeveria i përgatiste dokumentet që pastaj i prezantoheshin Brukselit për rregullat e shpenzimit të hollave tona, si dhe zhvillimit të shtetit tonë. 70% e rekomandimeve të strategjive dhe dokumenteve finale të hartuara nga ekspertët tonë në Konventën nacionale u realizuan në tekstet finale të Qeverisë. Kjo ka qenë sukses i jashtëzakonshëm - sindikatat dhe komunat ose cilido aktor tjetër në shoqëri nuk do të kishte shënuar sukses me veprim të ndarë. Në Konventat nacionale, ne ishim së bashku me funksionarët qeveritarë, deputetët dhe sektorin joqeveritar.

Rregulli kryesor ka qenë që çdo grup i punës takohet 4 herë në vit. Para takimit, ekspertët e hartonin agjendën dhe dokumentet që analizoheshin më pas nga anëtarët e grupit punues, i cili diskutonte dhe i jepte rekomandime finale Qeverisë. Ndonëse diskutimet ishin shumë të gjëra në shumë raste, nuk kishim mundësi ta përfshijmë tërë opinionin publik për shkaqe logjistike, kështu që i angazhuam mediat. Pas çdo sesioni të grupeve punuese, organizonim konferencë të vogël shtypi ose mëngjes me gazetarët, në të shumtën e rasteve. Gazetarëve ua tregonim detajet interesante - ndikimin nga realizimi i direktivës për ujë në buxhetin e qyteteve të vogla në Sllovakinë e mesme. Këto gjëra ishin të rëndësishme për jetën e përditshme të njerëzve dhe rajoneve. Një çështje tjetër që u shfrytëzua nga Konventa nacionale si vegël komunikative dhe përfshirjen publike ka qenë ueb-faqja. Versioni sllovak i saj ekziston edhe sot e kësaj dite.

Meqë kishim disa tema të ndryshme, gjatë projektit kishim edhe partnerë të ndryshëm. Ministria e punëve të Jashtme e Republikës së Sllovakisë ka qenë partner shumë i rëndësishëm, madje kyç, për shkak se kjo ministri i ka koordinuar të gjitha çështjet e lidhura me BE. Qeveria e Republikës së Sllovakisë ishte gjithashtu e rëndësishme, për arsye administrative. Shpejtë zbuluam që ka interes edhe nga jashtë - Delegacioni i Komisionit Evropian në Sllovaki u përfshi në aktivitetet tona. Kishim përkrahje të madhe edhe nga Ambasada e Britanisë. Projekti ishte mjaft interesant edhe për partnerët tonë, Lëvizjen evropiane në Serbi, me të cilët e krijuam projektin e njëjtë. Meqë gjendja në shtetet-kandidate dallonte, në Serbi kishte nevojë për krijimin e grupeve të ndryshme të punës, ku u formuan grupe pune për kushtet politike dhe institu-





cionet vendase, por edhe për bashkëpunim rajonal, kapital dhe shërbime, mallra, bujqësi, si dhe për liri dhe siguri. Këto projekte nuk u përkrahën vetëm nga ndihma sllovaqe (ndihma zyrtare zhvillimore), por më vonë fituan përkrahje edhe nga Komisioni Evropian. Mund të them që anëtarët e Parlamentit serb ishin pjesëmarrës në përgatitjen e rekomandimeve për Konventën nacionale të Qeverisë serbe. Një projekt tjetër ishte Konventa nacionale në

Bosnjë dhe Hercegovinë, ku çështjet kryesore ishin ekonomia, bujqësia dhe bashkëpunimi rajonal. Ne i këmbuem përvojat tona me ata. Ekspertët sllovakë që ishin pjesë e Konventës sllovakë tani punojnë në Konventën nacionale në Bosnjë, ku marrin pjesë në takime dhe e këmbajnë përvojën e tyre në tema të reja, si që është sektori i teknologjisë dhe shoqërisë informatike.

“Ne kemi nevojë për qytetarë dhe media kritike, kemi nevojë për shoqëri qytetare që është e interesuar dhe angazhuar”

ABASADA E
REPUBLIKËS SË
LIDHJES TË
GJERMANISË

Sh. S. Znj. Ulriche Marija Knoc,
Ambasadore



Më lejoni ta prezantoj politikën gjermanë për integrimet evropiane, gjegjësisht politikën gjermane për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Në fillim do të cek disa fjalë për politikën e përgjithshme gjermane, gjegjësisht për qëndrimin gjerman lidhur me integrimin.

Gjermania është një prej gjashtë vendeve themeluese të Bashkimit Evropian, që atëherë është quajtur Bashkësia ekonomike evropiane (BEE), e themeluar me Traktatin e Romës në 1957. Politika gjermane ka qenë çdoherë e orientuar fuqishëm drejt integritit evropian. Në fillim ka pasur dy arsye për këtë: e para, që Gjermania ka qenë në një mënyrë e përjashtuar nga shoqëria ndërkombëtare pas Luftës së dytë botërore.

Gjermania ka qenë fajtoare për Luftën e dytë botërore dhe ka qenë e shkatërruar tërësisht, me administrim të plotë nga bashkësia ndërkombëtare. Është dashur rishitazi të mësojmë demokracinë. Për Gjermaninë, integrimi në strukturat ndërkombëtare, si BEE dhe NATO ka qenë ri-pranim në bashkësinë ndërkombëtare dhe shans për ta kthyer reputacionin dhe ndikimin.

Arsyeja e dytë ka qenë ajo ekonomike - ekonomia gjermane çdoherë është varur kryesisht nga eksporti. Gjermania ka qenë e interesuar për qasje të lirë ndaj tregjeve evropiane dhe kjo ka qenë pikënisja e parë.

Kuptohet, vlerat kanë pasur rol të madh, por në fillim, Bashkimi Evropian ka qenë i lidhur vetëm për ekonominë. Për Gjermaninë, kjo ka qenë mundësi për të fituar qasje në treg dhe për Francën ka qenë mundësi për të fituar përkrahje për bujqësinë, e cila është çështje e ndjeshme në çdo shtet dhe fushë që nuk mund t'i bëjë ballë presionit të tregut. Në atë kohë, Franca ka qenë shtet bujqësor. Ideja themelore në fillimin e Bashkësisë evropiane ekonomike ka qenë që Gjermanisë t'i jepet qasje në treg dhe Franca të merr përkrahje për bujqësinë e saj, me të hollat e Bashkësisë. Madje edhe sot, mbi 40% e buxhetit evropian dedikohet për bujqësi.

Ky ka qenë fillimi i Bashkësisë evropiane ekonomike, që sot quhet Bashkimi Evropian, pas ndryshimit të emrit në vitin 1992. Mbarë projekti evropian ka pësuar ndryshime. Praktikisht, sot asnjë fushë e politikës nuk ka mbetur jashtë injerencave të Bashkimit Evropian. Për shembull, mjedisi jetësor, zhvillimi rajonal, politika sociale, arsimi, madje edhe politika e jashtme. Të gjitha politikat e cekur nuk udhëhiqen vetëm nga shtetet-anëtare, por edhe nga Bashkimi Evropian. Është e vërtetë që pjesa më e madhe e legjislativës nacionale të shteteve-anëtare vjen nga Brukseli ose në një mënyrë varen nga Brukseli. Ne në Gjermani besojmë që kjo është mirë, për shkak se shtetet e sotme nuk mund t'i zgjidhin vetëm problemet e tyre

- ata duhet të punojnë së bashku. Integrimi evropian do të thotë që ne kemi çka të themi edhe për çështjet ndërkombëtare dhe kjo është e pamundur pa qenë të bashkuar. Luftërat e tmerrshme të viteve të nëntëdhjeta në Ballkan, pas rënies së Federatës jugosllave i treguan shteteve-anëtare të Bashkimit Evropian që duhet të veprojnë së bashku, përndryshe nuk do të kenë ndikim. Kjo ka qenë pikënisja e Politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes.

Tani vijmë tek pika e dytë për të cilën dëshiroj të flas - zgjerimi. Gjermania çdoherë është angazhuar për zgjerim dhe ne i kemi mbështetur shtetet e Evropës lindore dhe të mesme, gjithashtu e përkrahim fuqishëm edhe Maqedoninë dhe përpjekjet e saj për anëtarësim në BE. Ky anëtarësim është shumë i famshëm në Maqedoni - anketat e fundit nga Eurobarometer tregojnë që 74% e qytetarëve e përkrahin integrimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe kjo është shkalla më e lartë e mbështetjes në mbarë rajonin ballkanik. Maqedonia tashmë është e lidhur ngushtë me Bashkimin Evropian dhe kjo nuk duhet harruar. Kjo rezulton me lidhje të ngushta dhe një lloj i partneritetit strategjik. Në vitin 2001 është nënshkruar Marrëveshja për stabilizim dhe asociim mes Maqedonisë dhe BE-së. Maqedonia ka qenë vendi i parë në rajon që ka lidhur marrëveshje të këtillë, me të cilën lehtësohet tregtia e lirë dhe bashkëpunimi në fushën e energjetikës, zhvillimit ekonomik, arsimit, kulturës, mjedisit jetësor, etj. Kjo do të thotë që ka më tepër të holla. Për shembull, përmes IPA fondeve, Maqedonia do të merr mbi 500 milionë euro nga Bashkimi Evropian në periudhën 2007-2013.

Në vitin 2005, Maqedonia e fitoi statusin e shtetit-kandidat. Ky status do të thotë që vendi është i kualifikuar të bëhet anëtare e ardhshme e BE-së dhe që duhet t'i përshtatet partnerëve evropianë, gjegjësisht

BE-së. Njëherazi, kjo do të thotë që vendi duhet të realizojë reforma politike dhe ekonomike. Këtu dëgjuar dhe lexuar shpesh për kriteret e njohura që duhet t'i plotësojë Maqedonia. Pse ekzistojnë këto kriteret? Ato e tregojnë pozitën ose suksesin e reformave të realizuara në fusha të ndryshme. Reformat maten përmes kriterëve dhe kanë një qëllim të vetëm: ta garantojnë pranimin e parimeve politike dhe vlerave të BE-së. Këto parime dhe vlera nuk delegohen, por për arritjen e tyre duhet punuar, ndonjëherë edhe njerëzit duhet të kujdesen që ato të respektohen. Ne, gjermanët, kemi shijuar dy diktatura. Së pari, e kemi pasur periudhën naziste 1933-1945 dhe pastaj sistemin komunist në Gjermaninë lindore, për 40 vite. Së këndejmi, e dimë se çka mund t'i ndodhë shoqërisë që nuk i respekton dhe vlerëson parimet dhe liritë themelore demokratike.

Kriteret e Kopenhagës i cekin katër parimet dhe vlerat themelore - demokracia, të drejtat e njeriut, sundimi i të drejtës dhe ekonomia e tregut. Do të them disa fjalë për secilën pjesë. Njerëzit nuk dëshirojnë të udhëhiqen nga dikush tjetër, por nga vetja. Kjo arrihet përmes sistemit demokratik, zgjedhjes së Kuvendit dhe zgjedhjes së Qeverisë nga Kuvendi. Kjo ka qenë arsyeja për rëndësinë e mënyrës së zgjedhjeve të fundit lokale dhe presidenciale në Maqedoni. Ka qenë shumë e rëndësishme të demonstrohet ky status ose rrjedhja e zgjedhjeve në vend, sepse zgjedhjet duhet të realizohen pa frikësim dhe pa presion. Njerëzit duhet të votojnë të lirë, ata nuk duhet të jenë nën ndikimin e të tjerëve. Dialogu politik është me rëndësi të njëjtë për demokracinë, që nënkupton se partitë respektohen mes vete, që nuk trajtohen si armiq që duhet të munden dhe marginalizohen. Në vend të kësaj, partitë duhet të shihen mes vete si konkurrentë për zgjidhjen më të mirë për problemet politike dhe të përpiqen të bashkëpunojnë, sipas nevojës. Në demokraci është



normale që partitë të kenë pikëvështrime të ndryshme dhe secili prej tyre duhet të trajtohet si legjitim. Nuk është jolegjitime të kenë pikëvështrime të ndryshme nga tjetri dhe kjo është esenca e pluralizmit. Fakti që njerëzit kanë mendime dhe interesa të ndryshëm duhet të pranohet patjetër. Është e rëndësishme që sistemi ta garantojë rezultatin e dialogut dhe bashkëpunimi të jetë i pranueshëm për mbarë shoqërinë.

Parimi i dytë është respektimi i të drejtave të njeriut, ku ndërthehet një ide filozofike, me rrënjë që nga krishterimi. Kjo nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore janë të lira, të barabarta dhe çdo individ është i rëndësishëm si edhe të gjithë të tjerët. Njerëzit duhet të kenë liri të shprehjes, ata patjetër duhet të jenë të lirë t'i shprehin mendimet e tyre. Ata duhet të kenë mundësi ta ushtrojnë besimin e tyre fetar - të gjithë janë të barabartë dhe nuk guxon të diskriminohen për shkak se i përkasin ndonjë grupi tjetër etnik, fetar ose gjinor.

Parimi i tretë është sundimi i të drejtës, që nënkupton se njerëzit duhet të kenë trajtim të barabartë nga gjyqet. Ligji duhet të zbatohet njëjtë për të gjithë. Gjykatësit nuk duhet të jenë nën ndikimin e politikës dhe të hollave - ata duhet të jenë të lirë prej presioneve. Nuk guxojnë të frikohen për humbjen e vendeve të punës nëse nuk veprojnë sipas dëshirave të dikujt tjetër. Duhet të jenë të trajnuar në mënyrë profesionale dhe ta kenë vendin e sigurt të punës. Kjo vlen edhe për administratën publike - ideja e pavarësisë së gjyqësorit dhe depolitizimit të administrimit publik është temë që bisedohet nga Bashkimi Evropian dhe Maqedonia në procesin e zgjerimit. Qeveria dhe Kuvendi kanë miratuar masa për garantimin e respektimit të sundimit të të drejtës ose për respektimin më të mirë se paraprakisht.

Ekonomia e tregut është parimi i fundit. Konkurrenca është zemra e ekonomisë së tregut. Në ekonomi, strukturat monopolistike janë të këqija për njerëzit.

Paramendoni nëse ka vetëm një kompani me licencë për importin e veturave në Maqedoni - do të duhej të gjithë ta blinin veturën e njëjtë. Njëherazi, veturat do të ishin të këqija dhe të shtrenjta. Për ta garantuar konkurrencën, kushtet duhet të jenë fer dhe transparente. Duhet të ketë zero-tolerancë për korrupsionin në administratën publike. Për shembull, kur ka tender për mbledhje të ofertave për ndërtimin e urave ose rrugëve të reja, mundësia e realizimit duhet t'i jepet ofertuesit më të mirë dhe jo atij që ka raporte më të mira me administratën publike.

Të gjitha reformat e nevojshme, të gjitha këto kritere nuk janë pjesë e provimit shkollor, ku Bashkimi Evropian jep nota, por ato ndërmerren në interes të njerëzve, në interesin tuaj. Ndonjëherë e fitoj përshypjen se njerëzit këtu mendojnë: "Bashkimi Evropian kërkon shumë dhe asnjëherë nuk është i kënaqur me atë që e bëjmë. Punojmë me zell dhe BE megjithatë na kritikon që nuk jemi mjaft të mirë". Kjo është pasqyra që e fitoj kur flas me njerëzit ose kur i shoh mediat. Për këtë, dëshiroj të theksoj që realizimi i reformave të cekura është në interesin tuaj. Po që se BE nuk insistonte në këto reforma, ajo nuk do të ishte atraktive për njerëzit në afat të gjatë. Nëse nuk i respektojmë parimet, nuk do të jemi klub atraktiv i shteteve, si që jemi tani.

Porosia ime e fundit është për rolin e shoqërisë civile, që është shumë e rëndësishme. Tërë procesi re-

formues nuk është vetëm brengë e Qeverisë, por e të gjithë qytetarëve. Qëllimi është të ndërtohet shoqëria civile, që udhëhiqet nga ideja e qëllimeve të përbashkëta, ku njerëzit nuk e shohin interesin personal ose atë fisnor ose të grupit etnik të tyre. Kjo është shoqëri ku anëtarët janë të vetëdijshëm për diçka më të lartë dhe më të rëndësishme - atë që është në interes të kombit dhe popullit. Shoqëria e këtillë ka anëtarë që përmbahen nga përcjellja ekskluzive e linjës partiake, fisnore ose të grupit etnik dhe në vend të kësaj veprojnë në dobi të qytetarëve ose të mbarë shoqërisë. Politikanët janë bartës të përgjegjësive kryesore, ata që janë në pushtet, në pozita qeveritare dhe në Kuvend, si dhe në administratë. Por, ata duhet të dinë që njerëzit dhe banorët janë të vetëdijshëm dhe kujdesen për atë që ata e bëjnë, që janë të gatshëm për përfshirje dhe angazhim. Mendimi publik mund të jetë forcë në një vend dhe mediat kanë rol të rëndësishëm. Ata duhet të dinë se çka ndodhë dhe t'ia bëjnë me dije politikanëve që ata kontrollohen dhe që çdo vepër e politikanëve përcillet, analizohet, diskutohet dhe kritikohet. Kjo është e rëndësishme për Maqedoninë, por edhe për çdo shtet tjetër. Kuptohet, ne në Gjermani kemi nevojë për media kritike të shtypura dhe elektronike. Çdo shtet, çdo demokraci ka nevojë për qytetarë të interesuar për politikë, për diskutim dhe kritikim dhe për përfshirje në partitë politike ose në organizatat joqeveritare.

“Definimi i interesit tuaj genësor do tu sjellë tek partnerët tuaj strategjikë”

AMBASADA E
HUNGARISË

Sh. T. Z. Ferenc Kekeshi,
Ambasador



ZDuke folur për Bashkimin Evropian me nocionet, shprehjet, politikat dhe instrumentet speciale, kuptojmë që komunikimi është një prej punëve më të vështira në Evropën e bashkuar. Ndonjëherë mendojmë që më mirë kuptohemi njëri me tjetrin, për të zbuluar më vonë që nuk kemi të drejtë. Roli i jonë, i të gjithëve, politikanëve, shoqërisë civile, ambasadorëve, ekspertëve, është të bëjmë gjithçka që mundemi për ta ndihmuar komunikimin dhe kuptimin e Evropës së bashkuar. Është në interesin e vendit tim ta ndajmë përvojën dhe të përpiqemi ta sjellim BE-në më afër jush. Kjo është mënyra në të cilën mund të përmirësohet partneriteti hungarez-maqedonas dhe të ndihmojmë të shndërrohet në partneritet strategjik.

Kur themi që bashkëpunojmë, kjo do të thotë që kemi qëllime të përbashkëta dhe zhvillojmë projekte për realizimin e tyre. Kur flasim për partneritet strategjik, kjo do të thotë që edhe më tej i kemi qëllimet e përbashkëta dhe zhvillojmë projekte, por gjithashtu ndërtojmë edhe aleanca për t'i prezantuar qëllimet e përbashkëta dhe së bashku të përkrahemi në forumet e ndryshme ndërkombëtare. Këtë e bëjmë pa dallim nga partia politike që është në pushtet dhe ky është partneritet afatgjatë në dobi të dy vendeve.

Republika e Hungarisë dhe Republika e Maqedonisë kultivojnë marrëdhënie të shkëlqyeshme dhe kanë bashkëpunim të ngushtë mes vete. Dy shtetet

nuk kanë çështje të hapura. Ne nuk jemi shtete fqinje, por jemi shumë afër mes vete, shumë më tepër sesa mendojmë. Në fakt, për një orë mund të vini në Budapest dhe të gjeni miq dhe partnerë. Fatkeqësisht, këtë afërsi nuk e shfrytëzojmë në masën e duhur. Kemi qenë pjesë e sistemit tjetër politik dhe ekonomik, kështu që tani përpiqemi të ndërtojmë lidhje të reja. Ndonëse periudha 20-vjeçare pas rënies së Perdes së hekurit dhe Murit të Berlinit nuk ka mjaftuar për ta arritur këtë, qëllimet e njëjta të përbashkëta japin bazë të mirë për bashkëpunim në nivel të partneritetit strategjik.

Maqedonia dhe rajoni janë të rëndësishme për Hungarinë. Këmbimi tregtar me rajonin është dyfishuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Këmbimi dypalësh i mallrave, si dhe bashkëpunimi ekonomik janë rritur dukshëm dhe zhvillohen edhe më tej. Prania e kompanive hungareze në rajon rritet ngadalë. Ekziston bashkëpunim i mirë në fushën e arsimit dhe kulturës. Megjithatë, bashkëpunimi më intensiv është në politikë, që duket çdoherë e më tepër në jetën e përditshme.

Kur flasim për qëllimet strategjike, së pari mendojmë në integrimin në strukturat euro-atlantike. Hungaria është një prej përkrahësve më të mëdhenj të vendit tuaj në NATO dhe BE. Dëshirojmë ta shohim vendin tuaj në këto organizata sa më shpejtë. Kjo e parasheh plotësimin e të gjitha kushteve themelore dhe përfun-



dimet janë proces pa fund. Hungaria është anëtarësuar në BE dhe NATO, por reformat dhe rikonstruimi ose zhvillimi i shoqërisë dhe ekonomisë vazhdon edhe më tej. Kjo është si tren që nuk ndalet kurrë. Maqedonia duhet të demonstrojë përkushtim të fuqishëm për procesin reformues. Duhet të keni tendencë të vazhdueshme ndaj përmirësimit, me qëllim që të projektoni pasqyrë të vendit të parapëlqyer për anëtar, që ka aftësi për ballafaqim me sfidat e anëtarësimit. Duhet t'i bindni dy organizatat që anëtarësimi i Maqedonisë nuk do t'i rrisë në madhësi, por në fuqi.

Duke u nisur nga partneriteti i jonë strategjik, Hungaria përpiket t'i ndihmojë Maqedonisë të bëhet anëtare e mirë dhe t'i shijojë të gjitha përfitimet e anëtarësimit. Ne e dimë që në Bashkimin Evropian ekzistojnë grupe të caktuara të interesit dhe mund të

quhemi partnerë, për shkak se jemi vende relativisht të vogla. Nuk them se jemi miq, për shkak se kjo është e qartë. Kur shfaqen çështjet vitale, ne jemi partnerë dhe në bazë të kësaj mund të them se në të shumtën e rasteve, si për shembull në bujqësi, Hungaria do të jetë më tepër partner sesa rival. Ekzistojnë milionë fusha tjera ku mund të gjejmë potenciale për zhvillimin e partneritetit strategjik dhe ndërtimin e aleancës. Shikoni shembullin e Grupit të Vishegradit. Në rrugën tuaj drejt BE-së, ne kemi ndërtuar aleancë me Poloninë, Republikën e Çekisë dhe Sllovakinë. Kjo aleancë na ka ndihmuar në anëtarësim dhe na ndihmon edhe sot. Merreni shembullin e Hungarisë, por edhe përvojën e shteteve tjera të reja anëtare, analizoni dhe definoni interesat tuaj qenësorë. Definimi i interesave tuaj qenësorë do tu sjellë tek partnerët tuaj strategjikë.

“Kapaciteti dhe vazhdimësia e shoqërisë qytetare ka rëndësi qenësore për rezultatin e negociatave”

INSTITUTI PËR EKONOMI
BOTËRORE I ASHH¹

D-r Kristina Vida,
Hulumtues e lartë



Detyra ime e sotme është ta prezantoj përvojën hungareze të bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin Evropian dhe tu jap disa ide, ndoshta edhe këshilla, për atë se çka duhet dhe çka nuk duhet të bëni. Në fillim, dëshiroj të them se nuk duhet të dëshpërohemi, për shkak se Hungarisë, shtet që në fillimin e viteve '90 konsiderohej si një prej shteteve-kandidate me përgatitje më të mirë për anëtarësim në BE, i duheshin 10 vite tjera për anëtarësim ose gjithsej 14 vite. Dhjetë vite kanë kaluar prej vitit 1994, kur e kemi parashtruar aplikacionin për anëtarësim në BE deri në vitin 2004, kur u anëtarësua. Në krahasim me Maqedoninë, ne kishim pak më tepër fat, meqë BE i filloi bisedimet me Hungarinë disa muaj pas marrjes së statusit të kandidatit. Gjendja ishte pak më e dallueshme nga situata e Maqedonisë, por nga ana tjetër edhe ne kemi pritur shumë gjatë, për shkak se bisedimet kanë zgjatur më shumë se që kemi menduar ose pritur.

Hungaria e përcaktoi qëllimin për anëtarësim në BE deri në vitin 2002. Ky qëllim nuk u arrit dhe ne u anëtarësua në vitin 2004, që do të thotë se procesi zgjatej për dy vite më shumë. Megjithatë, ne mendojmë që kjo ishte e dobishme, për shkak se përgatitjet e Hungarisë realizoheshin sipas afateve të cekura dhe shumë gjëra u arritën që në fillim. Përveç kësaj,

fituam edhe dy vite për t'i shfrytëzuar për miratim më të mirë të legjislacionit evropian. Nga ana tjetër, kjo ka qenë mundësi për parashtrimin e më tepër kërkesave për lëshime, për shkak se ishim të përgatitur për anëtarësim në vitin 2004. Së këndejmi, nëse punët realizohen më ngadalë, Maqedonia mund të mendojë në këtë drejtim, gjegjësisht të konsiderojë se fiton më shumë kohë për përgatitje.

Çështja e dytë është metodologjia e bisedimeve. Shtetet-kandidate duhet të jenë të përgatitura për ballafaqim me qasjen e dyfishtë të BE-së. Nga njëra anë, BE ju thotë që do tu vlerësojë sipas meritave tuaja individuale. Kështu, në rastin tuaj do të vlerësohet vetëm përparimi i shënuar nga Maqedonia dhe vetëm meritat tuaja individuale do të jenë të rëndësishme. Nga ana tjetër, BE tenton t'i bashkojë vendet e vogla në një grup. Për shembull, nëse gjendja në Ballkanin perëndimor përmirësohet më shpejtë se që pritet, duhet të jeni të gatshëm që BE mund ta konsiderojë futjen në një paket. Kjo do të thotë që do të ngadalësohet procesi i juaj, për t'i dhënë mundësi shteteve tjera ta arrijnë nivelin tuaj. Gjendja e këtillë nuk është e këndshme, por ne e kemi provuar për shkak se në fillim ishim gjashtë shtete që kishin përparim në bisedime dhe gjashtë me ngecje. Duhet të ballafaqoheni me këtë qasje dhe të kuptoni që BE e sheh hartën dhe thotë "t'i

¹ ASHH - Akademia hungareze e shkencave

marrim së bashku këto vende, nëse është e mundur". Megjithatë, ne ia dolëm në ballafaqimin me këtë qasje dhe u bashkuam me shtetet tjera kandidatë.

Së treti, çdoherë duhet të mbani mend që puna para jush vazhdimisht rritet. Gjatë zgjerimit në jud, shtetet e reja anëtare jugore duhej të miratonin 40.000 faqe legjislaçion evropian dhe ne duhej ta miratojmë dyfishin (rreth 90.000 faqe). Lajmi i keq është që ju duhet të ballafaqoheni me 120.000 faqe legjislaçion. Për këtë arsye, sa më shpejtë që hyni në BE, aq më mirë për ju. Tani jeni në pozitën e miratimit të një-anshëm dhe pastaj mund të merrni pjesë në hartimin e legjislaçionit të ardhshëm të Bashkimit Evropian.

Këshilla tjetër është që nëse bisedoni në paket me shtetet tjera, veçanërisht me fqinjët tuaj, gjatë negociatave duhet të krijoni koalicione. Kjo nuk është bërë më herët nga vendet e Evropës jug-lindore dhe mendoj se ishte gabim i madh. Shtetet e Grupit të Vishegradit, për shembull, nuk i prezantuan interesat e tyre të përbashkët, ndonëse interesat e këtyre ekzistonin. Të gjithë jemi fokusuar në detyrën tonë të shtëpisë dhe nuk i jemi drejtuar fqinjëve për të parë çka duhet të bëhet së bashku, për t'i prezantuar interesat tonë kyçë. Keni parasysh që çdoherë do të jeni më të fuqishëm nëse i prezantoni interesat e caktuara kyçë së bashku me të paktën një shtet tjetër, krahasuar me prezantimin ndaras.

Përgatitjet për bisedime bazohen në katër shtylla. Së pari, Hungaria është koncentruar në krijimin e bazave për stabilitet makroekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm në aspektin afatgjatë, si që besoj ka bërë edhe Maqedonia. Kjo ka rëndësi qenësore. Së dyti, është dashur të përqendrohemi jo vetëm në miratimin e të drejtës, por edhe në ndërtimin e institucioneve gjegjëse që do të jenë të qëndrueshme edhe pas anëtarësimit. Edhe ju do të duhet t'i ekiponi in-

stitucionet tuaja me kuadër kompetent dhe trajnim të vazhdueshëm të nëpunësve shtetërorë, duke e futur edhe trajnimin për gjuhë të huaja mes tjerash. Shtylla e katërt, për të cilën diskutohet sot, është përgatitja e opinionit publik për anëtarësimin në BE. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që procesi t'i afrohet qytetarëve, meqë Bashkimi Evropian është Bashkim i qytetarëve evropianë, kështu që ju si qytetarë duhet të dini dhe të përfshihen në aktivitetet. Që në fillimin e gjysmës së dytë të viteve '90, në Hungari kemi zhvilluar strategji të ndryshme për komunikim, ku BE çdoherë ka qenë në agjendë. Tani do të flas për disa elemente kyçë të bisedimeve.

Administrata është çelësi i suksesit në bisedime. Nëse keni rregullim të mirë dhe transparent institucional, me kuadër dhe sistem profesional që funksionon pa pengesa, ju keni arritur sukses të mirë. Pas hapjes së bisedimeve, administrata do të duhet të ballafaqohet me punë të jashtëzakonshme. Për këtë arsye, nëpunësit shtetërorë duhet të jenë të përgatitur ta kryejnë punën mirë. Mos u dëshpëroni për shkak të fakti se jeni vend i vogël dhe nuk keni kuadër. Edhe Qiproja dhe Malta janë shtete të vogla, por ia kanë dalë me sukses procesit të bisedimeve. Kjo është arsyeja pse nuk duhet të kujdeseni për madhësinë e kuadrit, që mund të rritet pak gjatë kësaj periudhe - përqendrohuni në krijimin e strukturës transparente. Ne e kemi zgjedhur Ministrinë për punë të jashtme, në kuadër të së cilës ka ekzistuar Sekretariati shtetëror për integritet, ku ka qenë edhe Seksioni për koordinim me BE. Në esencë, kjo ka qenë zemra e sistemit. Nevojitet sistem qendror, pavarësisht a do të jetë pjesë e MPJ-së ose ndonjë ministrie tjetër.

Delegacioni i jonë bisedues ka pasur 3 persona kyç: Ministri për punë të jashtme, Udhëheqësi i Sekretariatit shtetëror për integritet evropian, gjegjësisht Sek-



retari shtetëror dhe Krye-biseduesi i Hungarisë, me seli në Bruksel. Këta tre jo vetëm që ishin shumë të përgatitur, por ishin të përfshirë në çështjet evropiane që në mesin e viteve '80, si diplomatë me trajnim të mirë dhe të suksesshëm në karrierë, si pjesë e Misionit në Bruksel që u kthye për punë në ministrinë gjegjëse. Njëri prej tyre ishte profesor në nivel evropian. Këta ekspertë mbetën në mbarë procesin. Gjatë dhjetë viteve, prej 1994 deri në 2004, mbahej vazhdimësia e kuadrit, që gjithashtu është çështje kyçe. Me ndërrimin e vazhdueshëm të njerëzve, ata duhet të fillojnë rishtazi të mësojnë si funksionon BE dhe të përpiqen për krijimin e kontakteve personale, që janë tejet të rëndësishme gjatë bisedimeve, madje edhe kur ndërrohet Qeveria. Në periudhën e anëtarësimit tonë në BE, ne kishim të paktën dy zgjedhje, por njerëzit mbetën si pjesë e procesit.

Ndonëse të tre janë njerëz të shkëlqyeshëm, dëshiroj ta dalloj krye-biseduesin Endre Juhaz, i cili tani është gjykatës në Gjyqin evropian të drejtësisë. Ai ishte i njohur si njohës i shkëlqyeshëm i legjislacionit evropian, kështu që flitej se komisarët e Komisionit Evropian, gjegjësisht funksionarët ose eurokratët frikohen të flasin me të, për shkak se ndonjëherë e dinte legjislacionin shumë më mirë se ata.

Kemi caktuar tre parime biseduese. Kishim përgjegjësi të ministrave, që do të thotë se ministrinë duhej t'i përpunojnë punët sektoriale nga kapitujt për të cilat bisedohej. Punët e këtilla sektoriale duhej të koordinohen me ministrinë tjera, meqë çdoherë ka konflikte mes ministrive. Këto konflikte mes ministrave dhe sektorëve zgjidheshin në forumin ndër-ministror. Së treti, e kishim metodën e kanalit të vetëm, sipas të cilit Hungaria çdoherë fliste me një zë në BE. Ministria asnjëherë nuk e kontaktonte Komisionin ose shtetëtarët pa koordinim paraprak - kjo çdoherë kanalizohet me misionin në Bruksel.

Nuk mund ta theksoj në masë të mjaftueshme rëndësinë e kapaciteteve kadrovike. Ju nevojiten udhëheqës me profesionalitet të lartë, mundësisht diplomatë të karrierës, që e njohin mirë BE dhe e dinë domethënien e saj. Së dyti, duhet ta mbani vazhdimësinë e kuadrit dhe të keni nëpunës shtetërorë me trajnim të mirë, që duhet t'i shpërbleni në mënyrë adekuate dhe t'i mbani.

Ideja e radhës e diskutimit tim është vlerësimi i kapitujve. Ne kemi pasur 31 kapituj, mendoj se ju do të keni 35. Prej 31 kapitujve për bisedime, 29 ishin në lidhje me legjislacionin evropian. Pjesa më e madhe e kapitujve nuk ishte problematike. Por, kishte 11 kapituj

më të vështirë dhe unë do të theksoj disa. Për kapitullin 30 bisedohej pa asnjë problem. Por, fatkeqësisht, si rezultat i vendimit të padrejtë të Nicës, të miratuar nga 15 shtetet-anëtare të BE-së, Hungaria dhe Republika e Çekisë u ballafaquan me një problem shumë të madh dhe të ndjeshëm. Problemi ishte që dy vendeve, me nga 10 milionë banorë, ju dhanë dy vende më pak në Parlamentin Evropian. Ky problem u zgjidh në momentin e fundit, në Kopenhagë. Përfundimi është që mund të ballafaqoheni me probleme të papritura, për të cilat nuk keni menduar në mbarë procesin.

Nuk dëshiroj të ndërhyj në detajet e temave të vështira, por disa prej tyre mund të jenë interesante, kështu që edhe ju mund të keni probleme të ngjashme ose kërkesa për lëshime. Hungaria dëshironte të kërkojë 9 lëshime në kapitullin për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përfundoi vetëm me 4. Përjashtimi më i madh do të zgjasë deri në vitin 2015, lidhur me sistemet e kanalizimit që duhet ndërtuar në mbarë vendin dhe që kërkon investime të jashtëzakonshme. Këto janë direktiva aq të shtrenjta, saqë shtetit i duhet kohë shtesë për realizimin e investimeve të nevojshme. Së dyti, lëvizja e lirë e kapitalit. Dëshiroj të jap një shembull lidhur me këtë. Jam e sigurt që toka në Maqedoni është e lirë, si që ishte në Hungari. Mos lejoni të keni presione për liberalizimin e shpejtë të shitjes së tokës. Çdoherë mund t'i referoheni vendeve të vjetra anëtare dhe t'i thoni Brukselit se BE i ka dhënë moratorium shtatë-vjeçar 10 shteteve të reja anëtare për këtë kapitull, që ta kërkonte edhe ju të njëjtin lëshim. Nuk e di nëse kjo ka qenë rasti me vendet si Qiproja dhe Malta, por BE na ka dhënë moratorium shtatë-vjeçar për shitjen e tokës, që në raste të jashtëzakonshme mund të zgjatet edhe për 3 vite tjera. Kështu, ne fituam moratorium prej 10 viteve për shitjen e tokës, meqë blerja e tokës së lirë nga njerëzit e Evropës perëndimore

mund të shkaktojë shpekullime të mëdha. Çdoherë mund t'i referoheni përvojës tonë.

Kemi pasur diskutim edhe për buxhetin. Artikulli i buxhetor desha ta theksoj kur ceka se nuk kemi krijuar koalicion me shtetet e Grupit të Vishegradit. Në fakt, për buxhetin kemi biseduar në Kopenhagë, në momentin e fundit të ditës së fundit, gjegjësisht mbrëmjen e fundit, për shkak se të hollat e buxhetit janë çështje mjaft e ndjeshme për BE. Për fat të keq, katër shtetet e Grupit të Vishegradit nuk kanë krijuar koalicion, kështu që BE bisedonte me çdo shtet ndaras, pas dyerve të mbyllura. Rezultati ishte fakti se Hungaria dhe Republika e Çekisë (dy vende me popullatë të njëjtë dhe nivel të ngjashëm zhvillimi) bisedonin me rezultate të ndryshme. Çekët në fillim kishin përkrahje shumë më të madhe për likuiditet, për dallim prej hungarezëve. Kjo ndodhi për shkak se BE kishte mundësi t'i thotë diplomatëve në dhomat e ndryshme që çekët, si edhe polakët, tashmë e kanë pranuar këtë shumë. Së këndejmi, tentoni që bisedimet të vazhdojnë dhe mos u ndalni derisa nuk thoni se është në rregull dhe përpiquni të ndërtoni koalicionet.

Rezultati përfundimtar ishte që fituam 34 lëshime, që mund të konsiderohet si sukses mesatar, për shkak se disa shtete fituan më tepër, kurse tjerat më pak. Ndoshta është më së miri të koncentrohemi në kërkimin e më pak lëshimeve nga BE. Nëse kërkonte më pak arranjime kalimtare, do t'i tregoni BE-së që jeni të përgatitur mirë. Nga ana tjetër, nëse kërkonte disa lëshime, ato duhet t'i mbështesni mirë me argumente dhe duhet të tregoni që ato janë vërtetë të arsyeshme. Vetëm në këtë mënyrë do t'i fitoni lëshimet e kërkuara.

Të përfundoj, në fund ishim në pozitë të mirë buxhetore, posaçërisht prej vitit 2007 dhe BE na ka dhënë të paktën 3% të BPV-së në vjet. E kemi zgjidhur edhe



çështjen institucionale, por kemi përjetuar humbje të konsiderueshme në aspekt të kuotave bujqësore. Kjo lidhet veçanërisht me kuotat e qumështit dhe të lopëve, meqë jemi të pasur me lopë dhe jemi prodhues i madh i qumështit. Megjithatë, nuk ia kemi dalë të kemi negociata të mira për këtë çështje dhe Hungaria edhe sot i bart pasojat nga rezultatet e bisedimeve në fjalë.

Hungaria e ka mbështetur integrimin e tërë rajonit, pa kushtëzime. Në rasti tonë, Gjermania ishte vendi që e kishte rolin e forcës shtytëse për mbarë procesin. Ju nevojiten aleatë mes shteteve aktuale anëtare - sa më tepër, aq më mirë. Kuptohet, Hungaria dhe Sllovakia nuk mjaftojnë. Ju nevojiten shumë më tepër aleatë

dhe mos harroni ta reklamoni vendin tuaj, për shkak se në disa vende mbahet referendum për zgjerimet e ardhshme dhe do të duhet të ballafaqoheni edhe me këtë gjendje.

Mund të them që pesë vitet pas anëtarësimit në BE, deri në anëtarësim, kanë qenë periudhë vërtetë e suksesshme. Së pari, shumica e vendeve të anëtarësuar arritën stabilitetin makroekonomik. Hungaria nuk arriti rezultate të mira në këtë plan, por nuk dëshiroj të hyj në detale, në ndërkohë që të gjitha vendet tjera treguan sukses të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë. Katër prej 12 vendeve e futën Euron në përdorim, që është edhe një rrëfim i suksesshëm. Lidhjet tregtare me shtetet e reja tregtare u intensifikuan, meqë ato

ekzistonin që më herët, gjegjësisht vendet ishin të lidhura me tregjet e Evropës perëndimore. Por, ne shënuam rritje të dukshme në tregtinë rajonale, që do të jetë e dobishme edhe për këtë rajon. Investimet e huaja direkte nga vendet e vjetra anëtare vazhduan me ardhjen në rajon. Shumë punëtorë të vendeve të reja anëtare u larguan në perëndim, por kjo nuk shkaktoi asnjë problem.

Anëtarësimi në BE nuk kishte efekte negative ndaj buxhetit. Shtetet e vjetra anëtare të BE-së frikoheshin që zgjerimi i madh me 12 vende anëtare do ta rrit buxhetin. Kjo nuk ndodhi dhe buxheti edhe më tej është 1% e BPV-së së Bashkimit Evropian. Megjithatë, shtetet e reja anëtare ia dolën ta marrin pjesën e tyre prej të paktën 3% të BPV-së dhe të gjitha janë në gjendje të mirë. Falë buxhetit të BE-së, gjatë pesë viteve të kaluara kemi fituar vlerë të konsiderueshme të shtuar. Dëshiroj të theksoj që BE funksionon mirë me 27 shtete anëtare, që ka qenë befasi e madhe për disa. Së këndejmi, mund të thuhet që nëse BE mund të funksionojë mirë me 27 shtete-anëtare, atëherë mund të funksionojë edhe me 30 shtete, meqë gjërat nuk do të ndryshojnë dukshëm.

Rekomandimet ose këshillat për një vend që është në aderim e sipër, si Maqedonia, janë këto: së pari, duhet vendosur korniza transparente institucionale

me qendër efikase koordinimi; së dyti, mbani mend lëshimet që i fituam ne, meqë çdoherë mund t'i referoheni atyre si presedan; së treti, mbani të gjithë nëpunësit shtetërorë me trajnim të mirë në pozitat kyçe; së katërti, stabilizojeni demokracinë dhe luftojeni korrupsionin, për shkak se në BE ka të paktën një rast kur Komisioni i suspendon mjetet e fondeve kohezive për shkak të korrupsionit në një vend-anëtar. Mos lejoni të humbni asnjë eurocent për shkak të korrupsionit. Stabilizoni financat publike dhe të gjitha shtyllat e ekonomisë nacionale, në pajtim me Kriteret e Mastrohtit.

Sugjerimi im është të gjeni ndonjë udhëheqës në ekonomi, pa dallim a do të jetë turizmi ose bujqësia. Ndërtoni institucione që janë të afta për jetë dhe që do të mund të ballafaqohen me punët e përditshme në BE edhe pas anëtarësimit, meqë jeta nuk përfundon me anëtarësimin tuaj. Përkundrazi, trajtoni dhe shpërbleni në mënyrë gjegjëse nëpunësit tuaj shtetërorë, për shkak se në të kundërtën ata do të largohen në sektorin privat dhe do t'i humbni. Arrini konsensus nacional për çështjet kryesore të BE-së, për shkak se kështu do të jeni partner më i besueshëm i BE-së dhe tentoni të mos i ndryshoni prioritetet çdo katër vite pas zgjedhjeve. Mësoni si të krijoni koalicionë me shtetet-anëtare dhe vazhdimisht këmbëni ndani e BE-së me opinionin publik, si që veprojmë sot.

“Negociatat me BE-në kanë të bëjnë me legjislacionin e saj, por edhe me përpjekjen dhe politikën”

QENDRA PËR
MARRËDHËNIE
NDËRKOMBËTARE

Prof. D-r Bojko Buçar



Sot do të ndaj me ju disa vështrime për periudhën para-aderimit dhe anëtarësimin, si dhe për përvojën sllovene të anëtarësisë. Kur flasim për periudhën para-aderimit, dëshiroj të theksoj tre ide. Së pari, në Slloveni kemi hulumtuar shumë për mënyrën më të mirë për zhvillimin e Sllovenisë dhe shoqërisë së saj. Kemi hulumtuar nëse duhet të hyjmë në Zonën evropiane të tregtisë së lirë, në BE ose nuk duhet të jemi pjesë e asnjë integrimi dhe t'i lamë gjërat si që ishin ose ndoshta të krijojmë zonë jo-doganore, etj. Rezultatet kanë treguar që ndoshta ekzistojnë opsione jo aq të mira ose më të mira, por anëtarësimi në BE kuptohet që ka qenë opsioni më së paku i keq. Përfundimi ka qenë që Sllovenia, në esencë, nuk ka opsion tjetër përveç se t'i bashkëngjitet BE-së. Zhvillimi i dytë që ka ndodhur para fillimit të negociatave për anëtarësim në BE ka qenë që Sllovenia është dashur të ndryshojë shumë gjëra në fushën e ekonomisë, por edhe në sistemin juridik dhe politik. Disa njerëz nuk kanë besuar që të gjitha ndryshimet që janë bërë janë të mira dhe kanë filluar të dyshojnë. Përgjigjja e politikanëve, por edhe ekspertëve ka qenë shumë e qartë: nuk i bëjmë ndryshimet për shkak të Bashkimit Evropian, por për shkak se duhet t'i bëjmë për tu zhvilluar në shoqëri bashkëkohore, që ka gjasa për zhvillim. Është dashur ta përcjellim shembullin e shteteve tjera në Bashkimin Evropian, të cilat janë zhvilluar si bashkëkohore. Së këndejmi, nëse dëshirojmë

zhvillim, edhe ne duhet ta bëjmë të njëjtën, pa dallim nga Bashkimi Evropian! Reformat janë bërë për shkak se Sllovenia ka pasur nevojë për këto ndryshime, jo Bashkimi Evropian. Përvoja e tretë që e kemi kaluar, ka qenë e lidhur me shtetin-anëtar Italinë dhe me siguri kjo do tu tingëllojë e njohur - Italia nuk ka dashur të pajtohet për fillimin e negociatave për anëtarësim përderisa Sllovenia nuk e ka hapur tregun e saj të patundshmërive. Sllovenia e ka ditur që kjo duhet të bëhet si shtet-anëtar i Bashkimit Evropian, por shumë politikanë dhe opinionistë nuk e kanë kuptuar se pse duhet bërë kjo para fillimit të negociatave. Thjeshtë, kjo është dukur si diskriminim. Por, asgjë nuk ka ndihmuar. Rezultati ishte - Sllovenia duhej ta ndryshojë Kushtetutën para fillimit të negociatave, në pajtim me kërkesat e parashtruara. Në fund, Sllovenisë iu lejua t'i fillojë negociatat për anëtarësim, pasi që i plotësoi këto kërkesa.

Në fakt, këtu filloi cirkusi. Shpesh herë thuhet që negociatat për anëtarësim janë të lidhura me legjislacionin evropian, që duhet të pranohet nga çdo shtet. Thuhet që pothuajse nuk ka negociata - Bashkimi Evropian vetëm vështron nëse shteti i plotëson standardet e legjislacionit evropian ose jo. Në esencë, kjo është diktat nga Bashkimi Evropian dhe kuptohet, duhet theksuar fakti që në procesin negociues, mund të jepen periudha kalimtare dhe të bëhen lëshime, që ndoshta nuk janë të shumta në numër, por mund të



jenë të rëndësishme për vendin. Shteti duhet të ketë ekip negociator shumë të mirë dhe me përvojë, meqë negociatat nuk kanë të bëjnë vetëm me transformimin e legjislativës evropiane në atë nacionale. Kur flasim për ekipin e mirë negociator, duhet të theksoj që Sllovenia kishte ekip shumë të mirë, nën udhëheqjen e d-r Janez Potočnik si negociator kryesor, i cili aktualisht është komisar për shkencë dhe hulumtim. Ekipi negociator nuk ka biseduar vetëm me Bashkimin Evropian, por edhe me qeverinë nacionale, forcat politike në vend, madje edhe me shoqërinë civile. Kjo është punë shumë më e komplikuar sesa negociatat vetëm me Bashkimin Evropian.

Gjatë procesit para-anëtarësim ka pasur shumë aktivitete politike, por do të theksoj një gjë konkrete – qarkullimi i informatave. Në internet mund t'i gjeni jo vetëm pozitave e Sllovenisë në procesin e negociatave, por edhe rezultatet për çdo kapitull ndaras. Kështu që, sipas dëshirës, ekspertët kishin mundësi ta përcjellin mbarë procesin në afërsi. Por, nuk ka qenë vetëm

interneti. Nëse bujqit në ndonjë fshat të largët ishin të brengosur për çmimin e qumështit ose patateve, ndonjë anëtar i ekipit negociator e vizitonte fshatin për ta shpjeguar mbarë procesin, shpesh herë shkonte edhe krye-negociatori d-r Potočnik. Çdoherë kur dikush mendonte që duhet vizituar ndonjë vend për t'i shpjeguar gjërat, ekipi e bënte këtë. Në shaka themi që nëse shkon në shitore dhe blen një konservë, pas hapjes së saj do të del d-r Potočnik dhe mbi të gjitha, do të jetë i disponuar miqësisht.

Si që ceka më lartë, thuhet që negociatat kanë të bëjnë vetëm me legjislativën evropiane. Kjo është e saktë vetëm pjesërisht. Negociatat lidhen edhe me dy gjëra tjera – të hollat dhe politikën. Do tu jap disa shembuj. Së pari, në kapitullin e dispozitave financiare dhe buxhetore, Sllovenia është dashur të luftojë me tendencën e shndërrimit në neto-kontribuues së buxhetit të Bashkimit Evropian, si rezultat i efektit statistikor. BE-së i janë bashkëngjitur aq shumë vende të Evropës lindore në momentin e njëjtë, sa që

Slllovenia është konsideruar për një moment si shtet i zhvilluar. Meqë BPV e Slllovenisë ishte mbi gjysmën e BPV-së mesatare të Bashkimit Evropian, Slllovenia është dashur të bëhet neto-kontribuues. Në fund është gjetur zgjidhja politike, por kjo është vetëm për perspektivën momentale financiare. Së dyti, edhe çështja e politikës rajonale ka qenë çështje e të hollave. Slllovenia ka dashur të ketë dy ose tre rajone, por Komisioni Evropian ka insistuar që të ketë vetëm një. Kuptohet, dallimi është i madh. Nëse ka një rajon, ai do të jetë i zhvilluar dhe shumica e mjeteve të kualifikuara do të zvogëlohet. Me ndarjen e shtetit në disa rajone, do të thotë që rajone të caktuara do të trajtohen si të pazhvilluara dhe do të kualifikohen për më tepër mjete nga fondet më të mëdha të Bashkimit Evropian. Çështja e tretë e lidhur me të hollat ka qenë Politika e përbashkët bujqësore dhe mendoj që ky kapitull do të jetë shumë i rëndësishëm edhe për Maqedoninë. Kur flitet për subvencionet për bujqit, Bashkimi Evropian nuk i ka lejuar shteteve të porsa-anëtarësuara të kenë regjim të njëjtë si edhe anëtarët e vjetër. Slllovenia ia ka dalë të arrijë kompromis në kuptim të mundësisë për subvencionimin e bujqve të vet në shumë të njëjtë si edhe shtetet e vjetra anëtare, ku bujqit është dashur pjesërisht të subvencionohen nga buxheti vetanak. Sidoqoftë, kjo është konsideruar si sukses dhe besoj që vërtetë ka qenë sukses.

Një çështje tjetër që ka ndikim në negociatë është vetë politika. Çdo shtet që aderohet duhet t'i plotësojë Kriteret e Kopenhagës, të cilat janë aq të paqarta, saqë politika vazhdimisht hyn në lojë. Për shembull, kur Slllovenia e hapi tregun e patundshmërive, ne hartuam një klauzolë për reciprocitet për mbrojtje, që ka qenë kufizim i ngjashëm me ekzistueset në Itali dhe Greqi. Por, Komisioni tha që duhet ta anulojmë këtë klauzolë për shkak të dy parimeve themelore të Trak-

titit për Bashkimin Evropian: ndalimin e diskriminimit, ku qytetarët e shteteve tjera anëtare nuk guxon të trajtohen në mënyrë të ndryshme nga qytetarët e vendit dhe natyrës së pakushtëzuar së Traktatit - të drejtat e Traktatit janë të pakushtëzuara dhe shtetet-anëtare nuk mund të parashtrojnë kushte. Argumenti i tyre ka qenë që Slllovenia është më e zhvilluar, në krahasim me vendet tjera të Evropës lindore që anëtarësohen, kështu që periudhat kalimtare janë lejuar për shtetet tjera, por jo edhe për Sllloveninë.

Sa i përket lëvizjes së lirë të njerëzve, Slllovenia kërkoi qasje të lirë në tregun e punës, me argumentin e parimit të ndalimit të diskriminimit dhe kushtëzimit të Traktatit. Por, Komisioni këtë radhë pohonte që Slllovenia është e pazhvilluar dhe në fund i ka imponuar periudhë kalimtare, si edhe shteteve tjera të Evropës lindore. Vetëm Qiproja dhe Malta fituan qasje direkte në tregun e punës, meqë konsideroheshin si shtete të zhvilluara. Slllovenët u hutuan nga dallimet në trajtim, një herë konsideroheshin si shtet i zhvilluar dhe pastaj si më pak i zhvilluar. Besoj që kjo është pjesë e politikës.

Kuptohet, ka pasur edhe shembuj tjerë që mund të cekem, si që janë kërkesat e Italisë dhe Austrisë për mbylljen e shitoreve free-shop në pikë-kalimet tokësore kufitare, të adresuara tek Slllovenia dhe jo shtetet tjera aderuese. Slllovenia e dinte që duhet t'i mbyllë ato pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, por pse duhej ta bëjë këtë më herët? Nga ana tjetër, Austria imponoi disa kufizime për importin e duhanit dhe Italia e zvogëloi çmimin e benzinës në kufi. Slllovenia u ankua për shkak se nuk dëshironte t'i mbyllë shitoret free-shop dhe pohonte që veprimet e Austrisë nuk janë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, si dhe që veprimi i Italisë është mosrespektim i tregut të përbashkët. Komisioni nuk dha asnjë përgjigje ndaj ank-

esave të Sllovenisë dhe përgjigjja e vetme që e pranoi shteti ishte që shitoret free-shop duhet të mbyllen dhe ne vepruam kështu.

Në esencë, Komisioni tha që sipas rregullës, aplikuesit tregojnë interesim për anëtarësim në BE dhe jo e kundërta. Përveç kësaj ka pasur edhe disa veçori tjera. Regjimi Schengen dhe Euro-zona janë legjislativë për të gjitha shtetet e porsa-anëtarësuara, por anëtarëve të vjetër nuk ju është kërkuar të jenë pjesë e këtyre dy zonave. Thjeshtë, këto janë rregullat e klubit. Kur Sllovenia u anëtarësua në BE, vendi nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e Kopenhagës dhe Maastrihit, të nevojshme për anëtarësim në Euro-zonën. Megjithatë, vendimi që Sllovenia dhe vendet tjera të jenë pjesë e zonave të cekura ishte vendim politik dhe shteteve ju lejua periudha kalimtare. Për hyrje në Euro-zonë, shteti duhet të jetë i përpiktë në plotësimin e kriteve të Maastrihit, ndonëse disa shtete-anëtare nuk kanë qenë aq të përpikta në respektim. Kjo është mënyra në të cilën funksionojnë gjërat. E them këtë për shkak se besoj që duhet t'i ngushëlloj të gjithë që ndoshta frikohen se Maqedonia mund të diskriminohet përmes kërkesave ose që nuk do të jetë në pozitë të njëjtë si shtetet tjera. Në bisedat me profesorët e shteteve të vjetra anëtare në një konferencë në Vjenë ua përcolla porosinë e njëjtë. Përgjigjja e tyre ishte "Mirë se vini në klub" që do të thotë se të gjithë shtetet kanë përfjetimet e veta.

Në fund, Sllovenia u bë anëtare e Bashkimit Evropian. Ajo që na befason është se asgjë nuk ndodhi, asgjë nuk ndryshoi në jetën e njerëzve. Pse? Për shkak se Sllovenia në fillim ishte jashtë Euro-zonës dhe sistemit informativ Schengen. Njerëzit filluan t'i vërejnë ndryshimet pas hyrjes në Euro-zonë dhe zonën e Schengenit. Euroja është pranuar mirë, kryesisht për shkak se njerëzit nuk kanë pasur nevojë të vazh-

dojnë me këmbimin e të hollave gjatë udhëtimit në shumicën e vendeve të BE-së. Përveç kësaj, Sllovenia e kishte valutën e saj vetëm një periudhë relativisht të shkurtër. Njëherazi, njerëzit tani mund t'i krahasojnë çmimet dhe rrogat, që shkakton kërkesa për rritjen e rrogave. Por, ndikimi më i madh nga pranimi i Euros ishte rritja e dukshme e çmimeve. Qeveria pohonte se ekzistojnë edhe faktorë tjerë ekonomikë relevantë, por njerëzit kanë vërejtur vetëm se çmimet janë rritur me pranimin e Euros. Po që se bisedoni me italianët, austriakët ose gjermanët, edhe ata pohojnë me kokë dhe përgjigjen: "Po, gjithçka u shtrenjtua kur e pranuan Euron". Megjithatë, njerëzit e duan Euron dhe i çmojnë përfjetimet e saj.

Efeti tjetër i madh është shkaktuar nga Sistemi informativ Schengen. Ka pasur brengosje, posaçërisht tek ata që kishin lidhje të afërta me shtetet jashtë Sistemit informativ Schengen. Për shembull, shumë agjentë turistikë janë ankuar që turistët rusë ballafaqohen me shumë vështirësi gjatë vizitave të Sllovenisë, përvoja e njëjtë ka qenë edhe me shtetasit e ish-republikave jugosllave. Këta njerëz pohojnë se Schengeni nuk është i mirë. Ai duhet të jetë i mirë për mashtruesit, por ata i ikin kontrollit kufitar, i cili vlen vetëm për njerëzit e ndershëm dhe pikërisht këta njerëz kanë probleme gjatë hyrjes në shtetet tjera. Krimi çdoherë i ik kontrolleve kufitare. Megjithatë, mendoj se njerëzit në përgjithësi janë të kënaqur nga Sistemi informativ Schengen.

Kur flitet për lëvizjen e lirë të forcës së punës, në ende i ndiejmë të gjitha efektet. Kuptohet, ngadalë e vërejmë ardhjen e forcës së punës, kryesisht nga ish-shtetet lindore evropiane. Kjo nuk krijon probleme tani, por duhet të presim dhe të shohim çka do të ndodhë, ndoshta problemet shfaqen më vonë. Kemi vërejtur që ka rritje të të pastrehëve nga disa



vende dhe janë rritur aktivitetet e krimit të organizuar. Por, sfida e vërtetë vjen pas ndryshimit të pozitës së shteteve të vjetra anëtare dhe pas fillimit të liberalizimit të plotë me shtetet e vjetra anëtare. Ajo që mund të ndodhë, ndonëse nuk jam i sigurt, është që mund të ketë fluks të forcës së punës më të kualifikuar, si dhe ikje të kuadrit të mençur nga ana tjetër. Nëse kjo ndodh, mbetet ta shohim urtësinë e politikanëve tonë për ballafaqim me dukurinë e këtillë.

Në fund, dëshiroj të flas për fuqinë e Komisionit dhe të Gjyqit evropian të drejtësisë. Përveç publikut të interesuar, nuk ka njohuri të gjerë për këtë çështje. Mendoj se Bashkimi Evropian gabon me programin për përfshirje lokale, si që e kam emëruar. Kështu, kur ka ndonjë problem me Komisionin Evropian, mediat nacionale raportojnë për ndodhitë, por përqendrohen më shumë ose më pak vetëm në njërin anë, gjegjësisht në anën e Qeverisë. Ata nuk raportojnë për anën tjetër të rrëfimit - Bashkimin Evropian, Komisionin ose Gjyqin. Mund të them që kjo nuk është veçanti vetëm për ne, por për të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian. Qeveria çdoherë ia përshkruan meritat vetes pas miratimit të ndonjë mase të volitshme për banorët. Por, kur ka ndonjë masë që nuk gëzon shumë popullaritet nga banorët, përgjigjja është: "Kjo është Bashkimi Evropian dhe kemi qenë të detyruar të veprojmë kështu". Në këtë mënyrë, deformohet imazhi për Bashkimin Evropian në opinion.

Më duhet të them edhe diçka. Në Slloveni ka rënë përkrahja për Bashkimin Evropian. Në fillim, mbështetja për procesin e anëtarësimit ka qenë mes 80% dhe 90%, kurse tani ka rënë mes 53% dhe 63%. Prapëseprapë, do të them që njerëzit janë në përgjithësi të kënaqur që shteti i tyre është anëtar i BE-së, meqë e ndiejnë që është më mirë brenda Bashkimit Evropian, sesa jashtë. Mbetet të shohim nëse kjo do të ndryshojë gjatë krizës. Me siguri që ekspertët do të thonë se kriza do të ketë goditje shumë më të fuqishme nëse vendi gjendet jashtë Bashkimit Evropian. Publiku i interesuar është gjithashtu i kënaqur që shteti është pjesë e Bashkimit Evropian, për shkak se qeveria nacionale dhe shteti i nënshtrohen rregullave dhe rregullativave të përbashkëta për shumicën e shteteve evropiane, që vëzhgohen nga jashtë dhe kjo është shumë e mirë. Politikë nacionale autonome në bashkëlidhje me veçoritë e tranzicionit nuk sjellin çdoherë rezultate optimale. Publiku i interesuar do të ishte më i brengosur po që se politikanët kishin duar të lira për të miratuar ligje sipas qejfit të tyre. Anëtarësimi në BE, pa dallim nga rruga e vështirë të cilën duhet ta kaloni dhe pa dallim gjendjes së pakëndshme në të cilën do të gjendeni pas anëtarësimit, megjithatë është gjendja më së paku e pavolitshme për shtetet dhe shoqëritë evropiane, krahasuar me opsionet tjera. Shpresoj që Maqedonia do t'i fillojë negociatat për anëtarësim sa më shpejtë, ndoshta sivjet dhe që do t'i përfundojë sa më shpejtë, me çka do të jetë e mirëseardhur në Bashkimin Evropian.

“Sa më shumë që presim, aq më tepër punë do të kemi”

QENDRA MAQEDONASE PËR ARSIM EVROPIAN

M-r Natasha Jovanova,
Drejtoare e programit



Duke menduar për debatin e sotëm, më janë kujtuar disa çështje që dëshiroj t'i ndaj me ju, duke pritur që do ta provokojnë mendimin dhe komentet tuaja, për të kontribuar në qëllimin tonë final - anëtarësimin në BE.

Pyetja e parë që ia kam parashtruar vetes, është çështja e informimit. Sa prej qytetarëve të Maqedonisë janë vërtetë të informuar me Bashkimin Evropian, trupat dhe institucionet e saj, me mënyrën e funksionimit dhe domethënies së "kushteve, kritereve dhe reperëve evropianë", cili është qëndrimi i shtetasve të Maqedonisë për pyetjen pse BE, cilat janë përfitimet dhe pasojat negative të anëtarësimit... Me rëndësi të njëjtë është edhe informimi i qytetarëve për procesin e anëtarësimit të Maqedonisë në BE, rrjedhat e këtij procesi, gjegjësisht si përparon Maqedonia në këtë drejtim, etj.

Është për tu habitur që qëllimi strategjik afatgjatë dhe prioriteti më i lartë i shtetit të Maqedonisë, që gëzon mbështetje të jashtëzakonshme, pothuajse konsensuale nga të gjitha partitë politike dhe qytetarët, po trajtohet në mënyrë kaq joserioze dhe të papërgjegjshme. Kjo dëshmohet me faktin që shteti pothuajse nuk ka ndarë mjete për promovimin e qëllimit të saj. Vështirë merren informata për ngjarjet që janë esenciale për avancimin e shtetit. Fatkeqësisht, edhe mediat informojnë në masë të pamjaftueshme

për çështjet e lidhura me BE-në. Vërehet mos-përpikëri e madhe, ndonjëherë edhe qëndrim paushal, shpesh herë edhe kundërthëniet në informimin rreth proceseve integruese. Si rezultat i kësaj, qytetarët, të cilët në të gjitha anketat e mbështetin BE-në me përqindje të lartë, janë pak të informuar për çështjet e lidhura me BE-në. "Kundërthënie" të veçanta ekzistojnë edhe në rrefimin tonë "evropian".

Aderimi i Maqedonisë në BE nuk është dhe nuk guxon të jetë politikë e lartë, nuk është as politikë e pastër e jashtme dhe në fund - nuk është çështje e disa politikanëve, që ndodh në kabinete pas dyerve të mbyllura. Përkundrazi, euro-integrimi është politikë e brendshme e Maqedonisë dhe çështje me interes vital për çdo qytetar. Në BE anëtarësohet shteti Maqedoni, por qytetarë të BE-së do të jenë qytetarët e Maqedonisë. Së këndejmi, besoj që nëse dëshirojmë ta shpejtojmë procesin e integritit dhe t'i përfitojmë gjërat pozitive, duke i evituar pasojat negative, duhet ta përfshijmë tërë opinionin publik në këtë proces. Kontributi optimal mund të jepet vetëm nga qytetarët e informuar mirë. Shteti i jonë e ka miratuar para ca kohësh Strategjinë për informimin dhe komunikimin publik në procesin e anëtarësimit, që në radhë të parë realizohet nga Sekretariati për çështje evropiane (SÇE). Por, në ueb-faqen e SÇE-së nuk mund të gjenden raportet e zakonshme mujore për një kohë të



gjatë, prej të cilave merren informata, si dhe shumë dokumente tjera të rëndësishme. Ato që publikohen janë të vjetra, kurse shumica e dokumenteve strategjike që lidhen me instrumentet e para-anëtarësimit dhe Programeve të bashkësisë as që janë përkthyer në maqedonisht. Planet operative për realizimin e Strategjisë, që përmbajnë aktivitete dhe masa për realizim nuk miratohen për një kohë të gjatë. Ministrinë, si bartëse të procesit, japin informata sipërfaqësore, të pakta ose aspak nuk informojnë për përparimin e tyre në këtë proces. Nuk ka fushata të gjëra dhe mbarëpërfshirëse në mediat e shtypura dhe elektronike, të cilat do ta informojnë publikun e Maqedonisë për procesin e integritimit në mënyrë të vazhdueshme, të gjerë dhe transparente. Broshurat, afisheet, pamfletet dhe buletinet e parapara, Eurobusi (biblioteka lëvizëse e BE-së) dhe materialet tjera të shtypura, audio dhe video, si vegla për përhapjen e informatave nuk përgatiten për një kohë të gjatë. E njëjta ngjan edhe me ditët për informimin e palëve të përfshira. Injorimi i publikut pro-

fesional dhe të prekur, kapaciteti dhe energjia e të cilit duhet shfrytëzuar në proces, është problem plotësues. Procesi i konsultimit, në vend që të jetë i gjerë dhe mbarëpërfshirës, është zvogëluar dukshëm dhe është tejet selektiv, me çka shndërrohet në "pro forma".

Pyetja e dytë, e lidhur me çështjen e informimit, lidhet me të a.q. kapacitet absorbues të shtetit, gjegjësisht aftësisë dhe përgatitjes për shfrytëzimin e ndihmën para-anëtarësimit të BE-së, me të cilin duhet të lehtësohet dhe përshpejtohet tranzicioni i RM-së prej shtetit-kandidat në shtet-anëtar. Kur flitet për ndihmën para-anëtarësimit për BE, kryesisht mendohet në Instrumentin për ndihmë para anëtarësimit (IPA), që e mbështetë përgatitjen dhe ndërtimin e institucioneve dhe strukturave të nevojshme për pjesëmarrjen e ardhshme në fondet strukturore dhe kohezive të BE-së. Një burim tjetër i mjeteve janë edhe të a.q. programe të bashkësive, që financohen nga BE dhe e mbështetë bashkëpunimin e shteteve-anëtare me politikat e ndryshme të BE-së, si që është politika për punësim,

inovacion, të rinjtë, kultura, arsimit, hulumtimi dhe zhvillimi, etj.

Një program i këtillë është "Evropa për qytetarët" me buxhet prej 215 milionë eurove, që janë në dispozicion të Republikës së Maqedonisë prej 19 marsit 2009. Programi e promovon qytetërimin aktiv evropian, duke i përkrahur aktivitetet e organizatave lokale dhe grupeve të qytetarëve. Por, fatkeqësisht, programi as që ceket në ueb-faqen e Ministrisë kompetente (për Arsim dhe shkencë). BNJVL-ja prej anës tjetër, informon për Programin duke informuar për ndonjë takim të mbajtur jashtë vendit, kurse mediat nuk e promovojnë programin për palët e përfshira. Vështirë që programi do të ketë ndonjë sukses, nëse qytetarët nuk janë të informuar për ekzistimin e tij, mundësitë e ofruara dhe mënyrat për shfrytëzimin e programit. Programet tjera të këtij grupi janë CIP (për konkurrencë dhe inovacione), programi për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (me buxhet prej 3,7 mld euro), Programi i kornizës së shtatë për hulumtim dhe zhvillim (50,5 mld euro), Mësimi i përjetshëm (6,97 mld euro) dhe të Rinjtë në aksion (855 mil euro).

Mosinformimi dhe mungesa e kapaciteteve janë posaçërisht brengosëse, nëse merret parasysh fakti që fondet e BE-së shpenzohen në bazë të transparencës, por me procedura dhe rregulla tejet komplekse. Për këtë arsye, faza e aderimit ose përafrimit në BE nuk është asgjë tjetër, por një fazë përgatitore për anëtarësim në BE. Suksesi i jonë, si anëtar i ardhshëm i barabartë, do të varet nga përpjekjet që i bëjmë sot - në nivel qendror dhe lokal. Kjo do të thotë se do të ballafaqohemi me rrezikun që "të hyjmë" në këtë punë pa përgatitje të mjaftueshme, të mos i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë dhe ta pranojmë atë që na ofrohet ose të citoj një broshurë të SÇE-së: nëse nuk luftojmë për atë që e duam, do të duhet ta duam atë që e fitojmë.

Çështja e tretë lidhet me procesin e negociatave - ky proces është shumë i gjatë, tejet kompleks dhe shumë i vështirë që realizohet në shumë nivele dhe kërkon mobilizim maksimal të mbarë shoqërisë. Fillimi i shpejtë i negociatave është posaçërisht i rëndësishëm, nëse dihet që BE është organizatë shumë dinamike që vazhdimisht rritet, zhvillohet dhe mbindërtohet. Në përkthim, kjo do të thotë që rritet numri i politikave, fushave ku angazhohet BE dhe në fund - numri i akteve nënligjore të shndërruara në kapituj për të cilat duhet të negociojmë. Thënë ndryshe, sa më shumë që presim, aq më tepër punë do të kemi. Sa më larg që jemi nga BE, aq më pak do të mund të ndikojmë mbi atë. Për këtë arsye, negociatat dhe anëtarësimi në BE duhet të ndodhë tani, jo nesër.

Në tetor, Maqedonia e ka fituar rekomandimin e Komisionit Evropian, të cilin e priste katër vite për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, pas plotësimit të tetë kritereve nga Partneriteti para-anëtarësim, dokument kyç që i përcakton prioritetet afatshkurte dhe afatgjate, gjithsej rreth 180. Meqë Maqedonia ka edhe shumë obligime, duhet të punojë shumë, por dinamika nuk mjafton - nëse për tetë kritere na janë nevojitur 3 vite, për 180 detyra do të na nevojiten 6 dhjetëvjeçarë! Sa do të na duhet t'i plotësojmë detyrat për anëtarësim fuqiplotë?!

Negociatat, në aspektin e thjeshtë, rrjedhin kështu: pas marrjes së dritës jeshile për fillim, puna e parë e Komisionit Evropian është "skenimi i legjislacionit" me të cilën vlerësohet niveli i (mos)dakordimit me legjislacionin e BE-së, kapitull pas kapitulli. Ky proces mund të zgjatë deri në 12 muaj. Pastaj, KE e harton raportin dhe ia dorëzon shteteve-anëtare për t'i ndërmarrë pozitat e përbashkëta negociatore. Edhe Maqedonia duhet t'i përgatisë qëndrimet negociatore para fillimit të bisedimeve. Meqë bisedimet me BE-në nuk

janë negociata klasike, me rëndësi esenciale për shtetin është të ketë pozita cilësore për bisedime. Për ta arritur këtë, Maqedonia duhet ta njohë më mirë gjendjen në fushat e caktuara, për të qenë e gatshme për parashikimin e afateve kohore dhe mjeteve financiare, që nevojiten për dakordimin e plotë me normat dhe standardet evropiane. Përgatitja e pozitave negociatore të Maqedonisë dhe BE-së mund të zgjatë deri në 6 muaj. Negociatat faktike, nga ana tjetër, udhëhiqen sipas kriterëve të përcaktuara për fillimin dhe mbylljen e kapitujve. Kohëzgjatja mesatare e negociatave lëvizë mes 4-6 viteve. Së këndejmi, nëse Maqedonia fiton datë sivjet, negociatat përfundojnë në vitin 2015, në rastin më të mirë dhe Maqedonia mund të shpre-

sojë për anëtarësim në vitin 2016, pas ratifikimit të Marrëveshjes për anëtarësim nga të gjitha 27 shtetet-anëtare (28 me Kroacinë).

Cilësia e zgjedhjeve që do t'i kemi në ardhmëri varet nga përgatitja e mirë e negociatave dhe cilësisë së pozitive të ndërmarra, përveç strukturës së nevojshme institucionale. Nevojitet që Qeveria ta udhëheqë procesin me transparencë maksimale dhe t'i përfshijë të gjithë faktorët në shoqëri. Sa më e mirë të jetë përgatitja e palëve të përfshira, aq më "lehtë" do të rrjedhë anëtarësimi i Maqedonisë.

Shpresoj që edhe fushata e jonë "Aksioni për Evropë" do ta jep kontributin e vet për plotësimin e këtij qëllimi.



“Jam këtu për ta ndihmuar përforcimin e miqësive mes shteteve dhe popujve tonë”

ZYRA PËR LIDHJE E REPUBLIKËS SË GREQISË

Sh. S. Znj. Aleksandra Papadopulu,
Ambasadore, Udhëheqëse
e Zyrës për lidhje



Në gazetën këtu lexojmë dhe prej politikanëve dëgjojmë për gjasat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe kjo tingëllon shumë mirë. Kjo është mirë dhe premtion shumë, por rruga për në anëtarësim nuk është e lehtë. Unë jam mjaft e rritur dhe e kujtoj Greqinë para anëtarësimit në BE. Dallimi është i jashtëzakonshëm, jo vetëm në aspektin ekonomik, ndonëse shpesh herë dëgjojmë vetëm për përfitimet ekonomike. Për mua, momenti më i rëndësishëm zhvillimor ka ndodhë në nivelin social dhe ndryshimet e mëvonshme në mentalitetin e njerëzve. Rruga drejt Bashkimit Evropian nuk ka qenë e lehtë për vendin tim dhe kuptohet, nuk ndodhi për një natë. Anëtarësimi është proces i gjatë, i cili zgjati për dy vite dhe rezultatet janë marramendëse. Por, janë nevojitur shumë përpjekje për ndryshimin e mentalitetit të popullit grek, për hapjen e horizonteve dhe transformimin e shoqërisë tonë në shoqëri më tolerante dhe bashkëkohore.

Dëshiroj të fokusohem më tepër në partneritetin mes dy vendeve tona - partneritet që shkon përtej projektit evropian, por është me rëndësi esenciale për perspektivën tuaj evropiane dhe ardhmërinë e rajonit tuaj. Qytetarët e Gjevgjeliës dhe shtetasit grek nga ana tjetër e kufirit janë një shembull i mirë i këtij partneriteti - kjo e ilustron afërsinë tonë dhe tregon sa larg mund të shkojmë. Si hap i parë, partneriteti jonë është ekonomik dhe filloi menjëherë pas mëvetë-

sisë tuaj para 18 viteve. Në fillim ishte modest, por u rrit dukshëm pas nënshkrimit të Marrëveshjes së përkohshme. Marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve zhvillohen në nivele të ndryshme: investimet direkte në sektorin privat, ndihma e qeverisë greke për zhvillim, bashkëpunimi tejkuftar përmes IPA programeve, ndihma greke për rindërtimin e vendeve ballkanike. Ky është projekt rajonal në të cilin shteti i juaj merr pjesë si partner, me qëllim të investimeve direkte në mbarë rajonin, me masa konkrete.

Kur flasim për investimet direkte private, Greqia është investuesi më i madh i huaj në vendin tuaj. Kapitali i investuar nga kompanitë greke është rreth një miliard euro dhe numri i të punësuarve direkt në këto kompani tejkalon 200.000. Fushat në të cilat janë realizuar këto investime kanë rëndësi strategjike për çdo vend: energjetika, telekomunikacioni dhe sektori bankar, si dhe tregtia dhe prodhimi i tekstilit. Prania e ekonomisë greke në këtë shtet nuk është ndërprerë as në periudhat e ndjeshme, si që ishin ngjarjet e vitit 2001. Marrëdhëniet ekonomike mes dy vendeve nuk janë ndikuar nga çështjet politike, kurse afaristët prej dy anëve të kufirit punojnë në mjedis të liruar nga politika.

Ndihma zhvillimore greke kanalizohet përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe fokusohet në fushat me efekt më të madh social, si për shembull ndihma



për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, krijimi i projekteve në bashkësitë e vogla me nevoja të mëdha sociale, ndërtimi ose rindërtimi i shkollave, përkrahja për njerëzit në themelimin e bizneseve të tyre ose fitimin e njohurive në fusha të ndryshme, si që është fusha e teknologjive të reja. Një pjesë e madhe e ndihmës është orientuar edhe drejt projekteve për mbrojtjen e mjedisit jetësor, që ka rëndësi të jashtëzakonshme meqë ne kemi kufi të përbashkët dhe ndajmë fusha me rëndësi të madhe ekologjike. Liqeni i Dojranit dhe ai i Prespës, bashkë me lumin Vardar janë trashëgimia jonë e përbashkët natyrore dhe dy vendet janë përgjegjëse për ruajtjen e tyre për gjeneratat e ardhshme.

Afrimi i njerëzve është një pjesë e procesit evropian të integritimit dhe afrimit. Bashkëpunimi mes komunave ka rëndësi esenciale për arritjen e këtij qëllimi. Njerëzit duhet të gjejnë çdo ditë mënyra të bashkëpunimit, për shkak se ne kemi interesa të përbashkët. Së këndejmi, është e rëndësishme të punohet mirë në nivel lokal dhe të vazhdohet me projektet që sjellin përfitime për të gjithë. Pikërisht këtu fillon krijimi i bashkëpunimit të mirë dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore. Komunitat prej dy anëve të kufirit e kanë kryer mirë punën e parashtrimit të projekteve për financim nga të hollat evropiane. Kur flitet për bashkëpunimin tejkuftar, shtetet tona kanë arritur përparim të shkëlqyeshëm, edhe pse ka hapësirë për shumë më tepër.

Përfundimi i përgjithshëm është që edhe pas anëtarësimit tonë në Evropë, një prej gjërave që është dashur t'i mësojmë ka qenë ndryshimi i të menduarit. Të gjithë ne jemi të ndryshëm dhe kemi qëndrime të ndryshme për çështjet e njëjta. Por, kjo vjen në plan të dytë. Më e rëndësishme është të mësojmë nga njëri-tjetri, t'i këmbejmë përvojat dhe t'i ndihmojmë njëri-tjetrit. Fokus i kryesor i përkushtimeve tona duhet të jetë ajo që na afroh. Ne jemi fqinjë dhe jetojmë së bashku me vite, duhet të vazhdojmë të jetojmë bashkë. Ne nuk mund ta ndryshojmë gjeografinë dhe nuk guxojmë ta bëjmë këtë. Ne jemi shumë të lumtur me fqinjët tonë. Ky ka qenë leksioni që është dashur ta mësojmë në Greqi - t'i pranojmë fqinjët tonë dhe të jetojmë me ta. Ky proces është i gjatë dhe duhet të arrihet patjetër prej të gjithëve në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Nëse të gjithë fillojmë ta bëjmë këtë, do të jemi një hap para kohës dhe historisë. Jam e sigurt që kemi ardhmëri të shkëlqyer së bashku dhe jam e sigurt që bashkëpunimi i shkëlqyeshëm që ekziston mes Gjevgjelisë dhe qyteteve tjera do të zgjerohet më tej. Dëshiroj tu siguroj se Greqia do të jetë partner i juaj në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Vendet tona kanë partneritet strategjik, ne jemi të vendosur tu ndihmojmë në këtë rrugë. Jemi të vetëdijshëm për dallimet që i kemi, por në këtë kuptim nuk kemi nevojë të flasim për dallimet - këtu jam për ta ndihmuar përfundimin e miqësisë mes shteteve dhe popujve tonë.

“Pjesa më e madhe e frikës për Bashkimin Evropian nuk është asgjë më shumë se paragjykimë”

INSTITUTI EVROPIAN
NË LOGJ

D-r Krazimer Sobotka,
Drejtor



Polonia ka kaluar rrugë të gjatë për në Bashkimin Evropian, filluam në vitin 1994, me nënshkrimin e Traktatit evropian, dokument ky që na e hapi rrugën drejt Bashkimit Evropian. Ky është dokumenti bazë për anëtarësimin e Polonisë në BE. Kjo rrugë përfundoi në vitin 2004 kur më në fund u anëtarësua në BE. Sot festojmë 5 vite nga anëtarësimi i shtetit tonë.

Polonia është vend unitar me rreth 38 milionë banorë. Sistemi i jonë politik është demokraci presidenciale parlamentare me Parlament dydhomësh - Dhomën e poshtme dhe Senatin. Që nga fundi i sistemit komunist, në vitin 1989, Polonia ka kaluar një transformim të dyfishtë - sistemi politik dhe ekonomik është shndërruar në demokraci stabile, ekonomi paratregtare dhe i ka përshtatur ligjet dhe institucionet e saj me standardet e BE-së. Përveç kësaj, gjasat për anëtarësim në BE dhe vetëdija e rritur për nevojën e strukturës më të fuqishme të vetëqeverisjes kanë rezultuar me reforma në nivel rajonal. Si pasojë, Polonia e ka reformuar edhe administratën e saj. Në Poloni, ne kemi pushtete të fuqishme rajonale dhe lokale. Vetëqeverisja e shtetit tonë është bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale të vitit 1919, kur janë themeluar njësitë e vetëqeverisjes lokale (gminas) dhe provincat (dukat). Anëtarësimi i Polonisë në BE ka qenë qëllimi përfundimtar i tërë procesit të tranzicionit të ekonomisë dhe sistemit politik të vendit.

Procesi dhjetëvjeçar i anëtarësimit ka qenë i shoqëruar edhe me frikë. Në radhë të parë, kur njerëzit

diskutonin për anëtarësimin e ardhshëm të Polonisë, ankoheshin që kompanitë polake do të bankrotojnë pas anëtarësimit, toka do të blihet kryesisht prej Gjermanëve dhe të huajve të tjerë dhe që do ta humbim identitetin. Ndonëse kanë kaluar 5 vite nga anëtarësimi, frika e këtyllë edhe më tej ekziston. Kohëve të fundit thuhet që Bashkimi Evropian do të na detyrojë t'i pranojmë martesat homo-seksuale dhe qëndrimet dhe sjelljet tjera jomorale. Por, duhet të kemi parasysh që Bashkimi Evropian nuk ka ingjerenca në fushën e moralit dhe sjelljes morale - kjo është nën ingjerenca të shteteve-anëtare. Frikët e cekura janë disa prej arsyeve më të fuqishme pse euro-skeptikët nuk dëshironin ta përkrahin anëtarësimin tonë në Bashkimin Evropian.

Është e qartë që ekzistojnë shumë moskuptime rreth ingjerencave të Bashkimit Evropian. Sot mund të shihet që blerja e tokës nga shtetasi e huaj është marginale. Polonia mbetet shtet sovran me identitet të veçantë nacional dhe kulturor. Prodhimet bujqësore polake janë konkurrenca dhe fermat tona edhe më tej ekzistojnë. Për këtë arsye, mund të themi se ka ekzistuar frika që në esencë ka qenë stereotip pa prapavijë të fortë ose pa argumente të fuqishme.

Gjatë periudhës kalimtare, Polonia pranoi ndihmë të para-anëtarësimit përmes instrumenteve FARE, ISPA dhe SAPARD, për të cilat mendoj se shfrytëzohen edhe nga Maqedonia.

Më lejoni t'i prezantoj rezultatet e anëtarësimit tonë në Bashkimin Evropian. Në radhë të parë, këto



janë rezultatet makroekonomike. Ndikimi i anëtarësimit në BE dhe fondet evropiane kanë ndikuar për rritjen serioze të të ardhurave tona nacionale dhe të shkallës së BPV-së. Kemi pranuar transfere direkte financiare në shuma të jashtëzakonshme. Do tu tregoj vetëm diçka për shumën e mjeteve në dispozicion - në periudhën 2004-2006, transferet arritën në vlerë prej 12 miliardë eurove. Në perspektivën e re buxhetore të BE-së, që e mbulon periudhën 2007-2013, Polonia do të merr 68 miliardë euro. Kjo është ndihmë serioze që e lëvizë ekonominë tonë në drejtim që të bëhemi një prej ekonomive më të mira në BE. Përveç kësaj, Polonia është shteti i vetëm anëtar që ka tregues mjaft të mirë ekonomikë, madje edhe në kohën e krizës globale. Së bashku me faktorët tjerë, kjo është rezultat i anëtarësimit në BE dhe ndihmës vërtetë serioze.

Elementet tjera të suksesit polak lidhen me bilancin tregtar dhe investimet direkte në ekonominë tonë. Pas anëtarësimit, kemi qenë dëshmitarë të rritjes së jashtëzakonshme të investimeve të huaja në ekonominë tonë. Bujqësia është një prej fushave që ka pasur

efekte serioze nga anëtarësimi në BE. E ceka paraprakisht që para anëtarësimit, fshatarët polakë ishin euro-skeptikë, për shkak se frikoheshin që të huajt do ta blenë tokën dhe prodhimet tona bujqësore nuk do të jenë konkurrencte, në krahasim me prodhimet e Bashkimit Evropian. Sot, prodhimet tona janë mjaft konkurrencte dhe bujqit marrin pagesa direkte nga BE. Si rezultat i kësaj, bujqit polakë u shndërruan në euro-entuziastë. Kështu, ndryshimi i mentalitetit dhe mendimit tek banorët e fshatrave është vërtetë tepër i madh.

Edhe perspektiva makroekonomike është e rëndësishme, për shkak se bizneset e vogla janë frikuar para anëtarësimit që kompanitë e tyre nuk do të jenë mjaft konkurrencte në BE. Puna e kompanive të vogla dhe të mesme tani rrjedh mirë dhe ata ballafaqohen shumë mirë me konkurrencën e shteteve të vjetra anëtare të BE-së.

Cila është perspektiva politike? Në planin politik, anëtarësimi në BE është sukses. Polonia është një prej lojtarëve seriozë në forumin politik të BE-së dhe në politikën e jashtme. Një prej sukseseve më të mëdha

të diplomacisë dhe politikanëve polakë është krijimi i Partneritetit lindor, që është rezultat i aktivitetit të diplomacisë suedeze, çeke dhe polake. Partneriteti lindor përfshin gjashtë shtete të Evropës lindore dhe Bjellorusinë, Ukrainën, Gjeorgjinë, Armeninë dhe Azerbajxhanin. Polonia është një prej promotorëve më të mëdhenj të ndihmës për vendet e cekura dhe për anëtarësimin e tyre të ardhshëm në Bashkimin Evropian.

Edhe perspektiva sociale është e rëndësishme, veçanërisht në aspekt të tregut të punës dhe migracionit. Tregu i punës ka qenë shumë i suksesshëm në vitet e para pas anëtarësimit tonë. Në vitin 2007, niveli i papunësisë është ulur në 9% ose 8%. Në periudhën e krizës globale, shkalla e papunësisë është më e ulët se në shtetet tjera të Bashkimit Evropian. Sot, kjo shkallë arrin 11% dhe ne besojmë që do ta mbajmë këtë nivel. Pas anëtarësimit në BE, shumë polakë emigruan në Evropën perëndimore, kryesisht në Irlandë dhe në Britani të Madhe, ku fluksi i emigrantëve ishte më i lartë. Ndonjëherë bënim shaka duke thënë se Londra është duka e 16 polake, për shkak të migracionit të jashtëzakonshëm në Londër.

Çka mendon opinioni publik në Poloni për ardhmërinë tonë në Bashkimin Evropian? Një institut e hulumtoi mendimin publik në prill të vitit 2009 me këtë pyetje: Nëse të dielën duhet të mbahet referendum për

anëtarësimin e Polonisë në BE, a do të votoni "për" ose "kundër" anëtarësimit? Sipas TNSOBOP (njëra prej anketave më të famshme në Poloni), pranimi i anëtarësimit në BE ka arritur deri në nivel të pabesueshëm prej 90%. Shoqëria polake është mes shoqërive me orientim më të lartë pro-evropian. Rezultatet e anketave tregojnë që pranimi i BE-së tek fermerët rritet me kalimin e viteve, duke arritur përkrahje aktuale prej 70%, që është mbështetje mjaft e lartë. Menaxherët dhe studentët janë qytetarët me orientim më të lartë pro-evropian. Në përgjithësi, popullata rinore ka kryesisht orientim të këtuillë. Një pyetje tjetër e parashtruar në anketë ishte: A është anëtarësimi në BE i dobishëm, relativisht i dobishëm ose i pavolitshëm për Poloninë? Niveli i përgjigjeve "relativisht i volitshëm" po rritet me kalimin e viteve. Si përfundim, mund të theksoj se popullata dhe shoqëria jonë janë të bindur se anëtarësimi në Bashkimin Evropian është i dobishëm për shtetin tonë.

Pyetja e radhës u parashtrua për pozitën e Polonisë në BE. 64% e përgjigjeve tregonin që ne kemi pozitë modeste të ndikimit në BE, kurse 27% e banorëve u përgjigjën që pozita e Polonisë është mjaft e fuqishme dhe me ndikim.

Çka ndodh me identitetin tonë? Shoqëria e jonë është mjaft fetare. Në kuadër të Bashkimit Evropian, Polonia, Malta dhe Irlanda konsiderohen si shoqëri më



fetare. Pesë vite pas anëtarësimit, besimi jonë fetar nuk ka pësuar ndryshime, që do të thotë se nuk është e vërtetë se anëtarësimi në BE e zvogëlon karakterin fetar të shoqërisë. E njëjta vlen edhe për patriotizmin, që mbetet në nivel të njëjtë, Cilat janë qëndrimet e polakëve dhe evropianëve ndaj punës? Para anëtarësimit, qytetarët tonë besonin se evropianët janë punëtorë më të zellshëm, kurse ne jemi shumë dembelë. Me pesë vite përvojë dhe migracion tepër të lartë në BE, ne jemi të bindur që në 80% të rasteve ne jemi punëtorë më të mirë. Kjo e ka përmirësuar identitetin tonë dhe ne krenohemi me faktin që jemi punëtorë të mirë në Britaninë e Madhe, Irlandë dhe shtetet tjera- nikoqire të emigrantëve tonë.

Fatkeqësisht, informimi për çështjet evropiane nuk është në nivel të kënaqshëm. Edhe sot, pesë vite pas anëtarësimit, shohim se duhet të informohemi për tepër për Bashkimin Evropian dhe integrimin evropian. Prapëseprapë, nuk duhet të brengosemi tepër. Kur Komisari Verhojgen e vizitoi institutin tonë në Logj, ju ankova ndihmësit të tij se shoqëria jonë civile nuk është e informuar mirë për Bashkimin Evropian. Mos u brengosni, më tha ai, për shkak se edhe kunata ime më pyeti se ku punoj. Kur i thash që punoj në Komi-

sionin Evropian, ajo mu përgjigj "Po, në KE në Nica të Francës". Së këndejmi, mbetet edhe shumë për tu bërë - informata, informata dhe informata. Nëse nuk e dimë se çka është Bashkimi Evropian, do të na kaplojë frika për të cilën biseduam.

Çështja e fundit për të cilën do të flas është përgjigjja për pyetjen: Cilat janë mundësitë dhe rreziqet për ardhmërinë e Bashkimit Evropian? Një përgjigje interesante për rreziqet e ardhshme për BE-në është problemi me qëndrimet e rritura nacionaliste dhe ksenofobe. Sipas idesë së themeluesve, BE duhet të jetë kontinent i integruar, pa shovinizëm dhe pa nacionalizëm, që mund të duket si tepër idealiste. Mendoj që Evropa ka shans të mirë të jetë kontinent i bashkëpunimit dhe jetës së qetë në të gjitha shoqëritë.

Polonia është një prej shteteve që e përkrah fuqishëm anëtarësimin e shteteve të reja. Ne e mbështetim zgjerimin, e përkrahim anëtarësimin e ardhshëm të Ukrainës, Bjellorusisë dhe shteteve të Ballkanit. Kështu që, nëse ndonjë vend evropian dëshiron të ketë partner për tu bërë kandidat i ardhshëm për anëtarësim, duhet t'i drejtohet Polonisë. Ne kemi orientim të fuqishëm pro-evropian dhe shpresojmë ta shohim BE-në me të gjitha shtetet e kontinentit.

“Partia e mençur politike e lë anash fjalimin e mbingarkuar politik, për të mirën e shtetit”

QENDRA GREKE PËR
STUDIME DHE
HULUMTIME EVROPIANE

Nikos Frangakis,
Avokat, Kryetar i Bordit
të drejtorëve



Përvoja e "parë" evropiane e Greqisë ka ndodhur në vitet e '60, kur Greqia ishte shteti i parë që aplikoi dhe e fitoi statusin special në Bashkësitë e atëhershme evropiane. Po të mos ishte regjimi diktatorial, që filloi në vitin 1967, ky raport do të zhvillohej i papenguar. Në përgjithësi, vitet e shtatëdhjeta ishin të rëndësishme për Evropën lindore - në këtë periudhë ishim dëshmitarë të rënies së tre regjimeve diktatoriale në Greqi, Spanjë dhe Portugali. Që në vitin 1975, Kryeministri i atëhershëm grek Kostas Karamanlis, insistonte që agjenda evropiane të përshpejtohet dhe që Greqia të bëhet anëtare fuqiplotë sa më shpejtë që është e mundur. Vizioni i tij atëbotë ndahej nga shumica e grekëve, gjegjësisht që bashkëngjitja në Bashkësinë evropiane ekonomike ka rëndësi esenciale për konsolidimin e demokracisë në vend dhe për zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë evropiane. Është e qartë që aspektet ekonomike kishin rëndësi të madhe. Por, në anën ekonomike Greqia nuk ishte e përgatitur në atë kohë për anëtarësim dhe këtu duhet theksuar fakti që Raporti i Komisionit Evropian për kandidaturën greke ka qenë shumë i kujdesshëm, pothuajse negativ.

Nëse Këshilli i ministrave e pranonte sugjerimin e Komisionit, anëtarësimi i Greqisë do të shtyhej për një periudhë më të gjatë, posaçërisht për shkak se në atë kohë kishte zëra të fuqishëm në Evropë për

anëtarësimin e tre shteteve jugore në momentin e njëjtë. Kjo do të kishte ndikim tejet negativ për Greqinë, për shkak se nga njëra anë Greqia do të duhej të presë edhe tre-katër vite, kurse nga ana tjetër kushtet për anëtarësim do të balancoheshin në kuadër të tre vendeve, që do të ishte në dëm të Greqisë. Liderët e atëhershëm evropianë i mbështetën përkushtimet e Karamanlisit, veçanërisht Kryetari francez, Zhiskar D'Esten dhe Kancelari gjerman, Helmut Shmit. Si rezultat i kësaj, në vitin 1979 u nënshkruar Marrëveshja për anëtarësim dhe anëtarësimi filloi më 1 janar 1981.

Prapëseprapë, në shoqërinë greke nuk kishte konsensus për aderim në BEE, kryesisht për shkak të faktit se partia politike opozitare (PASOK) ishte fuqimisht kundër anëtarësimit. Kështu, kur Andreas Papandreu (PASOK) u emërua si Kryeministër në tetorin e vitit 1981, programi politik qeveritar parashihte referendum dhe shqyrtim të mbarë procesit bisedues, si dhe mundësi të jashtëzakonshme për tërheqje nga anëtarësimi. Për fat, pas ardhjes në pushtet të Qeverisë Papandreu, qasja ndaj Brukselit ndryshoi për 180 gradë, që nuk është diçka e pazakonshme në politikë dhe kështu qeveria e re morri qasje shumë pragmatike ndaj BEE-së. Shenja e parë e këtij pragmatizmi është demonstruar me parashtrimin e memorandumit të Qeverisë greke në Komision, ku në disa pika janë paraparë negociatat për dispozitat konkrete të Mar-



rëveshjes për anëtarësim. Në këtë fazë, Bashkësia evropiane nuk ka dashur ta rrezikojë atë që e ka konsideruar si të arritur demokratike: në familjen evropiane futi një shtet që e kishte hedhur regjimin diktatorial. Të mos harrojmë, Greqia u bë shteti i dhjetë anëtar në procesin që konsiderohej si zgjerim i dytë. Së këndejmi, pa dallim nga natyra e kërkesave të memorandumit, të gjitha janë miratuar dhe kanalizuar në aspektin financiar, kryesisht përmes fondeve strukturore.

Atëbotë, fakti që Greqia ishte në përparësi ndaj shteteve iberike kishte domethënie të madhe. Kjo ia dha mundësinë Greqisë për lidhjen e marrëveshjeve që pas 2-3 viteve ishin të pamundura, për shkak të rishpërndarjes së fondeve për shkak të zgjerimit vijues me Portugalinë dhe Spanjën. Do ta shpjegoj pak këtë çështje: zgjerimi me Mbretërinë e Bashkuar dhe Danimarkën ose zgjerimi me vendet skandinave dhe Austrinë janë konsideruar si "zgjerime lineare" ku çështjet financiare kanë qenë pak të rëndësishme. Të gjitha këto vende ishin relativisht të zhvilluara, me politikë të mirë sociale dhe nivel të lartë të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, krahas mesatares së BEE-së. Për këtë arsye, frika e tyre nuk lidhej me efektin financiar

të anëtarësimit, por me efektin e zgjerimit mbi këto fusha. Kjo ka rezultuar me dukurinë e Euro-skeptizmit tek britanikët dhe danezët.

Nga ana tjetër, zgjerimet tjera, si që ishte zgjerimi i dytë me Greqinë, i treti me Spanjën dhe Portugalinë dhe zgjerimi i madh në vitin 2004 ishin zgjerime të llojeve tjera - ato ishin hap i madh para dhe ishin vendime politike, të cilat i lanë anash problemet e shumta financiare dhe ekonomike. Kjo ndodhi me qëllim të arrijtes së qëllimeve të caktuara politike. Pak para folëm për rënien e diktaturave në vitet e shtatëdhjeta. Në vitin 2004 e kishim zgjerimin e madh, si pasojë e rënies së Murit të Berlinit dhe prishjes së Bllokut sovjetik. Këto ngjarje politike ia mundësuan Greqisë të negociojë sërish për kushtet e ndihmës financiare gjatë zgjerimeve të njëpasnjëshme. Aleance greke-franceze-italiane garantoj pjesëmarrje të drejtë të ndihmës financiare për jugun. Më tej, me programin për kohezion ekonomik dhe social, jugu i Evropës pranoi përsëri ndihmë financiare, pa dallim reagimeve nga shtetet nordike. Në fund, pas anëtarësimit të spanjollëve dhe portugezëve, Grekët kishin edhe një mundësi për të biseduar mbi kushtet. Klima e mirë financiare



Arnhildur
Halfadóttir



për të gjitha vendet jugore tashmë ishte krijuar, kuptohet, kjo do të thotë që Greqia edhe një herë e shfrytëzoi mundësinë të merr sa më tepër për vete.

Ajo që përpiqem ta them, është që pas anëtarësimit, do ta mësoni lojën e negociatave. Me çdo zgjerim të ri, mund të fitoni përfitime të reja. Në fund, rëndësi ka përfitimet që i keni marrë. Greqia të cilën ne e mbajmë mend para anëtarësimit nuk ka lidhje me Greqinë e sotme, kur flasim për prosperitetin dhe zhvillimin. Kjo ka qenë e qartë që prej fundit të viteve '80 dhe mund të shihet që gjendja ka ndryshuar shpejtë.

Këtë duhet ta mbani mend - kur negocioni për anëtarësimin e vendit tuaj, këtë duhet ta bëni me energji të madhe. Sfida është edhe më e madhe kur nuk bëhet fjalë për "zgjerim linear" të cilin e ceka, por për shtytje politike. Kjo u dëshmuar në vitin 2004, pse të mos përsëritet në ardhmëri? Pse të mos ketë sërish ndonjë zgjerim të madh? Pa zgjerime të mëdha, pengesat dhe vështirësitë në rrugë mund të jenë edhe më të

mëdha. E shihni se çka ndodh me Kroacinë: Kush mund të paramendonte para 3 vitesh që kandidatura kroate do të prolongohet aq gjatë? Kuptohet, kjo ndodh për shkak të pengesave. Për shtetin është me rëndësi që të lëvizë prej pjesës së problemit në pjesën e zgjidhjes.

Pas anëtarësimit, shteti ka vegla dhe mundësi për lidhjen e aleancave për ardhmëri më të mirë. E theksoj fjalën "aleanca" për shkak se kjo ndodhi me Greqinë, ne dinim si ta shfrytëzojmë pozitën tonë. Kjo ka ndodhë edhe me Bashkësinë me 10 anëtare, pastaj është përsëritur me 12 anëtarët dhe me 15 shtetet, si dhe me zgjerimin në 25 dhe më pas me të gjitha 27 shtetet-anëtare. Duhet të kuptohet që kultivimi i pritjeve maksimaliste nuk është zgjidhja më e mirë. Shembulli i negociatave të përsëritura nga PASOK në vitin 1981 e dëshmon këtë. Kjo e ka demonstruar urtësinë e një partie politike, e cila pas ardhjes në pushtet e ka lënë anash fjalorin e ngarkuar politik, me qëllim të përpjekjes për të punuar në dobi të vendit.

“Përmes ndarjes së sovranitetit deri në një nivel të caktuar, ne e kemi fituar sovranitetin e vërtetë”

INSTITUTI IRLANDEZ PËR
ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE
DHE EVROPIANE

Endru O'Rurk,
ish-Ambasador i BE-së,
Kryesues i Grupit për zgjerim



Pas historisë së vështirë disa-shekullore, në vitin 1921 Irlanda e fitoi pavarësinë nga Britania. Ne kishim ekonomi relativisht të varfër bujqësore dhe industri shumë të vogël. Kemi prodhuar uiski, birë, veshje, biskota dhe disa gjëra tjera, asgjë më shumë. Infrastruktura ishte e pazhvilluar, rrugët ishin në gjendje shumë të keqe. Sot pash rrugë të ngjashme, që më kthyen në fëmijërinë time. Nuk kishim repro-materiale. Më tepër se një shekull, kishim shkallë më të lartë të emigracionit në Evropë. Tre dhjetëvjeçarët vijues ishin periudhë vërtetë e keqe për zhvillim. Vitet '20 ishin periudhë pas-lufte, në vitet e tridhjeta e kishim depresionin e madh dhe në '40 filloi Lufta e madhe. Në vitin 1950 filloi rimëkëmbja. Atëbotë, Amerika ndihmoi në rimëkëmbjen e Evropës. Në Irlandë, u përpoqëm t'i zhvillojmë industrinë mbrapa mureve tarifore dhe kemi besuar që ato do të kenë sukses dhe do ta furnizojnë tregun vendas. Por, nuk kishte gjasa për eksport. Arritëm një përparim të caktuar, por kjo nuk mjaftonte për sigurimin e vendeve të mjaftueshme të punës. Emigracioni dhe papunësia vazhduan me shkallë shumë të lartë.

Kur në mesin e viteve të gjashtëdhjeta u krijuan mundësitë për anëtarësim në Bashkësinë evropiane ekonomike, ne ishim mjaft të varur nga tregu eksportues i Mbretërisë së Bashkuar. 70% e tregtisë tonë realizohej me Britaninë dhe valuta e jonë ishte e lidhur për Paundin. Kishim pothuajse ekonomi të plotë

bujqësore, të varur nga tregu britanik me çmime të ulëta botërore. Industrinë tona vareshin nga mbrojtja tarifore për mbijetesë. Zhvillimi ekonomik ishte i ulët, standardet e jetës ishin pothuajse 60% të mesatares evropiane, që do të thotë se ishim vendi totalisht më i varfër, i cili ka menduar për anëtarësim në Bashkësi.

Me këtë histori, mund të duket e qartë dëshira për anëtarësim në BEE dhe të mendohet se nuk ka pasur asnjë debat për këtë. Megjithatë, ka pasur argumente për dhe kundër. Argumenti kryesor në favor të bashkëngjitjes ka qenë nevoja për ta mbajtur qasjen në tregun britanik. Përveç kësaj, kishte gjasa edhe për përfshirje në tregun tepër të madh evropian, me çmime më të larta nga çmimet botërore. Anëtarësimi në BEE e ka ndihmuar investimin e brendshëm. Priteshin edhe përfitime nga Fondi rajonal dhe Fondi social evropian. Gjithashtu, konsiderohej që me ndarjen e sovranitetit deri në një nivel të caktuar, në fakt do ta fitojmë sovranitetin e vërtetë, përmes pjesëmarrjes në vendimet që kanë ndikuar në interesat tona reale. Nëse mbeteshim jashtë, si vend i vogël, nuk do të kishim asnjë rol në vendim-marrje. Kemi konsideruar që anëtarësimi i jonë do të na mundësojë pjesëmarrje të plotë me vendet tjera demokratike dhe me orientim të ngjashëm në Evropë drejt integritimit evropian, që bazohet në idealet dhe qëllimet e përbashkëta.

Por, ka pasur edhe argumente kundër, njëri prej të cilëve ishte fakti që duhej ta ndryshonim kushtetutën. Ka pasur argumente se do ta humbim sovranitetin, të cilin e fituam shumë vështirë nga Britania, jo shumë moti. Kishte edhe argumente që do t'i humbim vendet e punës në industritë tona të reja. Disa kanë konsideruar se vendet e punës do të transferohen në pjesët qendrore të BEE-së. Gjatë fushatës së referendumit, kishte një poster ku thuhej: "Dëshirojnë që vajzat tuaja të punojnë në Ruhr (rajon industrial në Gjermani)". Kjo ishte e pazakonshme, por pritej largimi i shumë njerëzve. Një argument tjetër ishte që identiteti i jonë kulturor do të rrezikohet. Është cekur që neutraliteti jonë ushtarak do të rrezikohet dhe ne ishim shumë të lidhur me këtë neutralitet. Megjithatë, në referendumin e vitit 1972, shumica e popullit votoi në favor të anëtarësimit - 83% e popullatës.

Në kohën e anëtarësimit ishim vend relativisht i varfër, por kishim disa përparësi. Kishim institucione stabile demokratike, ekonomi funksionale të tregut dhe aftësi për ndërmarrjen e obligimeve nga anëtarësimi, që ishin pjesë e arranjimeve të tranzicionit. Kishim administratë publike me funksionalitet të mirë dhe shërbime teknike në fushën e doganës, statistikës dhe shëndetit të kafshëve. Sistemi gjyqësor ka qenë me funksionalitet të mirë dhe kishim banka dhe in-

stitucione tjera, që nevojiten për qëndrueshmërinë e ekonomisë së tregut. Kishim edhe disa mangësi: shërbimi qytetar dhe ministria e jonë e vogël për punë të jashtme kërkonin zgjerim, riorganizim dhe trajnim për ballafaqim me mjedisin e ri. Sektori privat duhej të adaptohet ndaj kushteve të reja të punës.

Dëshiroj të theksoj që 15 vitet e para të anëtarësimit tonë ishin një luftë e vërtetë. Si që pritej, bujqësia lulëzonte, meqë filluam t'i përjetojmë përfitimet e qasjes së pakufizuar në treg të madh dhe çmimet më të larta. Skena rurale u transformua me më tepër investime në bujqësi, por ekonomia në përgjithësi kishte stagnim relativ. Në vitin 1973, kur iu bashkëngjitëm BEE-së, BPV e vendit tonë për kokë banori ishte rreth 60% e mesatares evropiane. Në mesin e viteve '80 ishim ende në këtë nivel, kishte zhvillim të caktuar, por nuk e mbanim hapin me shtetet më të pasura. Adaptimi ndaj tregtisë së lirë ishte i vështirë. Kemi humbur disa industri mjaft të rëndësishme. Ishte kjo kohë e recesionit botëror dhe Qeveria kishte menaxhim ekonomik mjaft të gabueshëm - shpenzimet qeveritare ishin shumë të larta, investimet ishin të ulëta dhe marrëdhëniet e punës të dobëta.

Ka fundi i viteve të tetëdhjeta, kjo ndryshoi duke i futur politikat me orientim më tregtar. Partnerët socialë arritën marrëveshje për zvogëlimin e tati-





meve dhe kërkesa modeste për rroga, që rezultoi me konkurrencë më të madhe dhe rritje të zhvillimit ekonomik dhe social. Kjo, së bashku me investimet paraprake që duhej t'i bënim në arsim, duket se funksionoi. Edhe pjesëmarrja e rritur e femrave në forcën e punës ishte faktor. Pas pjesëmarrjes, na nevojitej ta promovojmë barabarësinë e plotë të meshkujve dhe femrave. Një faktor tjetër për zhvillimin tonë, që atëherë ishte i pazakonshme, ishte integrimi më i madh evropian - Akti unik evropian hyri në fuqi në mesin e viteve '80 dhe kjo solli tregti vërtetë të lirë në Evropë. Kjo e ndihmoi atraktivitetin e bizneseve për investim në Irlandë, për shkak se pas arritjes së pajtueshmërisë me rregullat evropiane - ata ishin të lirë të eksportojnë në Evropë. Pas krijimit të Tregut të përbashkët evropian, ne kishim dobi nga përkrahja e konsiderueshme, meqë ishim një prej rajoneve më pak të zhvilluara në Bashkësitë evropiane.

Ndihma e rritur financiare nga Bashkimi Evropian kishte rol të konsiderueshëm në zhvillimin tonë - kjo ishte 3% e BPV-së irlandeze në vitet '90 dhe na ndihmoi shumë në zhvillimin dhe ndërtimin e rrugëve tona, porteve detare dhe enteve turistike, trajnimin e punëtorëve dhe përmirësimin e arsimit. Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik i Irlandës gjatë 20 viteve të fundit ishte i jashtëzakonshëm. Deri në vitin 2002, arritëm 122% të

pasurisë mesatare të Bashkimit Evropian, papunësia u zvogëlua prej 17% në 4% tek forca punuese, e cila u rrit për 50%.

Që nga fillimi i krizës financiare, kemi problem të madh me rënien e të hyrave qeveritare dhe dhënieve të serishme të borxheve nga bankat. Me rrethanat e këtilla, është shumë e rëndësishme që jemi pjesë e Bashkimit Evropian dhe Eurozonës, për shkak se marrim ndihmë të jashtëzakonshme esenciale nga Banka qendrore evropiane. Ka edhe dështime, të cilat janë nacionale dhe nuk kanë të bëjnë me Bashkimin Evropian. Ka shumë shtete-anëtare të cilave ju ecin mirë punët në këto kohëra të vështira, shumë më mirë krahasuar me Irlandën. Është e rëndësishme që të ketë politika të mira nacionale, madje edhe kur nuk jeni anëtarë të Bashkimit Evropian. Megjithatë, bilanci ekonomik dhe social i anëtarësimit tonë është i qartë - që nga viti 1973, standardi jetësor është rritur për tre herë, forca e punës është dyfishuar, eksporti është rritur për 50 herë në kushte reale dhe është arritur modernizimi i shoqërisë.

Dëshiroj të them diçka edhe për qëndrimin tonë ndaj zgjerimit. Pozita formale qeveritare është që ne e përkrahim zgjerimin, për shkak të tre arsyeve kryesore. Së pari, nevoja politike. Nëse kthehemi mbrapa dhe e shohim zgjerimin e tretë (Spanja, Portugalia dhe



Greçia), shohim tre vende që paraprakisht kanë qenë shtete nën diktaturë, kështu që ka ekzistuar nevojë politike për anëtarësimin e tyre dhe tu ndihmohet në stabilizimin e demokracive. Së dyti, imperativi moral. Ne jemi bashkëngjitur si vend i varfër dhe gjërat kanë ecur mirë që nga anëtarësimi. Së këndejmi, obligimi i jonë moral është t'i ndihmojmë edhe vendeve tjera që në fazën e hershme të zhvillimit, për përfshirje në Bashkimin Evropian dhe rritjen e prosperitetit të tyre. Së treti, mundësia historike për arritjen e stabilitetit në Evropë. E kemi parë përmirësimin e marrëdhënieve fqinjësore përmes anëtarësimit - kjo ka ndodhur në raportet tona me Britaninë. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, së bashku me Britaninë, na ka ndihmuar në arritjen e kuptimit më të mirë. Ky është qëndrimi i jonë gjeneral për zgjerimin. Por, duhet të insistojmë që Bashkimi Evropian të vazhdojë me funksionimin efektiv. Zgjerimi i BE-së nuk do të ketë kuptim nëse nuk fund kuptohet se nuk mund të funksionojë më tutje. Irlanda, si njëra prej shteteve më të vogla anëtare të BE-së, siguron trajnim dhe këshilla për vendet që aderojnë dhe kandidatët.

Të përfundoj, ekzistojnë disa leksione që duhet mësuar. Është e rëndësishme të theksohet se ne ishim shumë të lumtur kur u anëtarësua. Ndonëse

ishim vend relativisht i varfër, kishim infrastrukturë të mirë civile. Së dyti, e kuptuam rëndësinë e sistemit të mirë intern të koordinimit - të dimë çka duam dhe të shkojmë në Bruksel duke folur në një zë. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme - garantimi i pjesëmarrjes efektive në procesin e negociatave, që është esenca e negociatave. Kemi mësuar gjithashtu që bashkëpunimi me institucionet e BE-së, në veçanti me Komisionin dhe njohuria dhe respektimi i brengave të shteteve tjera anëtare janë shumë të rëndësishme, nëse dëshironi të keni veshë që bashkëndejnë me problemet tuaja.

Më tej, kemi mësuar që anëtarësimi e lehtëson avancimin ekonomik dhe social, por nuk e garanton atë. Kemi pasur situata të politikave të këqija të brendshme. Për këtë arsye, politikat tuaja duhet të funksionojnë në drejtimin e duhur. Kemi mësuar si ta shfrytëzojmë ndihmën financiare në dispozicion, me efekt më të mirë. Kemi pasur mundësi për krijimin e marrëdhënieve të mira me vendim-marrësit në Bruksel për dedikimin e shpenzimit të të hollave.

Kemi mësuar që qytetarët kanë nevojë të vazhdueshme të informohen dhe sipas nevojës, të mbesin me disponim entuziast për anëtarësim në BE, posaçërisht në rastet kur nevojitet referendumi çdoherë kur duhet ratifikuar ndonjë traktat, si që ndodh tek ne.

“BE nuk sjell asnjë vendim për ju pa ju”

AMBASADA E
REPUBLICËS SË
POLONISË

Sh. T. Z. Dariush Karol Bahura,
Ambasador



Marrëdhëniet tona diplomatike rrjedhin që nga shekulli X, kur Car Samoili dhe vëllezërit e tij janë takuar me të dërguarin e sundesit të parë polak në pallatin e perandorit gjerman. Në esencë, këto kanë qenë kontaktet e para polake-maqedonase. Dëshiroj ta theksoj edhe faktin që bashkëkombësit e mi kanë qenë të pranishëm gjatë themeimit të Republikës së Krushevs dhe kanë marrë pjesë në Kryengritjen e Ilindenit. E kaluara e këtyllë historike është privilegj, por edhe obligim për të dy shtetet të kultivojnë marrëdhënie të mira.

Që nga rimarrja e pavarësisë në vitin 1989, saktë para 20 viteve, madje edhe para anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian, themelet kryesore të politikës tonë të jashtme kanë qenë dhe mbesin mbajtja e hapur e dyerve euro-atlantike për të gjitha shtetet e kontinentit që dëshirojnë të bashkëngjiten. E themi hapur që Maqedonia është shtet i cili i takon Evropës. Maqedonia është në Evropë dhe me siguri që duhet të jetë në Bashkimin Evropian. BE asnjëherë nuk do të jetë e bashkuar pa popujt e Ballkanit perëndimor.

Jemi të përgatitur t'ia zgjasim dorën dhe t'i ndihmojmë Maqedonisë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian, jo vetëm përmes këmbimit të përvojave tona pozitive, por edhe përmes theksimit të gabimeve që i kemi bërë, me qëllim që Maqedonia të mos i përsërisë. Do ta citoj Kryetarin e parë polak të zgjedhur në zgjed-

hje të lira në vitin 1991, Z. Leh Valenca - kur mendojmë për përfitimet e Polonisë nga anëtarësimi në BE, mund të themi që "ka pluse pozitive dhe pluse negative" por me siguri të gjitha janë pluse. Cilat janë pluset pozitive dhe cilat janë pluset negative?

Ana negative është që shteti që tani synon të anëtarësohet në Bashkimin Evropian duhet ta kryejë detyrën e shtëpisë me tempo shumë të shpejtë. Keni parasysh që shtetet-themeluese kanë pasur kohë me dhjetëra vite për dakordimin e ligjeve dhe direktivave të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, shtetet që do të jenë anëtare në ardhmërinë e afërt duhet ta bëjnë këtë në periudhë shumë të shkurtër kohore. Çka ndodh me anët pozitive? Ato janë tepër të mëdha. Shteteve-anëtare, posaçërisht shteteve të reja, BE i jep mundësi për zhvillimin e arsimit, modernizimin e transportit, mbrojtjen e mjedisit jetësor, zhvillimin e industrisë, krijimin e vendeve të reja të punës, por edhe mundësisë për shfrytëzimin e ndihmës financiare për ta arritur këtë.

Që nga anëtarësimi i Polonisë në Bashkimin Evropian para pesë vitesh, tek bashkëkombësit e mi ka ndryshim të madh të mentalitetit. Tani nuk ndjehemi si qytetarë të rendit të dytë, si që jemi ndier kur kemi qenë prapa Perdes së hekurit. Jemi të barabartë me miqtë tanë nga Bashkimi Evropian. Studentët polak mund të studiojnë lirshëm në të gjitha universitetet



prestigjioze në mbarë Evropën, me çka ju jepen mundësi të barabarta dhe pikënisje të barabartë për zhvillim të karrierës.

Mbase dikush mund të pyet se cili është interesi i Polonisë për ndërtimin e bashkëpunimit polak-maqedonas. Përgjigjja më e thjeshtë është parafrazimi i këngës ish-jugosllave "Prej Vistule deri në Vardar". Shkupi dhe Varshava janë në largësi prej 1.600 km. A ka interes Polonia për mbajtjen e partneritetit strategjik me Maqedoninë dhe për promovimin e Maqedonisë si anëtare e ardhshme e Bashkimit Evropian? Përgjigjja është më e thjeshtë se që mendoni. Para një shekulli janë nevojitur 2 orë për kalimin e 20 kilometrave. Sot, po të kishte fluturim direkt, do të nevojiten 2 orë fluturim prej Varshave deri në Shkup. Jemi bërë fshat global, që do të thotë se stabiliteti ekonomik, social dhe politik në 1.600 km prej Varshave është stabilitet i Evropës qendrore. Mos-stabiliteti i Maqedonisë do të kishte pasoja edhe për stabilitetin e kontinentit, përfshirë edhe vendin tim. Së këndejmi, ne kemi interes

që Maqedonia të hyjë në zonën euro-atlantike sa më shpejtë. Kjo është thënë qartë në Bukuresht gjatë samitit të NATO-së, si dhe në Bruksel kur filluan konestet bilaterale që i tejkalojnë çështjet e anëtarësimit të vendeve në Bashkimin Evropian.

Çka mund të bëni për të qenë më të pranishëm në Bashkimin Evropian? Polonia dhe Maqedonia kanë përvoja të ngjashme historike. Dy shtetet kanë jetuar në regjime totalitare për më tepër se gjysmë shekulli. Ne jemi ballafaquar me pengesat e njëjta në fund të shekullit XX - çka të bëjmë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe të kemi pozitë stabile në BE pas anëtarësimit. Ne, polakët e kemi ditur që duhet të bashkëpunojmë me të tjerët në planin politik dhe ekonomik. Është më lehtë të arrihet diçka me shtetet tjera, sesa vetëm. Për këtë arsye, filluam të kërkojmë aleatë në Evropë. Së shpejti zbuluam që bashkëpunimi rajonal i vendeve me interesa të njëjta është mbase mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohemi. Kjo është arsyeja për krijimin e të



a.q. Grupi i Vishegradit, që përbëhet prej tre shteteve të Evropës qendrore: Çekosllovakisë, Hungarisë dhe Polonisë. Me prishjen e Çekosllovakisë në dy pjesë, në Republikën e Çekisë dhe Republikën e Sllovakisë, grupi është rritur në katër anëtarë. Kjo ka qenë bashkëpunim jo-institucional në nivel politik dhe na ka tërhequr përpara si lokomotivë drejt qëllimeve të përbashkëta - zonës euro-atlantike. Me bashkimin e katër kokave, zgjidhja e problemeve me të cilat jemi ballafaquar ka qenë më e lehtë.

Sfida e dytë ka qenë krijimi i këtij bashkëpunimi në planin ekonomik, gjegjësisht bashkëpunimit për të na mundësuar të anëtarësohemi në Bashkimin Evropian dhe kjo ka qenë goditje tejet e madhe. Përgjigjja ndaj kësaj sfide ka qenë themelimi i Traktatit të Evropës qendrore për tregti të lirë. CEFTA na ka e mundësuar shfrytëzimin e saj si simulim për politikë të hapur dhe lirë tregtare. Meqë themeluesit e CEFTA-së i kanë plotësuar qëllimet e tyre, CEFTA është zgjeruar edhe drejt shteteve të Ballkanit. Sot, Maqedonia është pjesë e CEFTA-së dhe jam i bindur që pjesëmarrja në

këtë organizatë do t'i mundësojë vendit të përgatitet për anëtarësim në BE dhe për ballafaqim me forcat konkurrense në tregun e BE-së në ardhmëri.

Kanë kaluar 70 vite që nga fillimi i Luftës së dytë botërore, kur kontinenti ka qenë tërësisht i ndarë. Ka pasur luftëra për kufij, pastrime etnike dhe vrasje masive. Kanë kaluar 20 vite nga rënia e Murit të Berlinit dhe 5 vite nga zgjerimi i madh, që është zgjerimi më i madh deri tani me 10 shtete, përfshirë edhe Poloninë. Koha kalon shpejtë, por kalon në drejtimin e duhur. BE është projekti më i madh paqësor në historinë bashkëkohore.

Kryetari i Republikës së Çekisë, Vaclav Havel, kur e ka parë flamurin e Bashkimit Evropian, ka thënë: "Këto 12 yje i shoh si përkujtim për botën të jetë vend më i mirë, nëse kemi guximin të shohim drejt yjeve". Mos i ndërprisni ëndrrat dhe keni guximin t'i plotësoni të gjitha kërkesat e BE-së dhe të bëheni anëtarë të familjes së Bashkimit Evropian. Mbani mend që përmes anëtarësimit në Bashkimin Evropian, do të jeni të sigurt që pa ju nuk do të vendoset asgjë për ju.



“Jemi pajtuar me fqinjët tonë, pa e humbur identitetin”

AMBASADA E
PORTUGALISË

Sh. T.Z. Luis de Almeida Sampajo,
Ambasador



Gjëja e parë që dëshiroj ta them është që ju i takoni Evropës dhe Bashkimit Evropian. Aspak nuk dyshoj në këtë dhe as Qeveria ime nuk dyshon. Më besoni, kjo ndjejë ekziston në mënyrë konsensuale në mbarë Bashkimin Evropian. Maqedonia i takon Evropës, nuk ka dyshim. Ky publik, njerëzit që i shoh para vetes nuk dallojnë nga njerëzit që i takoj në ngjarje të ngjashme në vendin tim. Fytyrat e njëjta, sjellja e njëjtë dhe mënyra e njëjtë e veshjes. Shumë skema i ndajmë së bashku, e ndajmë kontinentin tonë dhe kemi kulturë të afërt. Qëndrimet e Evropës së jugut, pothuajse mesdhetare i ndiej në të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor. Nuk do të them asgjë të re nëse theksoj që ndajmë shumë gjëra të përbashkëta. Por, ndajmë edhe shumë përgjegjësi. Duhet të bëhet edhe shumë që Maqedonia të vendoset në rrugën e vet drejt Bashkimit Evropian. Do ta ndaj me ju shembullin e vendit tim, Portugalisë. Çka kemi bërë, çka na ka ndodhur, ku kemi qenë para ca vitesh dhe ku jemi tani. Para revolucionit demokratik, Portugalia ka qenë vend i përjashtuar nga bashkësia ndërkombëtare. Pjesën më të madhe të shekullit XX e kemi kaluar në diktaturë, që e ka vendosur Portugalinë në izolim nga rrjedhat bashkëkohore të bashkësisë ndërkombëtare. Kemi pasur një regjim i cili është kujdesur pak për demokracinë, lirinë e të shprehurit, lirinë e mediave dhe të shtypit, si dhe për rolin e sho-

qërisë civile. Kemi bërë luftëra kolonialiste, të cilat i kanë shkatërruar financat e Portugalisë dhe që kanë detyruar shumë portugezë të emigrojnë në Francë, Gjermani, Kanada dhe SHBA. Por, gjithçka ndryshoi në vitin 1974 - revolucionin demokratik u përcoll me trazira politike. Këto ngjarje i dhanë fund luftërave koloniale dhe e hapën rrugën drejt pavarësisë së kolonive portugeze. Megjithatë, ekonomia portugeze ishte e shkatërruar. Vendi ishte plotësisht i paorganizuar. Në vitin 1976, kur aplikuum për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në Bashkësinë e atëhershme Evropiane, vendi ishte në gjendje shumë të vështirë. Është rëndë të paramendohen vështirësitë ekonomike, papunësia dhe dallimet sociale në shoqërinë e atëhershme portugeze. Na janë nevojitur dhjetë vite të gjata dhe me punë të dhembshme për të hyrë në Bashkësinë Evropiane. Është dashur të kryejmë shumë punë serioze, shumë detyra kanë kërkuar realizim mes vitit 1976 dhe 1986 për të ardhur në gjendje për plotësimin e sfidave të Bashkimit Evropian.

Pas anëtarësimit kemi qenë larg prej shteteve bashkëkohore dhe të zhvilluara. Ekonomia portugeze nuk ka qenë në gjendje as të krahasohet me ekonominë gjermane, franceze ose të Mbretërisë së Bashkuar. Edhe më tej mbetëm shtet relativisht i varfër, krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian. Sistemi arsimor, shëndetësor dhe i administratës publike kanë qenë

vetëm disa fusha ku është dashur edhe shumë punë për t'i plotësuar standardet e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, ideja e parë që dëshiroj ta theksoj është që nuk duhet të jeni plotësisht të përgatitur dhe me zhvillim të lartë për fillim serioz të integrimit evropian. Të gjithë e dinë që ndryshimet e mëdha do të ndodhin pas anëtarësimit, kur të bëheni anëtarë të familjes, të klubit. Ndryshimet e mirëfillta do të fillojnë pas anëtarësimit në BE, për shkak se atje rrjedh dinamika e vërtetë e procesit. Por, ju duhet të jeni serioz në përgatitjet tuaja. Kjo vlen për të gjithë: për Qeverinë, administratën publike, bizneset private dhe qytetarët. Roli i shoqërisë civile ka rëndësi të posaçme në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian.

Shembulli i Portugalisë mund të jetë shumë i dobishëm për shtetet si Maqedonia. Do të jap disa shembuj që e ilustronë dobinë të cilën e kemi përfituar nga fondet e Bashkimit Evropian, në kuptim të zhvillimit.

Jo shumë moti, kur në vitin 1986 jemi anëtarësuar në Komunitetet Evropiane, dy qytetet e mëdha të Portugalisë (Lisbona dhe Porto) që janë në largësi prej vetëm 300 km nuk kanë qenë të lidhur me autostradë. Sot, 20 vite pas integrimit tonë, në Portugali kemi autostrada me gjatësi totale mbi 3.000 km. Pothuajse është e pamundur të vozisni në Portugali jashtë autostradave. Të gjitha këto rrugë janë ndërtuar nga kompani portugeze, ndonjëherë në partneritet me kompani tjera evropiane, por kryesisht me ekspertizë portugeze dhe punë shumë të mundimshme. Pjesa më e madhe e mjeteve është siguruar nga fondet e Bashkimit Evropian, që janë në dispozicion vetëm pas anëtarësimit. Në vitin 1974, shkalla e vdekshmërisë tek foshnjat e porsalindura ka qenë mes më të lartave në Evropë - 35 foshnje të porsalindura kanë vdekur në 1000 foshnje të lindura. Sot, vdekshmëria është më e ulët se 3 dhe kjo është një prej shkallëve më të ulëta

jo vetëm në Bashkimin Evropian, por në mbarë botën. Sistemi jonë shëndetësor ka evoluar dhe është zhvilluar pikërisht për shkak të integrimit në Bashkimin Evropian, e njëjta ka ndodhur edhe me sistemin arsimor. Vitin e njëjtë, në 1974, më pak se 5% studentë portugezë e kanë kryer fakultetin. Më pak se 5%. Sot kjo përqindje tejkalon 90%. Këto dallime të jashtëzakonshme mund të japin pasqyrë të vërtetë për ndryshimet pas anëtarësimit. Ka edhe çështje tjera, shumë më të rëndësishme, si që është zhvillimi i dukshëm social. Tani jemi anëtarë të familjes së njëjtë dhe pjesë e punës së përbashkët - projektit evropian. Nuk jemi të izoluar dhe nuk kemi mbetur jashtë, por besojmë që jemi pjesë e sendit të përbashkët që quhet Evropë. Ndjenja e përkatësisë është e arritur tejet e madhe, jo vetëm në kuptim politik dhe ekonomik, por edhe në aspektin sociologjik dhe psikologjik.

Merrni parasysh marrëdhëniet me fqinjët - unë e di që kjo çështje është e ndjeshme edhe për Maqedoninë. Shikoni shembullin e marrëdhënieve mes dy vendeve të BE-së, Portugalisë dhe Spanjës. Historia e Portugalisë dhe ajo e Spanjës janë të plota me luftëra të ndërsjella. Pothuajse nuk kemi bërë asgjë tjetër në historinë tonë. Madje edhe kur kemi luftuar, kemi jetuar pranë njëri tjetrit, por kemi shikuar në drejtime të ndryshme. Ata janë fqinjët tonë të vetëm, ne nuk kemi fqinjë tjerë. Spanja është fatlume sepse ata e kanë edhe Francën fqinj. Nga ana tjetër, ne nuk kemi fqinjë tjerë me të cilët duhet të merremi, përveç miqve tonë spanjollë, me të cilët kemi luftuar me shekuj ose të cilët i kemi injoruar.

Do të kisha thënë që sot nuk ka asnjë shtet tjetër në Bashkimin Evropian me marrëdhënie më të mira se Portugalia me Spanjën, që nuk ekzistojnë vetëm në nivel politik dhe diplomatik. Tani nuk kemi kufij, nëse udhëtoni prej Madridi në Lisbonë dhe nuk i vëreni dal-





limet e vogla mes gjuhës spanjishte dhe portugeze, asnjëherë nuk do ta kuptoni që e keni kaluar kufirin. Kjo ndodh për shkak se njerëzit dhe mentaliteti janë të njëjtë, si edhe zhvillimi ekonomik. Në fakt, ne jemi pajtuar me fqinjët tonë dhe e kemi bërë këtë pa e humbur identitetin. Bashkimi Evropian nuk i ka shndërruar portugezët në spanjollë, as në francezë ose gjermanë. Identiteti i jonë ka mbetur i paprekur, si edhe trashëgimia jonë kulturore. Ne e kemi gjetur vendin në familjen e popujve, në Bashkimin Evropian pa humbur asnjë copëz të shpirtit tonë. Kjo është shumë e rëndësishme, posaçërisht për rajonin e Ballkanit perëndimor, ku të gjithë janë shumë të ndjeshëm për çështjen e identitetit. Kjo çështje është bërë pothuajse fetare, kështu që do të përsëris që nuk kemi humbur asgjë nga rrënjët dhe identiteti i jonë. Sa i përket të kaluarës, ne e kemi kultivuar historinë tonë dhe jemi krenarë. Edhe ju duhet të jeni krenarë për historinë tuaj, por megjithatë anëtarësimi është e arritur dhe aventurë e

madhe, që ia vlen të përjetohet. Kriteret e caktuara nga Bashkimi Evropian e përcjellin rrugën e integritit evropian. Ato nuk janë zbuluar për t'i nervozuar njerëzit ose nga burokratët e këqij në Bruksel për t'i komplikuar gjërat. Kriteret duhet t'i plotësoni për përgatitje për anëtarësim në BE, përndryshe anëtarësimi nuk ka asnjë kuptim. Të gjitha këto sfida janë barë e Qeverisë tuaj, por më lejoni të jem shumë i qartë - Qeveria është faktori kryesor përgjegjës për promovimin e ndryshimeve dhe përshtatjen e administratës publike ndaj këtyre kriterëve. Edhe pushtetet lokale kanë përgjegjësi të madhe. Ekziston edhe përgjegjësia individuale. Ju duhet ta ndjeni që jeni pjesë e procesit të cilin e vijoni çdo ditë, përmes kontributit tuaj të vogël për tu bërë qytetarë të Evropës, që besoj do të ndodhë së shpejti. Jam i sigurt që kur të kthehem një ditë në Veles, në të ardhmen e afërt, do të kem kënaqësi të pijë një gotë shampanjë me Kryetarin e komunës për ta festuar integritimin tuaj në Bashkimin Evropian.

“Republikës së Maqedonisë i nevojiten politikanë të guximshëm dhe përgjegjës”

QENDRA MAQEDONASE
PËR ARSIM EVROPIAN

M-r Andreja Stojkovski,
Kryetar



Në Samitin e dhjetorit 2005, Këshilli Evropian vendosi t'ia jep Republikës së Maqedonisë statusin e shtetit-kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Këshilli ka konsideruar që Maqedonia është demokraci funksionale dhe stabile dhe që gjatë bisedimeve, kurdo që të fillojnë, shteti do të përgatitet plotësisht për anëtarësim në BE. Kjo ka qenë kurora e mobilizimit të suksesshëm të të gjitha kapaciteteve të shtetit në përgjigjen e pyetësorit të Bashkimit Evropian, të cilën Përfaqësuesi i lartë i politikës së jashtme dhe të sigurisë e ka quajtur si "letra më e gjatë e dashurisë të cilën e ka pranuar Bashkimi Evropian".

Maqedonia ka humbur shumë mundësi dhe disa hapa të ndërmarra nga Qeveria më tepër na kanë larguar nga BE-ja, sesa që na kanë afruar. Përveç kësaj, Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë disa hapa që janë vështruar si provokim ndaj Republikës së Greqisë, me çka e kemi humbur jo vetëm mbështetjen e tyre, por edhe mbështetjen dhe kuptimin nga shtetet tjera anëtare. Republika e Maqedonisë nuk kishte nevojë për aeroport të emëruar "Aleksandar Veliki" i cili ka vetëm një dalje për vajtje dhe ardhje, nuk kishte nevojë për stadium futbollit të emëruar "Arena nazionale - Filip II" për futboll të ligës së tretë dhe sport në të cilin nuk investohet. Maqedonisë më së paku i duhej që korridori trans-evropian X të riemërohet në "Aleksandar Makedonski". Mbi të gjitha, Maqedonia humbi edhe 50

milione euro ndihmë të pakthyeshme nga Republika e Greqisë, ndërkohë që kontesti dypalësh me Republikën e Greqisë u shndërrua në parakusht kryesor për avancimin e mëtejshëm në procesin e aderimit në BE.

Kjo i ngjan pak përrallës popullore maqedonase, ku Republika e Maqedonisë është nusja që ka gjetur një djalë (BE) dhe në vitin 2005 janë fejuar (viti kur Republika e Maqedonisë e ka fituar statusin e kandidatit). Pas katër vite fejesë, nusja duhet të martohet dhe të krijojë familje. Sipas traditës, kanë filluar përgatitjet për dasmën dhe në atë moment shfaqet vjehrra (Greqia), e cila i thotë nuses çka duhet të bëjë për martesë: dhurata për tërë familjen (26 shtete-anëtare), banesë dhe mobilje, veturë, tre troje dhe dy vreshta. Kërkesat e vjehrrës nuk janë dashakeqe, meqë në pikëvështrimin e saj, martesë është shumë më e fuqishme nëse ka bazë të forte. Por, këto kërkesa e kanë përkeqësuar gjendjen e nuses në mënyrë dramatike. Ajo ka dy zgjedhje: 1) meqë nuk mund ta plotësojë kërkesën e vjehrrës, nusja mund ta prish fejesën me të dashurin e jetës së saj dhe të pajtohet me ish të dashurin (shtetet e painkuadruara) ose 2) të vendosë të merr kredi nga banka për plotësimin e kërkesave të vjehrrës, me shpresë që një ditë do të kuptojnë vjehrra dhe miqtë që kërkesat e parashtruara janë të padrejta.

Kjo përrallë maqedonase është përrallë, vetëm për shkak se çështja zgjat 20 vite. Në jetën reale, njerëzit



i zgjidhin problemet, për shkak se nusja (Maqedonia) nuk mund të mbetet e fejuar 20 vite - në politikë, gjërat mbesin të pazgjidhura. Mbetet të shpresojmë që nusja do të gjejë zgjidhje, do ta mbledh forcën dhe do ta ndërpret hidhërimin për pafatin e saj. Një ditë, kur të bëhet vjehërr, do të dijë të jetë më e drejtë.

Kuptohet, kontesti është çështje dypalëshe dhe ajo që është e rëndësishme është të plotësohen kushtet dhe të merret rekomandimi nga Komisioni Evropian. Megjithatë, për fillimin e negociatave vendosë Këshilli i Ministrave, kurse në Këshill çdoherë do të ketë përfaqësues nga Republika e Greqisë. Është më se e qartë që BE ka ndërmarrë obligime ndaj rajonit, përfshirë edhe ndaj Republikës së Maqedonisë. Por, në të njëjtën kohë, është e qartë që parimi i solidaritetit dhe rregullat e vendim-marrjes janë ashtu si që janë dhe Republika e Maqedonisë nuk mund të bëjë shumë jashtë BE-së. Prej Brenda, gjërat ndryshohen më lehtë.

Sipas Marrëveshjes së përkohshme, Republika e Maqedonisë obligohet të negociojë nën patronazhin

e OKB-së dhe me ndërmjetësimin e z.Metju Nimic për emrin ndërkombëtar të shtetit, gjegjësisht për zëvendësimin e shkurtesës "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë". BE dallohet nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, meqë beson që kulturat, gjuhët, kombet dhe grupet e ndryshme etnike janë përparësi krahasuese e Evropës. BE i gjallëron gjuhët e vdekura, kujdeset për kulturën e shteteve-anëtare, për historinë dhe identitetin e tyre. Republika e Maqedonisë, gjuha maqedonase, identiteti dhe kombi maqedonas do të mbrohen në momentin kur do të anëtarësohemi në BE. Sa më shpejt ndodh kjo, aq më mire.

Në këtë moment, Republikës së Maqedonisë i nevojiten politikanë të guximshëm, udhëheqës që veprojnë për të mirën e qytetarëve, udhëheqës që dinë si ndërmerren nismat dhe që mendojnë më shumë për ardhmërinë, sesa për të kaluarën.

Problemi nuk është i thjeshtë, por nëse e vendosim kështu, do ta gjejmë më lehtë zgjidhjen dhe kjo do të thotë që e sigurojmë ardhmërinë e Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj.

“Nëse Maqedonia është problemi - Evropa është zgjidhja”

INSTITUTI MBRETËROR PËR STUDIME NDËRKOMBËTARE ELKANO

D-r Hullo Krespo MscLennan,
Hulumtues akademik
Hulumtues i studimeve iberike
dhe evropiane në Santander,
Kolegjin Sh. Antoni dhe
Universitetin e Oksfordit



"Nëse Spanja është problemi - Evropa është zgjidhja". Kjo ka qenë thënia e famshme e filozofit spanjoll Hoze Ortega dhe Gasetit në vitet e njëzeta, që në masë të madhe jep përmbledhje të raporteve mes Spanjës dhe Evropës. Në atë kohë, thënia e Ortegës dhe Gasetit ka nënkuptuar që Spanja ballafaqohet me aq shumë vështirësi politike dhe ekonomike, sa që Evropa është dukur si zgjidhja e vetme. Është interesante që ky citat ka qenë realitet i Spanjës në mbarë shekullin XX. Përveç kësaj, citati mund të aplikohet edhe në të gjitha ose pothuajse të gjitha shtetet evropiane, të cilat ballafaqohen me gjendje shumë të vështira brenda vendit dhe shpresojnë në zgjidhjet evropiane për vete. Portugalia dhe Spanja kanë qenë viktimat të ndarjes së ashpër të radhës së Evropës në shekullin XX. Por, pas Luftës së Dytë Botërore në Evropën perëndimore ka pasur edhe një ndarje tjetër dhe bllok të tretë mes demokracive dhe diktaturave. Fatkeqësisht, gadishulli iberik është lënë nën diktaturat autoritare që i kanë ndaluar vendet dhe popujt e vjetër, si që është Spanja, të bëhen pjesë të rrjedhave bashkëkohore në Evropën perëndimore.

Së këndejmi, anëtarësimi i Spanjës në Bashkimin Evropian ose Bashkësinë Evropiane të atëhershme ka qenë shumë i rëndësishëm. Do të them ca fjalë për procesin me të cilin Spanja ia ka dalë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, për të dhënë një pasqyrë sa frustruese kanë

qenë bisedimet dhe sa i vështirë mund të jetë procesi i aderimit. Spanja ka aplikuar për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane në vitin 1962, pesë vite pas themelimit të Bashkësisë Evropiane. Aplikacioni i parë është refuzuar për shkaqe politike - Spanja nuk ka qenë demokraci dhe kjo ka shkaktuar refuzim, ndonëse Bashkësia Evropiane ka vendosur marrëdhënie ekonomike me Spanjën, që ka pasur rol shumë të rëndësishëm të ekonomisë spanjolle në vitet e gjashtëdhjeta. Pas rivendosjes së demokracisë në vitin 1977, Spanja ka pritur me padurim të anëtarësohet në Bashkësinë Evropiane dhe e ka parashtruar aplikacionin për anëtarësi vetëm një muaj pas zgjedhjeve të para parlamentare. Megjithatë, Spanjës i janë dashur edhe 9 vite për tu anëtarësuar, për shkak të procesit të gjatë të bisedimeve. Bisedat e para kanë filluar zyrtarisht në vitin 1979, por disa pengesa e kanë vështirësuar rrugëtimin e Spanjës. Pengesa më e vështirë ka qenë vetoja franceze e vitit 1980, menjëherë pas hapjes së negociatave - Franca vendosi veto ndaj anëtarësimit të Spanjës. Kuptohet, kjo na e sjell përfundimin shumë të rëndësishëm të negociatave, të cilin Maqedonia e njej mirë. Bashkimi Evropian është klub i të pasurve dhe nëse dëshiron të anëtarësohesh, duhet të pajtohesh me të gjithë anëtarët që kanë të drejtë vote. Ndonjëherë, kjo mund të jetë detyrë e vështirë dhe e rëndë. Edhe në rastin e Spanjës ka qenë vështirë, kur Bashkësia Evropiane ka pasë vetëm 10 anëtarë. Sot,

¹ Thënie e parafrazuar e Hoze Ortegës dhe Gasetit nga vitet e '20-ta të shekullit të kaluar



me 27 anëtarë në Bashkim, kjo është edhe më e vështirë. Vetoja franceze ndaj anëtarësimit të Spanjës ka qenë frustuese. Ndoshta pyesni pse Franca e bllokoi Spanjën, kur Portugalia ishte gjithashtu e përfshirë në bisedime dhe prekej nga vetoja. Kishte shumë arsye, kryesisht disa probleme bujqësore që e kanë sfiduar bujqësinë franceze. Së dyti, në vitin 1980 kishte zgjedhje dhe kuptohet, Kryetari i atëhershëm francez Zhiskar Desten besonte se vetoja është opsion i mirë.

Çka bërë Spanja për këtë veto? Pas dy vitesh, gjendja politike ndryshoi. Në zgjedhjet spanjolle fitoi Partia socialiste dhe kjo ishte në bashkërenditje me faktin që partia socialiste fitoi në Francë (para një viti, në zgjedhje kishte fituar Fransoa Miteran). Atëbotë konsiderohej që me dy qeveri socialiste në pushtet, vetoja franceze do të tejkalohet me siguri. Nuk ishte lehtë, për shkak se në atë kohë, Kryeministri Felipe Gonzales deklaroi: Francezët janë më tepër francezë sesa socialistë.

Në fund, vetoja megjithatë është tejkaluar. Por, kjo nuk ka qenë problemi i vetëm. Spanja është dashur pastaj të

bisedojë për çështje shumë të vështira me vendet tjera anëtare, prej vitit 1982 deri në 1985 kur më në fund është anëtarësuar. Ka pasur edhe probleme, si ai me Britaninë, gjegjësisht kontesti për Gjibraltarin. Dy vendet kanë pasur kundërshtime diplomatike rreth sovranitetit të kësaj enklave të vogël britanike në tokën spanjolle. Gjatë bisedimeve, Britania ia ofroi përkrahjen Spanjës, me kusht që Qeveria spanjolle ta tërheqë bllokadën për Gjibraltarin dhe Spanja pranoi. Ka pasur edhe shumë kushte nga shtetet tjera, si për shembull shtetet e Beneluksit (Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu) që kanë pasur kujtime të hidhura nga fanatizmi fetar spanjoll gjatë shekujve të mëparshëm. Ata kërkuan që Spanja të vendosë marrëdhënie me Izraelin, meqë shteti i Izraelit nuk ishte pranuar zyrtarisht. Spanja është dakorduar sërish me këtë kërkesë dhe e ka pranuar Izraelin. Shtetet tjera nuk kanë imponuar kushte, por kanë dhënë rekomandime, si që ishte këshilla e kancelarit gjerman Kohl, i cili e këshilloi Kryeministrin Gonzales ta mbajë shtetin në NATO, për shkak se Spanja ka pasur mendime të ndara rreth NATO-së. Spanja është



anëtarësuar në NATO në vitin 1981, por partia socialiste premtoi tërheqje të Spanjës nga kjo organizatë. Felipe Gonzales e ndryshoi qëndrimin e tij për NATO dhe vendosi që vendi të mbetet në Aleancën atlantike. Është e qartë që këshilla e Helmut Kohlit kishte ndikim të madh mbi këtë çështje. Procesi ka qenë i vështirë. Bindja e të gjitha vendeve të Bashkësisë Evropiane për të votuar në favor të anëtarësimit të Spanjës ka qenë e vështirë. Për këtë arsye, anëtarësimi është dashur të pritët deri në vitin 1985.

Shumë faktorë të rëndësishëm intern i kanë ndihmuar Francës në procesin e gjatë të bisedimeve. Kur bisedimet rrjedhin pa pengesa, është lehtë që populli të nervozohet dhe dëshpërohet nga Bashkimi Evropian, të besojë që BE nuk është e interesuar. Spanja dhe Portugalia është dashur t'i orientojnë të gjitha forcat për ta përshtatur gjendjen në vend për anëtarësim në Komunitetin Evropian. Këto kanë qenë kohëra të një prej krizave më të vështira ekonomike me të cilat jemi ballafaquar në Evropë. Pikërisht në këtë kohë, Spanja

dhe Portugalia filluan ta shkruajnë detyrën e shtëpisë, të nevojshme për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane.

Spanjës i ka ndihmuar edhe konsensusi i brendshëm krahas Bashkësisë Evropiane, që do të thotë se të gjithë e kanë mbështetur anëtarësimin. Në Spanjë nuk ka ekzistuar i a.q. Euro-skepticizëm, që ka filluar të problematizohet në shumë vende evropiane. Në kohën kur në Parlamentin spanjoll është votuar për anëtarësimin në Bashkësinë Evropiane, të gjitha partitë politike, majtiste dhe djathtiste e kanë mbështetur anëtarësimin në Bashkimin Evropian. E njëjta ka ndodhë edhe për shoqërinë sociale. Entuziazmi për anëtarësim ka qenë i jashtëzakonshëm, ka ekzistuar besim që Evropa është zgjidhja, pa dallim faktit që e njëjta Evropë duket se i vështirëson gjërat për Spanjën.

Do të kisha dashur të flas për anëtarësimin spanjoll. Cila ka qenë përvoja e Spanjës si anëtare? Duhet të themi që Spanja ka pasur përvojë të privilegjuar si anëtare e Bashkësinë Evropiane të atëhershme dhe Bashkimit Evropian të sotëm. Që nga viti 1985 deri më sot, trans-

formimi i Spanjës është i pabesueshëm. Spanja sot është ekonomia e tetë në botë dhe kjo do të ishte e pamundur pa ndihmën e Bashkimit Evropian. Mënyra në të cilën Spanja i ka shfrytëzuar fondet strukturale dhe kohezive ka qenë e shkëlqyeshme. Shteti ka pasur ndryshim radikal: është ndërtuar infrastruktura rrugore dhe janë modernizuar qytetet. Si rezultat, Spanja tani ka një prej sistemeve më të mira të transportit në Evropën perëndimore, si edhe Portugalia. Transformimi i qyteteve spanjolle dhe portugeze është i pabesueshëm. Të gjithë që kanë udhëtuar në Spanjë dhe Portugalinë në vitet e shtatëdhjeta nuk do t'i njihnin vendet në vitet '80 ose '90 - ekziston ndryshim i pabesueshëm, që në masë të madhe ka kontribuar për zhvillimin ekonomik dhe industrial. Mirëqenia sociale është një çështje tjetër e rëndësishme. Spanja e ka konsoliduar shtetin bashkëkohor social me sistem universal shëndetësor në fund të viteve të tetëdhjeta, falë Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, nuk habit fakti që Kryeministri i atëhershëm Gonzales dhe të gjitha qeveritë vijuese çdo herë e më tepër e përfaqësojnë parimin e solidaritetit - ideja që shtetet më pak të pasura duhet të jenë shfrytëzues të fondeve të këtylla për zhvillimin e vendit. Si rezultat i kësaj, Spanja shënoi përparim të konsiderueshëm jo vetëm si anëtare, por edhe në kornizat e Bashkimit Evropian. Prej shtetit relativisht të marginalizuar në Evropën perëndimore, Spanja është bërë pjesë e rrjedhave bashkëkohore në Evropë dhe zë i rëndësishëm në miratimin e vendimeve. Kuptohet, hyrja në zonën e Euros dhe përdorimi i valutës së unifikuar ka qenë shumë e rëndësishme. Njëherazi, kjo ka kërkuar shumë mund, për shkak se

në kohën kur filloi debati për valutën e përbashkët në vitin 1992, Spanja nuk ka plotësuar asnjë kriter ekonomik, që nevojitej për anëtarësim. Vetëm falë programit të rreptë për përparim ekonomik dhe masave të ashpra për kursim, të imponuara nga qeveria e re e Partisë popullore në vitin 1996, Spanja ia ka dalë që brenda disa viteve t'i plotësojë kriteret e Bashkimit Evropian. Kjo na tregon sa e privilegjuar ka qenë marrëdhënia e Spanjës me Bashkimin Evropian, ku janë nevojitur përpjekje prej të dy palëve. Mendoj që është e rëndësishme të konsiderohet fakti që sot i harrojmë përpjekjet e disa vendeve për transformimin e shoqërive të tyre. Kjo patjetër duhet të rikujtohet nga vendet, si që jeni ju. Ndonëse Evropa është zgjidhja e problemeve të brendshme të një vendi, shteti nuk guxon asnjëherë ta humbë planin e vet për zhvillim të brendshëm dhe ta tregojë fuqinë para pjesës tjetër të Evropës.

Do të përfundoj duke theksuar që marrëdhënia e privilegjuar që është krijuar dhe shijuar nga Spanja në Bashkimin Evropian, mund të përsëritet edhe në fushat tjera dhe në kohëra tjera. Është e saktë që Spanja, si edhe Portugalia, e kanë pasur privilegjin e Bashkimit Evropian më të vogël. Kjo ka qenë rast me zgjerimin e viteve të tetëdhjeta dhe kontekstit më të mirë në Evropë gjatë zhvillimit ekonomik - vitet e tetëdhjeta dhe fillimi i viteve të nëntëdhjeta kanë qenë vite shumë të mira. Tani rrethanat kanë ndryshuar shumë. Por, të mos harrojmë që kur ka filluar krejt kjo, kur Spanja dhe Portugalia e kanë filluar marshin e tyre drejt Komunitetit Evropian, rrethanat ekonomike në Evropë kanë qenë dukshëm më të këqija se rrethanat aktuale.

“Tani duhet të mendohet për ardhmërinë”

AMBASADA E
REPUBLIKËS SË
SLLOVENISË

Sh. T. Z. Allan Brajan Bergant,
Ambasador



Në mars 2004, Sllovenia u anëtarësua në NATO dhe pas dy muajve, së bashku me 9 shtete-anëtare hyri edhe në Bashkimin Evropian. Pastaj e pranuan Euron si valutë nacionale dhe aderuan në zonën Schengen. Këto janë sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet Maqedonia tani. Më 15 shtator, Komisioni Evropian do ta mbyllë Raportin për progresin e Maqedonisë, që do të prezantohet zyrtarisht më 14 tetor. Sipas informative të Lubjanës dhe Brukselit me të cilat disponoj, ky Raport do të jetë pozitiv për shkak se Maqedonia ka bërë shumë gjatë javëve të fundit.

Marsin e kaluar, Maqedonia i morri 8 kriteret dhe një plotësues, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme. Sipas vlerësimit të OSBE-së dhe ODIHR-it, në zgjedhjet e marsit 2009 ky kriter është përmbushë nga Maqedonia. Me miratimin e paradokohshëm të Ligjit për nëpunës publikë është plotësuar edhe kriteri i gjashtë. Kjo do të thotë që ka avancim serioz në plotësimin e kriterëve të caktuara nga Komisioni. Megjithatë, përparimi i deritashëm nuk do të thotë që gjithçka përfundon më 14 tetor. Edhe më tej pritet implementim i mirë. Në Maqedoni, ligjet kalojnë shumë shpejtë në Kuvend, por ngecin në implementim.

Një çështje tjetër e rëndësishme për qytetarin e rëndomë është liberalizimi i vizave. Sllovenia e di mire domethënien e barrierës së vizave, për shkak

se në ish-Jugosllavi, sllovenët, maqedonasit dhe të tjerët nuk kishin probleme për udhëtim. Por, Maqedonia mbeti prapa perdes së vizave dhe maqedonasit nuk mund të udhëtojnë lire. Çdo ditë shohim qindra njerëz duke pritur për viza para ambasadave. Gjatë kryesisë sllovene, prej 1 janarit 2008, hyri në fuqi e a.q. Marrëveshje për liberalizim të vizave për kategori të caktuara të qytetarëve, si që janë mësimmshënësit, gazetarët, shoferët e kamionëve, biznesmenët, etj. Në këtë periudhë, ambasada e jonë lëshoi pa pagesë 45% të vizave.

Procesi i liberalizimit të vizave u iniciua në kohën kur me Këshillin e BE-së kryesonte Dragutin Mate, si Ministër i punëve të brendshme të Sllovenisë dhe kur Komisar për liri dhe drejtësi ishte Franko Fratini. Rol të madh ka luajtur edhe Ambasadori i jonë i mëparshëm në Maqedoni, Marjan Shiftar. Kështu, shtetet e rajonit morën kushte të caktuara, të cilat Maqedonia i plotësoi dhe morri notë më të mire. Kushtet përfshinin menaxhim të integruar kufitar, pasaporta biometrike, themelim të viza-qendrës në Ministrinë e punëve të jashtme, etj. Sllovenia ka ndihmuar edhe më shumë në lidhjen e ambasadave maqedonase me viza-qendrën në Ministrinë e punëve të jashtme. Ne gjithashtu e kemi mbështetur propozimin e Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për Malin e Zi, Serbinë dhe

Maqedoninë prej 1 janarit 2010. Për Slloveninë, kjo është punë e kryer dhe tani duhet të mendohet për ardhmërinë.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian duhet të jetë proces i hapur dhe qytetarët duhet të marrin informata të vazhdueshme për atë se çka është BE. Sllovenia i ka përkushtuar vëmendje të posaçme komunikimit publik. Qeveria ka miratuar strategji, program të komunikimit për informimin publik për domethënien e anëtarësitimit në BE. Si rezultat i kësaj, në të gjitha anketat e Eurobarometrit, Sllovenia ishte një prej shteteve me qytetarë më të informuar për domethënien e Bashkimit Evropian.

Një prej programeve për komunikim publik ka qenë Eurofon, një linjë speciale telefonike, 080-2000. Qëllimi i jonë ka qenë të anëtarësohemi në vitin 2000, por Sllovenia i ka përmbyllur negociatat në 2002 dhe është anëtarësuar në vitin 2004. Në këtë linjë telefonike, si dhe përmes adresave speciale elektronike, qytetarët kanë parashtruar pyetje dhe janë informuar. Janë shpërndarë kartolina speciale "Euro-korrespondentë" me të cilat qytetarët kanë mund të parashtrojnë pyetje të ndryshme për Bashkimin Evropian dhe kryesinë sllovene. Persona me trajnim special kanë udhëtuar në mbarë Slloveninë me Eurobus dhe i kanë informuar qytetarët, jo vetëm në qytetet e mëdha por edhe në vendet e vogla. Për Bashkimin Evropian janë informuar edhe grupet speciale në shënjestër: gazetarë, afaristë, studentë, bujq, etj. Motoja e Qeverisë për këtë fushatë ka qenë: Sllovenia në shtëpi në Evropë.

Shembulli i liberalizimit të vizave e tregon rëndësinë e informimit të saktë dhe me kohë të qytetarëve. Kështu, kohëve tu fundit flitet që prej 1 janari, Maqedonasit do të udhëtojnë, punojnë dhe studiojnë në

shtetet-anëtare. Për fat të keq, kjo nuk është e saktë. Prej 1 janari nuk do të pritet para ambasadave, gjithçka tjetër mbetet e njëjtë. Edhe më tej do të nevojitet sigurimi i udhëtimit, si dhe mjetet e mjaftueshme për udhëtim dhe qëndrim. Për këtë arsye, nevojitet informimi i qytetarëve. Ambasada do ta mbështesë Ministrinë e punëve të brendshme, Sekretariatin për çështje evropiane dhe një organizatë joqeveritare në realizimin e fushatës promovionale për liberalizimin e vizave dhe pasojave të saj.

Sllovenia është anëtare e Bashkimit Evropian tash e pesë vite. Përfitimet nga anëtarësimi në BE tani janë të dukshme, me siguri përfitimi më i madh është anëtarësimi në zonën Schengen. Më pare, udhëtimi prej Lubjane për Trieste ka zgjatur 2 orë, tani zgjat më pak se 45 minuta. Meqë nuk ka kufij në zonën Schengen, lirisht mund të udhëtohet prej Sllovenisë deri në Portugali, gjegjësisht deri në Suedi dhe Finlandë në veri. Studentët në Slloveni kanë harruar çka është pikë-kalimi kufitar. Miqtë e mi, kur udhëtojnë prej Lubjane në Shkup me veturë duhet t'i tregojnë pasaportat tre herë. Madje edhe pas fillimit të liberalizimit të vizave, në çdo aeroport të BE-së do të ketë hyrje të posaçme për "Shtetasit e Bashkimit Evropian" dhe "Të tjerët". Ky rregull është aplikuar edhe për Slloveninë deri në anëtarësimin në zonën Schengen, edhe unë jam shembull i aplikimit të këtij parimi. Kur punoja në Finlandë dhe udhëtoja me miqtë e mi finlandez në Estoni, ata kalonin për një minute, kurse mua më duhej të pres tek "Të tjerët". Mospajtimin tonë me trajtimin e këtyrë e kemi shprehur simbolikisht përmes një fushate. Në qendër të Lubjanës gjendet ura Trimostoie, me tre degë - një për vetura dhe dy për këmbësorë. Në njërin anë të urës ishte e shënuar "Shtetasit e Bash-



kimit Evropian" kurse në tjetrën "Të tjerët". Maqedonia do ta tejkalojë këtë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe zonën Schengen.

Një prej përfitimeve të Sllovenisë, posaçërisht tani në periudhën e krizës financiare, është edhe pranimi i Euros si mjet pagesor. Për qytetarin e thjeshtë, më të dukshme janë përfitimet e tregut të përbashkët, gjegjësisht euro-tarifa për celularët gjatë roamingut. Çmimi më i lartë që llogaritet nga operatorët për thirrjet prej jashtë është 42 euro-cent dhe tarifimi është në sekonda. Më tej, numri 112 për rastet urgjente dhe karta e sigurimit shëndetësor evropian.

Qytetarët e Bashkimit Evropian kanë të drejtë të punojnë në vendet tjera anëtare. Ndonëse Sllovenia është anëtare prej vitit 2004, sllovenët edhe më tej nuk kanë të drejtë të punojnë lirisht në disa vende, si që është Gjermania ose Austria, për shkak se ekziston e a.q. periudhë kalimtare. Duhet ta presim vitin 2011 që sllovenët të punojnë lirisht në të gjitha shtetet-anëtare. Gjithashtu, qytetarët e BE-së mund të pensionohen dhe të zhvendosen në ndonjë shtet tjetër anëtar, me obligim të vetëm të paraqitjes në stacionin e pare policor.

Lëvizshmëria e diturizës është përfitim i posaçëm. Shtetasit e BE-së mund të përfitojnë nga programet



për arsim, si që janë Erasmus, Komenski, Gruntvig, Leonardo da Vinçi, etj. Në kohën kur isha student, nuk kishte mundësi për studim pa pagesë ose bursa për studime jashtë vendit. Gjatë qëndrimit tim në Helsinki të Finlandës, takova shumë studentë sllovenë që përfitonin nga programet për arsim, përmes këmbimit studentor.

Në fund, sllovenët kanë të drejtë të votojnë dhe të votohen për deputetë të Parlamentit Evropian. Më 7

qershor, Sllovenia për herë të dytë i ka zgjedhur deputetët për Parlamentin Evropian. E njihni Jelko Kacinin dhe Alojz Peterle, të cilët çdoherë i japin përkrahje Maqedonisë. Janez Potočnik është komisar i jonë dhe në institucionet e BE-së punojnë rreth 350 sllovenë. Kryesia jonë i ka ndihmuar më së shumti Sllovenisë për lansim në Bashkimin Evropian.



ISBN 978-608-218-065-6

